



UNITED NATIONS
NORTH MACEDONIA



2021

REZULTATET E RAPORTIT VJETOR NË MAQEDONINË E VERIUT

MAJ 2022





UNITED NATIONS NORTH MACEDONIA



Food and Agriculture
Organization of the
United Nations



IAEA



International
Labour
Organization



IOM
UN MIGRATION



UNITED NATIONS
HUMAN RIGHTS
OFFICE OF THE HIGH COMMISSIONER



UNDRR
UN Office for Disaster Risk Reduction



UNECE



UN
environment
programme



United Nations
Educational, Scientific and
Cultural Organization



UNHCR
The UN Refugee Agency

unicef



UNODC
United Nations Office on Drugs and Crime



UNOPS



THE WORLD BANK
IBRD • IDA | WORLD BANK GROUP



World Health
Organization



UN
VOLUNTEERS



FALËNDERIM

Ky dokument është hartuar nga Zyra e Koordinatorit të përhershëm të Kombeve të Bashkuara (ZKP/RCO) në Maqedoninë e Veriut në emër të ekipit të OKB-së në Maqedoninë e Veriut. ZKP dëshiron t'i falënderojë të gjitha palët përkatëse për kontributin e tyre në përgatitjen e këtij dokumenti.

Versioni më i fundit i këtij dokumenti gjendet në ueb faqen e OKB-së për Maqedoninë e Veriut në northmacedonia.un.org.

Për informacione shtesë, ju lusim kontaktoni: **ZKP-në të OKB-së në Maqedoninë e Veriut** rc-northmacedonia@un.org

Fotografia e ballinës: KOVID-19 dhe ndikimi i tij ndaj familjeve. ©UNICEF/2022/Georgiev.

Emërtimet e përdorura dhe paraqitja e materialit në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë mendimi nga ana e Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me statusin ligjor të çdo vendi, territori, qyteti, zone ose të autoriteteve të tij, ose në lidhje me përcaktimin e kufizimit ose kufijve të tij.

Të dhënat financiare janë të përkohshme dhe mund të ndryshojnë varësisht nga certifikimi financiar.

Përmbajtja

HYRJE	4
EKIPI I KOMBEVE TË BASHKUARA NË VEND NË VITIN 2021	5
PARTNERËT KRYESORË TË OKB-SË PËR ZHVILLIM	6
ZHVILLIMET KRYESORE NË KONTEKSTIN VENDOR DHE RAJONAL	7
MBËSHTETJA E SISTEMIT TË ZHVILLIMIT TË OKB-SË PËR PRIORITETET E ZHVILLIMIT KOMBËTAR ..	9
REZULTATET E VITIT 2021 SIPAS PRODHIMEVE *	13
Rezultati 1: Prosperitet gjithëpërfshirës	13
Rezultati 2: Shërbime cilësore për të gjithë	16
Rezultati 3: Mjedisi i shëndetshëm.....	19
Rezultati 4: Qeverisja e mirë.....	22
FINANCIMI I OZHQ-VE DHE PARTNERITETI	25
KOHERENCA, EFEKTIVITET DHE EFIKASITETI I OKB-SË	26
VLERËSIMI DHE MËSIMET E NXJERRA	28
MOBILIZIMI I FINANCAVE DHE BURIMEVE	29
OKB NË MAQEDONINË E VERIUT NË VITIN 2022	31
SHTOJCAT	32

** Për rezultatet e detajuara të vitit 2021 sipas çdo prodhimi, shihni Shtojcën e raportit*

Hyrje

Njerëzimi po përballet me një zgjedhje të ashpër dhe urgjente: zbrapsje apo përballje. Zgjedhjet që i bëjmë – ose dështojmë t'i bëjmë sot – mund të rezultojnë në çrregullim të mëtejshme dhe një të ardhme me kriza të përhershme, ose me një përparim drejt një të ardhmeje më të mirë, më të qëndrueshme dhe paqësore për njerëzit dhe planetin tonë. - Antonio Guterres, Sekretar i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara



Në vitin 2021, bota dhe Maqedonia e Veriut filluan ta tejkalojnë KOVID-19 përmes përhapjes së vaksinave, rikuperimit të ekonomisë dhe rikthimit të zhvillimit të arsimit me prezencë fizike. U shënua rritje të punësimit, veçanërisht për gratë, të cilat vuajtën më shumë gjatë pandemisë, mirëpo nuk u shënua rritje e asaj përmase të punësimit të të rinjve, ndonëse ata kishin vuajtur më së shumti gjatë pandemisë, gjë që mbetet çështje shqetësuese. Pavarësisht vonesave në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE), angazhimi i vendit në zbatimin e reformave dhe prioritetëve të BE-së ngeli një përcaktim i pakompromis.

Në nivel politikash, u arrit përparim i rëndësishëm në ndryshimin e klimës dhe menaxhimin e burimeve natyrore, si dhe me përmirësimin e statusit ligjor të grupeve të cënueshme, duke përfshirë gratë, personat me aftësi të kufizuara (PAK) dhe migrantët. Pavarësisht sfidave, vendi e realizoi regjistrimin e shumëpëritur dhe e nisi procesin e formulimit të vizionit të parë nacional të zhvillimit, që të dy më rëndësi parësore në përmirësimin e politikëbërjes dhe zbatimin e Agjendës 2030.

Viti 2021 ishte viti i parë i zbatimit të strategjisë së përbashkët, Korniza për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Qëndrueshëm 2021-2025 (KBZHQ/SDCF). Në këtë drejtim janë ndërmarrë përpjekje të fuqishme në përbashkjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ/SDG) dhe transformimit në praktikë të reformës së sistemit të zhvillimit të OKB-së. Ne vazhduam të demonstrojmë se puna e përbashkët shpie në rezultate më të mira dhe më të qëndrueshme, e rrit efikasitetin dhe e eliminon dyfishimin e punëve.

Plani i Përbashkët i Punës 2021 ishte i pari i këtij lloji, i zhvilluar së bashku me më shumë se 70 partnerë të OKB-së dhe qeverisë. Përgjatë punës sonë të përbashkët për zbatimin e këtij plani, gjithashtu u angazhua e gjithë shoqëria e Maqedonisë së Veriut dhe partnerët ndërkombëtarë. Ne i ndamë njohuritë dhe mirëkuptimin e përbashkët të Agjendës 2030 me nxënësit/studentët, komunitetin e biznesit, nëpunësit civilë, deputetët dhe të tjerë. Me mbështetjen bujare të donatorëve, ne punuam së bashku për zbatimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe reformat e BE-së, si dhe zhvillimin e zgjeruar lokal dhe rajonal. Njashtu ne i bashkuam përpjekjet me mediat dhe

Rosana Duxhak

Koordinatorë e përhershme e Kombeve të Bashkuara



partnerët për t'i fuqizuar mesazhet e rëndësishme mbi klimën, dhunën mbi bazë gjinore dhe raportimin e saktë dhe të bazuar në fakte.

Së bashku me institucionet financiare nacionale dhe ndërkombëtare, promovuam mënyra dhe instrumente inovative të financimit, që tashmë janë të racionalizuara në politikat e qeverisë. Ne identifikuam kampionë midis bizneseve në përfshirjen e standardeve mjedisore, sociale dhe të qeverisjes së korporatave në sektorin privat.

Në të gjitha fushat e mbështetëm inovacionin dhe digjitalizimin, me qëllim të përmirësimit të qasjes në vende cilësore të punës dhe fuqizimit të konkurrencës së ekonomisë, përmirësimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe rritjes së aftësisë së tyre për t'i përdorur ato.

Veprimi i përbashkët vazhdoi në formën e programeve të përbashkëta të OKB-së – mbi politikën e migracionit dhe të dhënave cilësore, për përgjigjen shëndetësore ndaj KOVID-19 në zona të largëta dhe për avancimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara – madje edhe më shumë është në proces të përgatitjes - duke përfshirë qasjet inovative në fushat e mjedisit dhe energjisë.

Në fund të vitit, u shfaqën sfida të reja, të cilat ndikojnë në standardin e jetesës në vend dhe rajon. Rritja e çmimeve të energjisë dhe efektet negative të krizës politike rajonale me ndikim të thellë në paqen, stabilitetin dhe zhvillimin socio-ekonomik do të ndihen në vitet në vijim. Cënueshmëritë dhe rreziqet janë në rritje.

Për punën tonë të përbashkët, kujdesi që askush të mos mbetet pas, do të jetë aq i rëndësishëm sa kurrë më parë. Ndjekja e vlerave dhe parimeve të OKB-së që vazhdojnë të testohen, do të jetë çelësi për t'i kapërcyer krizat dhe për t'i tejkaluar përpjekjet tona të përbashkëta.

Maqedonia e Veriut, një mbështetëse e fortë e veprimit shumëpalësh, dhe Kombet e Bashkuara, një nga partnerët kryesorë të zhvillimit të vendit, do ta vazhdojnë partneritetin e ngushtë drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe përmirësimit të kushteve të jetesës për njerëzit në Maqedoninë e Veriut dhe në rajon.

Bujar Osmani

Ministër i Punëve të Jashtme

EKIPI I OKB-SË NË VEND

Në vitin 2021 Kombet e Bashkuara (OKB) në Maqedoninë e Veriut kanë përfshirë 22 agjenci të angazhuara në aktivitete operative për zhvillim në vend. Këto subjekte punojnë së bashku përmes ekipit të Kombeve të Bashkuara në vend (UNCT), i cili është mekanizmi kryesor në vend për koordinimin dhe vendimmarrjen ndërmjet agjencive, nën udhëheqjen e Koordinatorit të përhershëm të OKB-së (KP) – përfaqësuesit të caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së për operacionet e zhvillimit në vend.

Puna e OKB-së në Maqedoninë e Veriut është në linjë me zhvillimin shtetëror të vendit dhe prioritetet strategjike, detyrimet e ndërkombëtare të shtetit mbi të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore, si dhe angazhimet drejt përbushjes së Agjendës 2030 dhe Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ).

Prioritetet strategjike të OKB-së përcaktohen qartë në Kornizën e përbashkët të Bashkëpunimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2021–2025 (KBZHQ), që është dokument strategjik kryesor, i cili e drejton punën gjatë periudhës pesëvjeçare, të akorduar me Qeverisë dhe OKB-së në vitin 2020.

Mbështetja e OKB-së ofrohet përmes asistencës teknike, zhvillimit të kapaciteteve, shfrytëzimit të partneriteteve dhe burimeve, mobilizimit social, ndërmjetësimit të njohurive dhe pilotimit dhe rritjes së inovacioneve.

Në vitin 2021 – vit i cili e shënoi vitin e parë të zbatimit të strategjisë pesëvjeçare - 17 agjenci të OKB-së kishin prezencë fizike në Maqedoninë e Veriut, edhe atë qoftë përmes një zyre të pavarur përfaqësimi, stafit të projektit ose kapaciteteve të ngulitura në Zyrën e Koordinatorit të përhershëm (ZKP). Katër agjenci i kanë zhvilluar aktivitetet e tyre tërësisht nga distanca.

Ekipi i OKB-së në Maqedoninë e Veriut në vitin 2021 përbëhej nga më shumë se 250 persona të stafit profesional dhe mbështetës nacional dhe ndërkombëtar me prezencë në vend. Ata u mbështetën nga ekspertë dhe personel nga zyrat rajonale dhe qendrore të OKB-së anëmbanë globit.

24

Agjencitë e OKB-së të angazhuara në aktivitete operative për zhvillim në Maqedoninë e Veriut

FAO	Organizata e Kombeve të Bashkuara e Ushqimit dhe Bujqësisë
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
ITU	Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit *
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNDRR	Zyra e OKB-së për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë *
UN-Habitat	Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore *
UNDSS	Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Sigurinë dhe Sigurinë
UNECE	Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën *
UNEP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimit, Shkencë dhe Kulturë *
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNIDO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin
UNOPS	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve
UNV	Vullnetarët e Kombeve të Bashkuara *
ZKP e OKB	Zyra e Koordinatorit të përhershëm të Kombeve të Bashkuara
UN WOMEN	Njësia e OKB-së për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
BB	Grupi i Bankës Botërore
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

* pa prezencë fizike pa KBZHQ




Partnerët kryesorë të OKB-së për zhvillim

Gjatë vitit 2021, OKB-ja vazhdoi të punojë me mbi 130 partnerë – pushtetet qendrore dhe lokale, shoqërinë civile, partnerët ndërkombëtarë, sektorin privat, botën akademike dhe gjithë të tjerët – për ta mundur rëndësinë dhe ndikimin e veprimit të saj për njerëzit në Maqedoninë e

Veriut. Në aneks është dhënë një listë e detajuar e palëve të interesuara, me të cilat OKB-ja ka zhvilluar partneritet në vitin 2021.

Partnerët që dhanë kontribute bujare në aktivitetet e OKB-së në Maqedoninë e Veriut në vitin 2021

Të dhënat e datës 31 mars 2022, bazuar në shpenzimet për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2021, në në miliona dollarë amerikan



* Kontribuesit publikë në fondet e bashkuara, vertikale dhe tematike, të cilët mbështetën aktivitetet e OKB-së në Maqedoninë e Veriut në vitin 2021, të treguar sipas rendit alfabetik.

Zhvillimet kryesore në kontekstin vendor dhe rajonal për vitin 2021

Përgjatë gjithë vitit 2021, KOVID-19 vazhdoi t'i zgjerojë kapacitetet dhe financat institucionale, me një shpenzim të lartë dhe të vazhdueshme për shëndetin publik, por edhe me një ekonomi në rigjallërim. Vonesat e vazhdueshme me fillimin e negociatave të anëtarësimit në BE ishin zhgënjyese dhe shpjen në uljen e mbështetjes për integrimin në BE, si në rajon ashtu edhe në vend, ndonëse kishte dallime përgjatë spektrit politik dhe etnik.

Pavarësisht kësaj, vendi ka vazhduar ta luajë një rol pozitiv në rajon, duke përfshirë edhe Dialogun e Forumit të Prespës të nivelit të lartë dhe nismës "Ballkani i Hapur", që synon krijimin e tregut të vetëm të mallrave, shërbimeve, njerëzve dhe kapitalit për Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë. Vendet tjera janë inkurajuar që t'i bashkohen kësaj iniciative.

Është arritur progres me reformat ligjore dhe institucionale dhe me të drejtat dhe liritë themelore të njohura gjithandej, ndonëse ka vazhduar korrupsioni në vend, andaj rezultatet e ulëta kundrejt indikatorëve kryesorë të qeverisjes (stabiliteti politik, sundimi i ligjit dhe llogaridhënia) kanë ngel të ulëta. Shteti e ka përshpejtuar dinamikën e harmonizimit të politikave dhe procesit legjislativ, duke siguruar përputhjen me kërkesat kyçe të legjislacionit ndërkombëtar dhe atij të BE-së dhe e ka nisur procesin e zhvillimit të një vizioni afatgjatë të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të politikave tjera përmes konsultimit të gjerë ndërtimit të konsensusit.

Zgjedhjet lokale të tetorit rezultuan në fitime të konsiderueshme të opozitës dhe e nxitën dorëheqjen e kryeministrit në detyrë. Koalicioni i përmirësuar dhe kabineti i rinovuar u formuan në fund të vitit me sfida në pritje e sipër, si kriza energjetike në rritje dhe ngërçi i procesit të pranimit në BE.


Viti filloi me recesion të vazhdueshëm për shkak të efektit të përhapur të bllokimeve anekënd Evropës në fund të vitit 2020, por ekonomia u rrit fuqishëm në tremujorin e dytë dhe mesatarisht në gjysmën e dytë të vitit, duke shënuar një rritje vjetore të vlerësuar prej rreth 4%. Masat e reagimit të qeverisë dhe rrjeti i sigurisë sociale ndihmuan në zbutjen e ndikimit tek grupet dhe bizneset më të cenueshme, duke e rritur ndjeshëm borxhin publik.

Tregu i punës u rrit në vitin 2021, duke e rifilluar trendin në rënie të papunësisë, mirëpo papunësia në rritje e të rinjve (2020-2021) mbeti një çështje shqetësuese. Reforma e fundit e tregut të punës e përcaktoi të dielën si ditë jo pune, ndërkohë që u intensifikuan presionet për rritjen e pagës minimale. Rritja e inflacionit dhe kriza energjetike në fund të vitit 2021 ishin ndër sfidat kryesore ekonomike lidhur me ndikimin që e kanë për standardin e jetesës në vend.


Vendi është prekur rëndë nga pandemia KOVID-19. Dy valët e fundit në 2021 e ngarkuan edhe më tej kapacitetin e sistemit shëndetësor me zënie të shtretërve spitalorë deri në 90%. Vaksinimi filloi në shkurt të vitit 2021, duke synuar të arrinte 60% të popullsisë deri në fund të vitit 2021, ndonëse pak më pak se 50% të qytetarëve janë vaksinuar.

Sektorët socialë kanë pësuar më së shumti – frekuentimi i arsimit parashkollor ka rënë në 36%, ndërsa fëmijët nuk kanë shkuar në shkollë për 52 javë. Edhe pse, sektori i arsimit arriti të shkonte me shpejtësi nga mësimi përmes internetit dhe ta rivendoste mësimin me prani fizike që në

Normat e rritjes së PBV-së së Maqedonisë së Veriut shkalla vjetore e rritjes 2012-2022



2021 shkalla vjetore e rritjes




Source: SSO, 2022

vitin 2021, megjithatë ndikimi në rezultatet e të nxënit dhe shëndetin mendor mbetet i paqartë. Shkalla e vaksinimit të fëmijëve është ulur në nën 90%, ndërsa shkalla e vdekshmërisë neonatale është rritur në 4.2 për 1000 lindje të gjalla. Pavarësisht sfidave, prapëseprapë në vitin 2021 kanë vazhduar reformat e rëndësishme sociale.

Reforma e mbrojtjes sociale, e plotësuar me masa shtesë, rezultoi në shpërndarje më adekuate të përfitimeve në para, duke kontribuar në uljen e lehtë të shkallës së varfërisë në 21.6 në vitin 2019, me përjashtim në kategorinë e grave mbi 25 vjeç ku shënohet rritje të varfërisë. Varfëria relative e fëmijëve u rrit nga 27.8% para pandemisë në 32.4% vitin e kaluar. Mbi 488,000 njerëz në vend jetojnë në varfëri. Indeksi i zhvillimit njerëzor ka shënuar rritje të vogël.


Labour market trends, 2012-2021



Source: SSO, 2022

Indikatorët kryesor socio ekonomik, 2012-2021

Viti bazë kundrejt vlerës së fundit të disponueshme




Burimet: ZSHS, PNUD, ISHP, MEPP, Banka Botërore

Indeksi i parë shumëdimensional i varfërisë së fëmijëve në vend tregoi se janë të prekur 12% e fëmijëve të moshës 5 deri në 17 vjeç dhe 9% e fëmijëve nën 5 vjeç. Fëmijët romë ishin dukshëm më të cenueshëm: një në tre fëmijë romë përjetuan varfëri shumëdimensionale krahasuar me një në nëntë në popullatën e përgjithshme. Privimet në arsim, zhvillimi të hershëm të fëmijëve, ushqim, siguri, dashuri dhe kujdes ishin ndër pesë kontribuuesit kryesorë në varfërinë e fëmijëve, duke sinjalizuar fushat ku ishte më i nevojshëm përmirësimi i shpërndarjes së financave publike dhe ofrimit të shërbimeve.

Shpallja e Malit Sharr si Park i ri Nacional, premtimi ambicioz i vendit për reduktimin për 51% të emetimeve të gazeve serrë (GS) dhe njoftimet për investime të konsiderueshme në kapacitete të reja të energjisë së rinovueshme ishin arritjet kryesore të vitit 2021, ndonëse pjesërisht janë shtyrë për shkak të sfidave me sigurimin e furnizimit të mjaftueshëm të energjisë elektrike për shkak të sistemit të vjetruar të prodhimit të energjisë në vend, kryesisht të bazuar në qymyr. U paralajmëruan disa investime të konsiderueshme në burimet e rinovueshme – pesë parqe të reja ose të zgjeruara me erë, dy termocentrale diellore dhe një pjesë e madhe e ndërlidhjes së energjisë elektrike midis Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë. Zona nën mbrojtje është rritur ndjeshëm, ndonëse mbrojtja e liqeneve, veçanërisht atë të Pespës dhe Ohrit, mbetet një nevojë kritike.

Ka pasur disa zhvillime pozitive në përmirësimin e trajtimit të ujërave të zeza, mirëpo qytetet kryesore, përfshirë Shkupin mbeten të pambuluara. Në lidhje me mbetjet e ngurta, është bërë përparim i kufizuar në periudhën 2020-2021, me

Varfëria shumëdimensionale e fëmijëve për rajon



Burimi: UNICEF/FinanceThink (2021), Varfëria shumëdimensionale e fëmijëve në Maqedoninë e Veriut


përjashtim të nivelit të planifikimit të politikave dhe shpalljes së impianteve të klasifikimit dhe përpunimit të mbetjeve në rajonin Lindor dhe atë Verilindor.

Kanë ngelë sfidat në qasjen sistematike për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vend, duke përfshirë parashikimin dhe adresimin e sfidave globale. Ndërkohë, rivitalizimi i aktivitetit ekonomik dhe moti i ftohtë sërish rezultuan me ndotje të lartë të ajrit në qytetet e mëdha, veçanërisht në Shkup.

Vendi gjendet përgjatë njëres prej rrugëve kryesore për lëvizjet e përziera të migracionit drejt Evropës, gjë që rezultoi në më shumë se 20,874 kalime të parregullta kufitare të zbuluara në vitin 2021, kryesisht nga Pakistani, Afganistani, Siria dhe vende të tjera. Emigrantët mbetën jashtëzakonisht të cenueshëm, shpesh duke udhëtuar në grupe të mëdha të ekspozuara ndaj rreziqeve të shumta. Punëtorët sezonalë nga radhët e migrantëve nga Maqedonia e Veriut, të vlerësuar midis 40,000 dhe 100,000, mbetën të prekur nga kufizimet e udhëtimit për shkak të KOVID-19, duke ndikuar

Rrjedha e përzier e migracionit në Maqedoninë e Veriut 2016-2021

2021 flukset vjetore të migracionit, arrijtjet e reja



Source: UNHCR (2022), Government of North Macedonia

në remitancat dhe duke e reduktuar mbështetjen për familjet e lëna në vend. Autoritetet e zhvilluan një "Strategji pesëvjeçare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Migrimit të Paligjshëm" dhe vazhduan ta luftojnë krimin e organizuar ndërkufitar. Në vitin 2021, rastet e kontrabandës së emigrantëve të zbuluar u ulën për 33% krahasuar me vitin paraprak . 91 persona janë përndjekur për 64 raste të kontrabandës.

Mbështetja e sistemit të zhvillimit të OKB-së për prioritetet e zhvillimit nacional

Kjo pjesë e thekson kontributin dhe rezultatet e OKB-së për Maqedoninë e Veriut për vitin 2021 dhe rezultatet nga puna me partnerët në katër fusha – prosperiteti gjithëpërfshirës, shërbimet cilësore për të gjithë, mjedisi i shëndetshëm dhe qeverisja e mirë.

Pasqyra e përgjithshme e KBZHQ-së

KBZHQ 2021-2025 u konsultua gjerësisht gjatë hartimit të këtij dokumenti. Nëpërmjet zbatimit të tij, OKB-ja dhe partnerët i adresojnë tre prioritetet strategjike nacionale dhe synojnë të kontribuojnë në katër rezultatet e synuara.

Duke u mbështetur në traditën e fortë të punës së OKB-së në Maqedoninë e Veriut, KBZHQ e mbështet kalimin nga zbatimi i drejtpërdrejtë drejt një mbështetjeje më të synuar të OKB-së, si një mundësues dhe ofrues i këshillave paraprake të politikave, inovacionit dhe ekspertizës. Më shumë fokus i kushtohet zhvillimit të qëndrueshëm urban, duke trajtuar çështje të tilla si ndotja e ajrit dhe duke e rritur rëndësinë e shëndetit dhe arsimit.

Veprimi i OKB-së bazohet në prova, gjë që kërkon kapacitete të forcuara statistikore, mbledhje më të mirë të të dhënave të ndara dhe përmirësim të koordinimit dhe ndarjes së informacioneve në të gjitha nivelet. Të gjitha aktivitetet kryhen së

bashku me autoritetet nacionale dhe lokale, shoqërinë civile, sektorin privat, partnerët ndërkombëtarë dhe palët tjera.

Programet e promovojnë barazinë gjinore, angazhimin qytetar të të rinjve, ndërtimin e besimit dhe mundësitë e barabarta për të gjithë për t'i realizuar të drejtat e tyre njerëzore dhe potencialin e plotë. Duke pranuar se njerëzit nuk janë marrës pasivë të shërbimeve, por agjentë ndryshimi, ndërhyrjet e OKB-së e mbështesin transformimin shoqëror për një qasje më aktive dhe më të përgjegjshme individuale dhe të komunitetit ndaj zhvillimit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

Nënkategoritë e mëposhtme e pasqyrojnë në detaje kontributin e OKB-së në rezultatet e zhvillimit në vitin e parë të zbatimit të KBZHQ-së.

OZHQ	PRIORITETI STRATEGJIK	REZULTATET DERI NË VITIN 2025	PRIORITETET E QEVERISË
PROSPERITETI DHE NJERËZIT	Zhvillimi i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës ekonomik dhe shoqëror	<p>(1) Standardi i jetesës së të gjithë njerëzve në Maqedoninë e Veriut është përmirësuar përmes qasjes së barabartë në punë të denjë dhe punësimit produktiv të gjeneruar nga një ekosistem biznesi gjithëpërfshirës dhe inovativ.</p> <p>(2) Njerëzit në Maqedoninë e Veriut kanë qasje universale në shërbime sociale cilësore të bazuar në të drejtë; qasje në kujdes shëndetësor, arsim dhe mbrojtje të nevojshme sociale dhe mbrojtje të fëmijëve, të rrënjësura në sisteme të rezistueshme ndaj situatave emergjente.</p>	<p>Negociatat e suksesshme të anëtarësimit në BE</p> <p>Rritja e qëndrueshme ekonomike, standardi më i lartë i jetesës dhe cilësia e jetës së qytetarëve</p> <p>Kujdes për të gjithë: Investime në kujdesin shëndetësor dhe menaxhim efikas të pandemisë KOVID-19</p> <p>Reformat e sistemit arsimor</p> <p>Një shoqëri për të gjithë</p>
PLANETI	Veprimi i klimës, burimet natyrore dhe menaxhimi i rrezikut nga katastrofat	<p>(3) Njerëzit në Maqedoninë e Veriut përfitojnë nga veprimet ambicioze të klimës, burimet natyrore të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme dhe biodiversitetit, të ruajtura mirë përmes menaxhimit të mirë të mjedisit jetësor dhe nga bashkësitë e rezistueshme ndaj katastrofave.</p>	<p>Mbrojtja e mjedisit</p> <p>Zhvillimi i gjelbër</p> <p>Reduktimi i ndikimit të ndryshimeve klimatike</p> <p>Reduktimi i ndotjes së ajrit</p>
PAQJA	Qeverisja demokratike transparente dhe e përgjegjshme	<p>(4) Njerëzit në Maqedoninë e Veriut përfitojnë nga sundimi i përmirësuar i ligjit, politikat e bazuara në prova, të parashikueshme, që i përgjigjen gjinisë; nga kohezioni më i madh shoqëror; dhe ofrimi efektiv i shërbimeve nga institucionet transparente, llogaridhënese dhe të përgjegjshme</p>	<p>Qeverisje demokratike, transparente dhe të përgjegjshme</p> <p>Reforma në sektorin e administratës publike dhe drejtësisë</p> <p>Lufta kundër korrupsionit</p>

Prioriteti strategjik 1: Zhvillimi i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës ekonomik dhe social



Rezultati 1: Prosperitetet gjithëpërfshirës

Në vitin 2021, OKB-ja punoi drejt rritjes së prosperitetit gjithëpërfshirës duke krijuar **mbi 1,000 vende pune** (653 për gratë, 391 për të rinjtë) dhe duke e mbështetur **Garancinë për Rininë**, me çka kanë rezultuar **6,822 vende të reja pune për të rinjtë**.

Në kuadër të krizës së zgjatur të COVID19, u ofruan **shërbime këshillimore dhe të digjitalizuara për 500 kompani** për ta forcuar qëndrueshmërinë, ndërsa Agjencia e Punësimit (AP) u fuqizua për të ofruar këshilla të digjitalizuara për personat e papunë. Njashtu u krijuan rreth **72 biznese fillestare** (20 nga personat me aftësi të kufizuara (PAK)), kurse **306 persona u rikualifikuan përmes Qendrës së Trajnimit të Aftësive të Ardhshme (SkillsNet)**. Një **model i zhvillimit të aftësive të realitetit virtual** është krijuar dhe zbatuar në pesë shkolla të mesme profesionale.



Një trajnim për instaluesit e paneleve fotovoltaike në qendrën SkillsNext të mbështetur nga UNDP në Tetovë. Qendra ofron shërbime trajnimi të dizajnuara për përgatitje të fuqisë punëtore të vendit për punë të reja dhe të ardhshme. Fotografia: UNDP

Grupe e fuqizuara nga OKB, të cilat kanë vështirësi për të gjetë punë: **900 persona** e përfunduan të paktën një program të të mësuarit të aftësive, ndërsa **474 persona përfituan nga aktivizimi i punësimit dhe shërbimet mbështetëse**. Shërbimet e reja sociale janë ofruar në 46 komuna përmes **Programit të punëve në komunitet, duke përfshirë 8,560 persona**. Mbështetje iu dha edhe **refugjatëve**, për fat të keq asnjë prej tyre nuk u punësua zyrtarisht në vitin 2021.

Janë mbështetur dokumentet dhe ligjet kryesore të

politikave për punësimin dhe punën, arsimin e të rriturve, bujqësinë dhe zonat e zhvillimit rural, ndërsa komponenti gjinor është integruar brenda prioritetëve strategjike. Me mbështetjen e

OKB-së, **Këshilli Ekonomik dhe Social (ESC)** ngeli një forum i rëndësishëm për dialogun social, ndërsa partnerët social ofruan shërbime dhe mjete të reja digjitale për anëtarët e tyre. Mekanizmi për raportimin e shkeljes së të drejtave të punës përmes internetit rezultoi me mbrojtje ligjore për më shumë se 3,000 punëtorë.

OKB-ja mbështeti rreth 2,500 fermerë/pronarë të vegjël përmes përpjekjeve aktive për **konsolidimin e tokës dhe kontribuoi në konsolidimin e 1,078 hektarëve tokë bujqësore**, duke e mbështetur paralelisht zhvillimin e integruar të komunitetit. **Mbështetja për gratë fermere u rrit nga 100 në 250**, ndërsa përafrimi me BE-në u rrit në menaxhimin e shëndetit të kafshëve dhe sigurinë e ushqimit.



Rezultati 2: Shërbime cilësore për të gjithë

OKB-ja dhe partnerët vazhduan ta mbështesin Ministrinë e Shëndetësisë në **zbatimin e reformës së sistemit shëndetësor mbi parimet e të drejtave të njeriut** të vënë në fokus qendror. Fokusi ishte në kujdesin primar shëndetësor dhe shëndetin e nënës dhe fëmijës, transformimin e infermierisë në një fuqi punëtore të vlerësuar shëndetësore, përmirësimin e disponueshmërisë së ilaçeve, afrimin e shërbimeve më afër njerëzve dhe përgatitjen e sistemit shëndetësor për imunizime në shkallë të gjerë. Gjithashtu OKB-ja ka ndihmuar në **mirëmbajtjen e shërbimeve thelbësore shëndetësore gjatë krizës COVID-19, duke përfshirë futjen e shërbimeve gjinekologjike të lëvizshme (mobile)** në zona të vështira për t'u arritur; prokurimin e pajisjeve mjekësore dhe atyre mbrojtëse personale, parandalimin e kancerit të qafës së mitrës, planifikimin familjar, digjitalizimin në sistemin shëndetësor dhe ngritjen e kapaciteteve të fuqisë punëtore të kujdesit shëndetësor



Zona e konsoliduar e tokës në Egri (Komuna e Manastirit) – para dhe pas konsolidimit të tokës. Me konsolidimin e tokës, numri i parcelave të tokës në Egri u reduktua pothuajse katërfish, nga 874 parcela në 260. Tani 214 pronarët e tokave kanë parcela më të mëdha, në formë të rregullt që mundësojnë praktika më të mira bujqësore. Madhësia mesatare e parcelës tani është 1.30 hektarë, krahasuar me mesataren vetëm 0.38 hektarë para konsolidimit të tokës. Fotografia: FAO

6,822 VENDE TË REJA TË PUNËS JANË KRIJUAR me mbështetjen e OKB-së në vitin 2021

YOUTH NUMRI I TË RINJVE TË PAPUNË, JASHTË PROCESIT ARSIMOR DHE QË NUK NDJEKIN TRAJNIM KA SHËNUAR RËNIE prej 24.5 (2019) në 24.2 (2021)

për t'iu përgjigjur më mirë sfidave të COVID-19.

Me mbështetjen e OKB-së për Planin nacional të shpërndarjes së vaksinave kundër COVID-19, vendi arriti shkallën e vaksinimit në pothuajse 50%, duke administruar mbi 1.5 milion doza vaksinash në më pak se një vit. 523,012 doza të vaksinave kundër COVID-19 u prokuruan përmes mekanizmit të prokurimit KOVAKS të menaxhuar nga OKB-ja (28% e të gjitha dozave të administruara).


Me mbështetjen dhe përkrahjen e OKB-së, të gjitha shkollat u rihapën në shtator, pas një ndër periudhave më të gjata të mbylljes së shkollave në mbarë botën. **Koncepti i ri për arsimin fillor** vendosi ndryshime thelbësore, duke inkorporuar ndryshimet klimatike, përmbajtjen dhe qasjet transformuese dhe gjithëpërfshirëse gjinore. **Platforma Eduino** u bë strumbullari i vetëm më i madhe i burimeve arsimore të verifikuara në mënyrë zyrtare. Prezantimi në nivel nacional i **Programit inovativ të të mësuarit social dhe emocional (MSE)** u përfundua në të gjitha entet parashkollore publike, duke trajnuar pothuajse të gjithë edukatorët aktivë të kopshteve dhe enteve tjera parashkollore. Mbështetja për arsimin gjithëpërfshirës vazhdoi me transformimin e shkollave të specializuara në qendra burimore, për të ofruar mbështetje për shkollat e zakonshme dhe asistencë arsimore sipas nevojës. Njashtu u arrit marrëveshje për një partneritet të ri për pilotimin dhe shtrirjen e edukimit gjithëpërfshirës seksual në nivel nacional deri në vitin 2025.

Janë bërë përmirësime në sistemet funksionale të vlerësimit për fëmijët dhe të rinjtë me paaftësi në rajonin e Shkupit, Pellagonisë, atë Juglindor dhe të Pollogut. Paralelisht, janë hartuar ndryshime në ligj për mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve, sigurimin dhe kujdesin shëndetësor dhe arsimin fillor, duke hapur rrugë krijimit të pikave të vetme të hyrjes për fëmijët me aftësi të kufizuara për të pasur qasje në shërbimet mbështetëse.

Me mbështetjen e OKB-së, janë fuqizuar autoritetet qendrore dhe lokale në përfshirjen dhe integrimin e personave nën mbrojtje ndërkombëtare – migrantët, azilkërkuarit dhe refugjatët. Është krijuar një mekanizëm efektiv mbështetës për integrimin e refugjatëve dhe janë përditësuar dokumentet

kryesore strategjike nacionale. OKB-ja vazhdoi t'i mbështesë përpjekjet sistematike për zgjidhjen e regjistrimit civil dhe eliminimin e rasteve në rrezik të pashtetësisë.

Po ashtu është ofruar mbështetje për funksionalizimin e Ligjit të ri për Parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, në përputhje me Konventën e Stambollit. Është mbështetur ndryshimi i Kodit Penal, që do ta përcaktojë si vepër penale dhunën mbi bazë gjinore ndaj grave. Këto do të përmirësojnë ndjeshëm mjedisin rregullator për reagim të zgjeruar multisektorial për t'i parandaluar dhe trajtuar të gjitha format e dhunës ndaj grave. Madje në bashkëpunim me shoqërinë civile ka vazhduar mbështetja e drejtpërdrejtë për gratë viktime të dhunës.



Prioriteti strategjik 2: Veprimi i klimës, burimet natyrore dhe menaxhimi i rrezikut nga katastrofa



Rezultati 3. Mjedis i shëndetshëm

Progres i rëndësishëm është arritur në fushën e politikës mbi ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e resurseve natyrore, mirëpo më pak progres është shënuar për sa i përket trajtimit të ujërave të zeza, menaxhimit të mbeturinave të ngurta, ndotjes së ajrit dhe zvogëlimit të rrezikut nga



fatkeqësitë.

Me mbështetjen e OKB-së, Mali Sharr është shpallur park i ri nacional, duke e rritur pas disa dekadash rritjen e zonave të mbrojtura (ZM) në katër parqe nacionale. Me zonat e mbrojtura në anën e Shqipërisë dhe Kosovës*, ai është bërë një nga zonat më të mëdha të mbrojtura ndërkufitare në Evropë. Zona nën mbrojtje është rritur në 30% në vitin 2020 dhe 2021, krahasuar me vitin 2019, dhe tani shtrihet në 13.5% të territorit të vendit ose 81 zona të mbrojtura, duke forcuar ruajtjen afatgjatë të natyrës dhe biodiversitetit. Kjo rritje paraqet gjithashtu një progres prej 67% në përmbushjen e objektivit të përgjithshëm.



Në krye të konferencës mbi ndryshimet klimatike (COP26), vendi e forcoi ndjeshëm angazhimin e tij për ndryshimet klimatike. OKB-ja ishte mbështetësi kryesor i këtyre përpjekjeve, nëpërmjet zhvillimit të politikave, qasjes në financa, rritjes së ndërgjegjësimit dhe përkrahjes, dhe integrimin të ndryshimeve klimatike në fusha të ndryshme. Në prill të vitit 2021, qeveria e miratoi Kontributin e Përcaktuar Nacional (eKNP) të zgjeruar në Marrëveshjen e Parisit për Klimën, duke vendosur një objektiv nacional

ambicioz për ta arritur **reduktimin e emetimeve të gazeve serrë (GHG) për 51% deri në vitin 2030** ose 82% reduktim të emetimeve neto në krahasim me nivelet e vitit 1990. Ky ishte angazhimi më ambicioz i vendeve të Ballkanit Perëndimor. Reduktimi do të arrihet nëpërmjet zbatimit të Skenarit të Zbutjes së Gjellbër nga Strategjia Nacionale për Zhvillimin e Energjisë deri në vitin 2040, e cila është pasuruar me politika dhe masa në sektorët e industrisë, bujqësisë,

pylltarisë, përdorimit të tokës dhe sektorët mbeturinave.

Duke vënë në dukje se viti 2021 ishte viti i parë i KBZHQ-së, janë nisur aktivitete të rëndësishme në fushën e **reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë, veçanërisht në reduktimin e rrezikut nga përmytjet, ndotjet e ajrit dhe largimit të mbetjeve të rrezikshme.**

Prioriteti strategjik 3: Qeverisja demokratike transparente dhe e përgjegjshme



Rezultati 4: Qeverisja e mirë

Maqedonia e Veriut vazhdoi t'i përmbushë prioritetet kryesore të reformës për anëtarësimin në BE dhe përmbushjen e agjendës së vitit 2030. Mbështetja e OKB-së nxiti reforma sistematike, të cilat e avancojnë qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit, qasjen në drejtësi, kohezion më të madh social dhe bashkëpunim në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ndryshimet transformuese u iniciuan nga një politikëbërje me shikim përpara, parashikuese dhe të bazuar në dëshmi në shumë sektorë. OKB-ja mbështeti qeverinë në zhvillimin e një metodologjie gjithëpërfshirëse dhe inovative, që e mundëson qasjen e të gjithë shoqërisë në formulimin e **Strategjisë së parë Nacionale të Zhvillimit (SNZH)** për dy dekadat e ardhshme.

OKB-ja njashtu kontribuoi edhe në agjendën rregullatore ambicioze të qeverisë. Ligjet dhe politikat nacionale janë përafëruar me legjislacionin e BE-së dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Ky përkushtim rezultoi me **21 politika dhe 98 ligje dhe akte nënligjore të hartuara dhe të rishikuara**, të cilat mes tjerash e mbulojnë gjyqësorin, rishikimet e ligjit civil dhe penal, drejtësinë për fëmijët, barazinë gjinore, dhunën me bazë gjinore, kompensimin e viktimave, mbrojtjen ndërkombëtare dhe trajtimin e pashtetësisë, luftën kundër korrupsionit. U miratuan një **Politikë gjithëpërfshirëse e migracionit 2021-2025** dhe një Plan veprimi, së bashku me Profilin e vendit për migracionin.

OKB-ja i forcoi institucionet qeverisëse llogaridhënëse, gjithëpërfshirëse dhe transparente, të afta për të ofruar shërbime të ndjeshme ndaj gjinisë, moshës dhe aftësisë së kufizuar, në të gjitha nivelet. Po ashtu u forcuan **kapacitetet e 1799 partnerëve shtetërorë dhe joshtetërorë**, përfshirë **694 persona të marginalizuar**. Parlamentarët, zyrtarët e qeverisë dhe administrata i avancuan njohuritë e tyre,

në veçanti mbi procesin e anëtarësimit në BE, aftësitë negociuese, dhe lokalizimin e OZHQ-ve. Perspektiva gjinore u përfshi në programet dhe buxhetet sektoriale të 13 ministrive dhe 31 komunave. Decentralizimi fiskal u avancua përmes sistemit elektronik të pagesave për taksat, Indeksit të përditësuar të zhvillimit komunal dhe Programin ri për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe decentralizim 2021-2026.

98

LIGJE
DHE AKTE

NËNLIGJORE TË
ZHVILLUARA
me mbështetjen
e OKB-së

Angazhimi dhe pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqërisë civile është përmirësuar përmes zgjidhjeve digjitale. OKB-ja e promovoi dialogun gjithëpërfshirës dhe kohezionin e komuniteteve të ndryshme, veçanërisht i fuqizoi gratë, të rinjtë dhe grupet e cenueshme – **3,300 gra iu bashkuan iniciativave mbështetëse dhe informuese lokale, ndërsa 1,000 të rinj u angazhuan në imagjinimin dhe krijimin e përbashkët të së ardhmes së tyre.**


Në këtë vazhdë OKB-ja e mbështeti, ndërsa Enti Shtetëror i Statistikës (ESH) e drejtoi Strategjinë e Komunikimit të Regjistrimit të vitit 2021, që e nxiti procesin e mbledhjes së të dhënave. Hulumtimi analitik mbi ndikimin socio-ekonomik të KOVID-19 tek fëmijët, gratë, viktimat e dhunës dhe njerëzit e tjerë të cenueshëm në komunitetet rurale e formësoi përgjigjen dhe rimëkëmbjen, i ndjekur nga fushatat avokuese, që i synojnë shkaqet rrënjësore. Mbështetja e OKB-së në zhvillimin e **Strategjisë për Konfiskimin (Rikuperimin) e Pasurive dhe Udhërrëfyesit kundër Korrupsionit** për Ballkanin Perëndimor, së bashku me kapacitetet e zgjeruara të praktikuesve të drejtësisë penale, mundësoi reagim më efektiv dhe bashkëpunim ndërkufitar kundër krimit të organizuar.



OKB-ja e mbështeti qeverinë në zhvillimin e një metodologjie gjithëpërfshirëse dhe inovative, që mundëson qasjen e të gjithë shoqërisë në formulimin e Strategjisë së parë Nacionale të Zhvillimit (SNZH) për dy dekadat e ardhshme.

2021 SDCF contribution to gender equality and human rights % of budgeted resources across all SDCF outcomes

■ No contribution ■ Limited contribution ■ Significant contribution ■ HR / gender primary focus



Rezultatet e vitit 2021 sipas prodhimeve

REZULTATI 1

Prosperiteti gjithëpërfshirës



Deri në vitin 2025, niveli i jetesës së të gjithë njerëzve në Maqedoninë e Veriut të jetë përmirësuar përmes qasjes së barabartë në punë të denjë dhe punësimin produktiv të gjeneruar nga një ekosistem biznesi gjithëpërfshirës dhe inovativ

Kontributet për:



Parimet themelore: Zhvillimi Ekonomik dhe Konkurrenca
19. Politika sociale dhe punësimi;
20. Politika e ndërmarrjeve dhe industriale;
26. Arsimit dhe kultura

Shpenzimet e OKB-së në vitin 2021

\$7,394,489

Partnerët e zhvillimit:

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave; Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Sekretariati për Çështje Evropiane, Agjencia për Punësim; Zyrat Rajonale të Punësimin; Fondi për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik; Sindikatat tregtare; Shoqatat e punëdhënësve, Këshilli Ekonomik dhe Social; Këshillat Vendore Ekonomike dhe Sociale; Shoqatat e fermerëve, Organizatat e prodhuesve, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare - Shkup, Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati Shtetëror i Punës, Sindikatat, Agjencia për kadastër të patundshmërisë, Qendra për punë sociale, Fakulteti i Bujqësisë dhe Shkencave Ushqimore, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Fondi për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik, IZBOR STRUMICA, Këshillat Lokale Ekonomike dhe Sociale të Maqedonisë së Veriut, Shoqata e Juristëve të Rinj Maqedonas, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Komuna e Gostivarit, Komuna e Prilepit, Komuna e Shtipit, Komuna e Manastirit, Komuna Çeshinovë - Obleshevë, Komuna e Dollnenit, Komuna e Shuto Orizarit, Komiteti nacional për luftë kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe luftë kundër terrorizmit, Federata Nacionale e Fermerëve, Agjencia Nacionale për Promovimin e Zhvillimit të Bujqësisë, Këshilli Kombëtar Trepalësh Social dhe Ekonomik, OJQ "SEGA" PRILEP, Ombudsmani, Universiteti i Evropës Juglindore, Inspektorati Shtetëror i Punës, Enti Shtetëror i Statistikës, Zyra e Koordinatorit Nacional luftë për kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe luftë kundër terrorizmit.

PRODHIMI 1.1

Ndërmarrjet e qëndrueshme të krijuara si gjeneratorë të punësimin, punës së denjë dhe inovacioneve përmes zinxhirëve të forcurar dhe vlerave dhe rritjes së kapaciteteve për të adoptuar modele të reja biznesi.

Agjencitë: **ILO, UNDP, UNESCO, UNOPS**

Në vitin 2021, **500 ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)** u mbështetën nga OKB për ndërtimin qëndrueshmërisë dhe për t'u përballë me krizën e zgjatur të KOVID19 përmes **platformës** në internet për mentorimin e biznesit, kryesisht në fushën e marketingut në internet dhe digjital. Gjithashtu, u krijuan **72 biznese të reja**, me 80 vende të reja pune, nga të cilat 28 për personat me paaftësi (PP) dhe 5 prej tyre gra. Në total, me ndërhyrje të ndryshme, OKB-ja ka ndihmuar në **krijimin e mbi 1000 vendeve të punës**, nga të cilat 391 për të rinjtë.

OKB-ja e mbështeti zbatimin e planit të Garancisë për Rininë, që krijoi 6787 vende pune për të rinjtë. Nëpërmjet partneritetit lokal me botën akademike, pushtetin lokal, shoqërinë civile dhe sektorin privat, u krijua **Qendra Rinore e Resurseve** - iCan, e cila ofron punë, mbështetje fillestare dhe inovative për të rinjtë në rajonin e Pollogut.

OKB-ja e pajisi Laboratorin për shkathtësi të realitetit virtual për nxënësit e arsimit dhe aftësimin profesional (APT) në elektrikë dhe elektronikë, si dhe e hartoi një plan-program trajnimi, në konsultim me Organizatën e punëdhënësve të Maqedonisë së Veriut. **Ndërtimi i aftësive "të së ardhmes"** u mundësua përmes **platformës** që i mblodh palët e interesuara për të prezantuar teknologjitë e reja, si dhe **Qendrës së Trajnimit për Aftësitë e së Ardhmes (Rrjeti i Aftësive)**, e themeluar dhe e pajisur plotësisht në Universitetin e Evropës Juglindore (UEJL). Në këtë mënyrë, u zhvilluan **6 standarde të reja profesionale** në burimet e rinovueshme të energjisë, industrisë së tekstilit dhe

ndërtimit dhe **6 programe të reja trajnimi APT**, me **306 persona të trajnuar në aftësitë digjitale**. Tani **Perspektiva profesionale** e përmirësuar përmban profile me 60 profesione.

72
500

BIZNESE TË REJA TË KRIJUARA NË VITIN 2021

KOMPANI TË FORCJUARA ME MBËSHTETJE TË OKB-SË

Zinxhirët e vlerës u forcyan duke e futur teknologjinë e paketimit me atmosferë të modifikuar (PAM) për të zgjatur jetëgjatësinë e produkteve të freskëta bujqësore dhe për ta kontraktuar bujqësinë organike për 30 familje. **Industritë kreative** u promovuan gjithashtu si mundësi ekonomike për të ardhmen.




OKB-ja e pajisi laboratorin e aftësive të realitetit virtual për nxënësit e arsimit dhe aftësimin profesional (APT) në drejtimin e elektrikes dhe elektronikës, si dhe e hartoi një program trajnimi, në konsultim me Organizatën e punëdhënësve të Maqedonisë së Veriut. Fotografia: ILO

PRODHIMI 1.2

Gratë dhe personat vulnerabil/të përjashtuar përfitojnë nga mjedisi mbështetës përmes masave të përshtatura të punësimit dhe sistemit të aftësimimit më dinamik dhe gjithëpërfshirës, që i përgjigjet nevojave të tregut të punës për të gjithë njerëzit.

Agjencitë: **UNDP, ILO, IOM, UNHCR, UNOPS**

Puna e OKB-së është fokusuar në fuqizimin ekonomik të grupeve të cenueshme, në përputhje me parimin e saj qendror për të mos lënë askënd pas: në këtë drejtim u krijuan 1000 vende pune – **653 për gratë, 52 për romët dhe 42 për PP-të**, kryesisht përmes Programit të Punëve në Komunitet që ofroi shërbime sociale për 8560 përfitues.



Duke pasur parasysh se aktivitetet e panjohura të kujdesit ndërmerren kryesisht nga **gratë**, OKB-ja asistoi në hartimin dhe zbatimin e dy masave të reja të punësimit në **ekonominë e kujdesit**, me vlerë prej 1.3 milionë dollarë. Më shumë se **300 gra, nga të cilat 70% janë të reja**, u trajnuan në Qendrën e Resurseve Rinore. Kryesisht trajnimi kishte të bëjë me marketingun digjital.

Disa ndërhyrje në nivel politikash i trajtuan boshllëqet strukturore në kornizën ligjore **për përfshirjen e personave më aftësi të kufizuar në tregun e punës**. Njashtu u iniciua



Një nga 50 të rinjtë romë nga Prilepi do të punësohet në vitin 2021 me mbështetjen e programit Acceдер të zbatuar nga UNDP. Fotografia: UNDP

një program për ngritjen e kapaciteteve të organizatave të personave më aftësi të kufizuar (OPAK) dhe u mbështetën tri qendra të pushimit për personat me aftësi të kufizuar, së bashku me qendrat Reha në Shkup dhe Strumicë.

OKB-ja punoi me njerëz që kanë vështirësi të gjejnë punë, duke iu mundësuar 900 personave ta përfundojnë të paktën një program të të mësuarit të aftësive, prej të cilëve mbi 70% ishin gra. 474 persona përfituan nga shërbimet e aktivizimit dhe mbështetjes së punës, nga të cilët 206 romët dhe 150 persona me aftësi të kufizuar. Përfundimi i arsimit fillor ishte në dispozicion për 67 të burgosur (16 femra) dhe 12 të mitur. Pavarësisht përpjekjeve për ta lehtësuar njohjen adekuate të aftësive profesionale dhe njohurive të specializuara të refugjatëve dhe për t’iu siguruar atyre qasje në punësim, asnjëri prej tyre nuk u punësua zyrtarisht në vitin 2021.

Në nivel lokal, Plani Lokal i Punësimit u pilotua në Manastir,

duke krijuar 35 vende pune përmes Qendrës Komunale të Startup-it, si dhe u nënshkruan memorandume mirëkuptimi me tri komuna për ri integrimin e të kthyerve, duke u bazuar në vlerësimin e cenueshmërive të tyre.



PRODHIMI 1.3

Masat rregullatore të zgjeruara dhe të përgjegjshme ndaj gjinisë, që e nxisin sipërmarrjen dhe financimin për një rritje gjithëpërfshirëse dhe të gjelbër.

Agjencitë: **FAO, ILO, IOM, UNDP, UNECE**

OKB-ja e mbështeti hartimin e dokumenteve të politikave, ligjeve, masave dhe



strategjive, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Punës (SNP) dhe legjislacionin e BE-së.

Me mbështetjen e OKB-së u zhvillua dhe u miratua **Strategjia e re Nacionale e Punësimit (SNP) 2021-2027** me Planin e ri të veprimit për punësimin 2021-2023 dhe me **Planin e punës për perspektivat profesionale 2022-2026**. OKB-ja gjithashtu kontribuoi në hartimin e **Strategjisë së parë Nacionale për Zhvillimin e Ndërmarrjeve Sociale (2021-2027)**, të miratuar në vitin 2021.

Ligji për marrëdhëniet e punës u ndryshua për t’i adresuar realitetet e reja në tregun e punës; **Ligji për punësim dhe sigurime** u ndryshua, me qëllim që t’i përcaktojë instrumentet për modelin e kontraktimit social dhe ofrimin efikas të shërbimeve të standardizuara dhe të licencuara për personat me paaftësi; **Ligji për arsimin e të rriturve** për të promovuar arsimin gjithëpërfshirës dhe **Ligji për shitjen e tokës bujqësore shtetërore** për ta kthyer tokën bujqësore në pronësi shtetërore në funksion të zhvillimit bujqësor dhe prodhimit të ushqimit.

Institucionet u mbështetën për të ofruar **shërbime onlajn për të papunët**, së bashku me këshilltarët e trajnuar për biznes dhe karrierë të Agjencisë për Punësimi, dhe për të hartuar **shërbime të reja sociale**, d.m.th masat e ekonomisë së kujdesit në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS). Në përgjigje të KOVID-19 dhe goditjeve të tjera të mundshme, OKB-ja e forcoi kapacitetin institucional në **sistemet e informacioneve të çmimeve dhe tregut të monitorimit të politikave për mallrat ushqimore dhe zinxhirët e vlerës**. Ngritja e kapaciteteve u siguroi përmes projektit rajonal që synon rritjen e kapaciteteve të ekonomive të Ballkanit Perëndimor për t’i zbatuar **masat lehtësimi të tregtisë dhe të platformës dritare e vetme**.

STRENGTHENING SOCIAL DIALOGUE

This project is funded by European Union, and implemented by the International Labour Organization.

Këshilli Ekonomik dhe Social është ripozionuar si një aktor i rëndësishëm në zhvillimin e politikave ekonomike, të punës dhe sociale me mbështetjen e OKB-së. Fotografia: ILO

Me [mbështetjen](#) e OKB-së, Këshilli Ekonomik dhe Social (KES) u ripozicionua si një aktor i rëndësishëm në zhvillimin e politikave ekonomike, të punës dhe sociale. **Dymbëdhjetë përfaqësitë vendore të Agjencisë për Punësim** u pajisën me analiza të tregut të punës dhe dukshmëri të zgjeruar përmes [platformës](#) së komunikimit. Po ashtu u zhvilluan **Planet Lokale të Veprimit për Punësim** në Strumicë dhe Kumanovë. Partnerët social e zgjeruan numrin e shërbimeve digjitale dhe ligjore të ofruara për anëtarët, gjë që rezultoi me rritjen e anëtarësimit.

PRODHIMI 1.4

Përmirësimi i cilësisë së punësimit përmes zvogëlimit të nivelit të pamjaftueshëm të punësimit, punës joformale dhe mbrojtjes adekuate në punë në përputhje me standardet ndërkombëtare të punës.

Agjencitë: **ILO**

OKB-ja vazhdoi të trajtojë nivelin e ulët të punësimit, punës joformale dhe mbrojtjen në punë, duke e mbështetur **Strategjinë për Formalizimin e Ekonomisë Joformale** me [platformën](#) e sektorit të hoteleve, restoranteve dhe kafeneve (HORECA), të zhvilluar në partneritet me Shoqatën e punëdhënësve në hoteleri dhe shërbime ushqimore (HOTAM).

3,000 WORKERS RECEIVED LEGAL PROTECTION AND ADVICE with UN support

Bazuar në analizën e mangësive të OKB-së dhe produktet për [ritjen e ndërgjegjësimit](#), Këshilli Ekonomik dhe Social (KES) e mbështeti planin për ratifikimin e **Konventës 190 të ILO-s mbi Dhunën dhe Ngacmimin dhe Udhëzuesin mbi Dhunën dhe Ngacmim** në vitin 2022. Janë zhvilluar dy fushata të ndërlidhura, "[Puna ime, të drejtat e mia!](#)" dhe "[Kujdesuni për Stafin tuaj!](#)". Këshilltarja virtuale për **ndihmë juridike**, Cindy, u vu në dispozicion përmes faqes së internetit të Federatës së Sindikatave Tregtare (FST) dhe [aplikacionit celular](#) për t'i raportuar shkeljet e të drejtave të punëtorëve, duke siguruar mbrojtje ligjore dhe këshilla për 3000 punëtorë. **Materialet mësimore** të zhvilluara nga OKB-ja **Youth Rights@Works**, të miratuara nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit, u përdorën për trajnim të 500 nxënësve të shkollave të mesme në 12 qytete.

PRODHIMI 1.5

Politikat dhe kapacitetet e forcuara për ekonomi rurale të qëndrueshme dhe konkurruese në përputhje me BE-në, me fokus në fermat e vogla dhe gratë fermerë

Agjencitë: **FAO, UN WOMEN**



U bënë përpjekje për ta rritur konkurrueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e ekonomisë rurale, duke u fokusuar në konsolidimin e tokës dhe mundësitë për gratë dhe fermerët e vegjël.

Konsolidimi i tokës bujqësore është avancuar në tetë zona të konsolidimit të tokave, me çka kanë përfituar 2,455 pronarë tokash bujqësore. Ky proces është finalizuar në dy fshatra, [Egri](#) dhe [Dabjani](#), me **1,078 hektarë të konsoliduar**, duke rezultuar në një reduktim pothuajse katër dhe pesëfish të parcelave të tokës.

2,455 LANDOWNERS BENEFITED FROM LAND CONSOLIDATION in 2021

250 WOMEN AGRICULTURE PRODUCERS supported

Mbështetur nga OKB-ja, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU) i përfshiu perspektivat gjinore në Strategjinë e re Nacionale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2021-2027, si dhe ofroi [mbështetje financiare për 250](#) gra prodhuese bujqësore.



Përfaqësues nga Federata Nacionale e Fermerëve dhe gratë prodhuese bujqësore i prezantojnë produktet e tyre gjatë manifestimit për grante të grave prodhuese bujqësore të regjistruara, të organizuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe Qeveria e Maqedonisë së Veriut. 7 maj 2021, Siti Park, Shkup. Fotografia: UN Women

Gjithashtu MBPEU ka marrë udhëzime të politikave të bazuara në prova për përafrimin e skemës nacionale të pagesave të drejtpërdrejta me rregulloret e Politikës së Përbashkët Bujqësore (PPB) të BE-së dhe trajnime të specializuara për 40 këshilltarë nacional të zgjerimit dhe personelin e MBPEU-së mbi mbledhjen e të dhënave dhe llogaritjen e kostos së marzhit bruto të prodhimit për dhjetë mallra bujqësore. Investimet në shkallë të vogël në gjashtë fshatra e promovuan [zhvillimin e integruar të komunitetit lokal](#).

REZULTATI 2

Shërbime cilësore për të gjithë



Deri në vitin 2025, njerëzit në Maqedoninë e Veriut kanë qasje universale në shërbime sociale cilësore të bazuar në të drejta, si kujdesi shëndetësor, arsimit dhe mbrojtje e nevojshme sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve, të rrënjësura në sisteme të qëndrueshme ndaj situatave emergjente

CKontributi për



Grupi 2, Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorëve dhe shëndetit
Grupi 3, Kapitulli 19: Politika Sociale dhe Punësimi; Kapitulli 25: Shkencë dhe hulumtimi, Kapitulli 26: Arsimit dhe kulturë

Shpenzimet e OKB-së në vitin 2021

\$9,967,640

Partnerët e zhvillimit:

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Arsimit dhe Shkencës; Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Enti Shtetëror i Statistikës, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Instituti Shtetëror i Shëndetësisë Publike, Komunitat, Institutet e formimit profesional; Sindikata e punëtorëve shëndetësorë; Shoqëria civile; bota akademike; sektori privat; Shoqata për Hulumtim, Komunikim dhe Zhvillim, Qendra Nacionale e Romëve, Qendra për Kërkim dhe Krijim Politikash, organizata të shoqërisë civile (OSHC), Drejtoria e Shëndetit Elektronik, Shoqata për Arsim dhe Kërkim Shëndetësor, Fondi për Sigurim Shëndetësor, Projekti Opsionet e Shëndetit Shkup, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Shoqata e Juristëve të Rinj Maqedonas, Fakulteti i Mjekësisë Shkup, Qendrat Komunale për Mirëqenie Sociale (QKMS), shoqatat profesionale,

PRODHIMI 2.1

Sistemi shëndetësor është forcuar për të siguruar qasje universale në shërbime të përballueshme me cilësi të lartë dhe i përqendruar te njerëzit, me qëllim të promovimit të mënyrave të shëndetshme të jetesës dhe për adresim të nevojave shëndetësore specifike të popullatës dhe faktorëve të rrezikut, përfshirë këtu situatat emergjente.

Agjencitë: **OBSh, UNICEF, UNFPA, UNHCR, UNOPS**

KOVID-19 i preku seriozisht kapacitetet e sistemit të kujdesit shëndetësor dhe e shtriu punën e personelit mjekësor midis prioritetëve të sigurimit të kujdesit dhe trajtimit të pacientëve me KOVID-19 dhe ofrimit të shërbimeve të rregullta dhe cilësore të kujdesit shëndetësor për të gjithë popullatën. Në vitin 2021, OKB-ja vazhdoi ta lehtësojë prokurimin e pajisjeve mjekësore dhe mbrojtëse për parandalimin, zbulimin dhe reagimin për të ofruar shërbime diagnostikuese më të shpejta dhe më cilësore për njerëzit në Shkup dhe ata që e vizitojnë spitalin universitar për trajtim dhe kujdes terciar.

Mbulimi universal i kujdesit shëndetësor u përmirësua nëpërmjet reformave të nisura, të cilat OKB-ja i mbështeti përmes pilot ndërhyrjeve në kujdesin primar shëndetësor, ngritjes së kapaciteteve të fuqisë punëtore shëndetësore dhe hartimit dhe zbatimit të trajnimit të parë për kompetencat e infermierisë. Zhvillimi i kapaciteteve afatgjata të praktikuesve të shëndetit dhe mbrojtjes së fëmijëve kontribuoi në përmirësimin e kushteve për shëndet dhe ushqim më të mirë të fëmijëve dhe përmirësimin e mundësive për stimulim dhe mësim të hershëm.

Ofrimi



5,000

HEALTH
PROFESSIONALS
CAPACITATED
in 2021

10


HOSPITALS' PERINATAL
CARE STRENGTHENED
in 2021 with UN support

vazhdueshëm i

shërbimeve thelbësore të kujdesit shëndetësor në kohën e pandemisë ka qenë me rëndësi parësore. Mbështetja e OKB-së u fokusua në ngritjen e kapaciteteve të fuqisë punëtore shëndetësore dhe futjen e shërbimeve të reja, duke përfshirë **kujdesin shëndetësor amnor dhe perinatal** përmes pilotimit ose zbatimit të veprimeve të përzgjedhura nga Plani i përgjithshëm nacional për Kujdesin perinatal dhe ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve shëndetësor. Gratë dhe vajzat në zonat e thella fituan **qasjen në shërbime cilësore dhe të sigurta të shëndetit seksual dhe riprodhues nëpërmjet futjes së shërbimeve gjinekologjike mobile të integruara në sistemin nacional të shëndetësisë.**

Mbështetja e ofruar e politikave e bazuar në fakte siguroi një kuptim më të mirë të pabarazisë dhe e filloi diskutimin e politikave për integrimin e kujdesit shëndetësor për të moshuarit në nivele të shërbimit dhe sistemit. U prezantuan instrumente të reja për matje të performancës dhe cilësisë së shërbimeve për të moshuarit, u institucionalizuan Llogaritë nacionale shëndetësore dhe filloi studimi i parë, i bërë ndonjëherë për mbrojtjen nga rreziku i shëndetit financiar. Vlerësimi i kapaciteteve nacionale për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës i definoi fushat prioritare të mbështetjes. Aleanca Rajonale për Parandalimin e Kancerit të qafës së mitrës u krijua si një platformë për bashkëpunim dhe shkëmbim të informacioneve për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës. Mbështetja për **digjitalizimin e përshpejtuar të sistemit shëndetësor** përmes mjeteve të futura digjitale të shëndetit mendor dhe sistemit të regjistrimit të vaksinimit kontribuoi ndjeshëm në një efikasitet më të mirë, transparencë dhe përmirësim të komunikimit dhe kontaktit me pacientët, duke rezultuar gjithashtu në një proces më efikas të vaksinimit.

Pacientët e huaj, duke përfshirë ata nën mbrojtje ndërkombëtare, fituan qasje të përmirësuar në shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe ishin në gjendje t'i kapërcejnë barrierat gjuhësore dhe statuset ligjore - Spitali i Gjevgjelisë dhe Klinika e Traumatologjisë në Shkup.



Mamia dhe mjeku në klinikat mobile. Vetëm në dhjetor, në Sveti Nikollë (me 18.000 banorë dhe vetëm 1 gjinekolog) 188 gra dhe vajza kanë mundur të bëjnë analiza dhe kontrolle të vonshme. Fotografia: UNFPA

PRODHIMI 2.2

Arsimi cilësor dhe i përbalueshëm, që siguron informacione për traumat e përjetuara dhe mjediset e përgjegjshme për gjininë dhe ato gjithëpërfshirëse për fëmijët dhe të rinjtë në vend, me qëllim të rritjes së rezultateve të mësimin, për të mundësuar zhvillim socio-emocional dhe për fuqizim me aftësi për kalimin në tregun e punës.

Agjencitë: **UNICEF, UNFPA, UNHCR, UNDP, ITU**

300,000 PËRDORUES TË PLATFORMËS MËSIMORE EDUINO në vitin 2021

Paralelisht me avokimin dhe mbështetjen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) për rihapjen e të gjitha shkollave në shtator pas një prej mbylljeve më të gjata të shkollave në mbarë botën, OKB-ja mbështeti plotësisht nisjen e reformës së re arsimore në vend.

Zbatimi i parë praktik i Konceptit të ri për arsimin fillor u realizua në programet e reja për klasat 1 dhe 4, i mbështetur nga zhvillimi i kapaciteteve të të gjithë 3000 mësuesve të klasave I dhe IV për të aplikuar qasje të reja pedagogjike në zbatimin e programeve të reja, si dhe nga uebinaret shtesë mbi mësimin e aftësive digjitale për të gjithë forcën mësimore përmes [platformës mësimore Eduino](#), e cila vazhdimisht iu shërben mbi 300,000 përdoruesve, me mbi 130,000 shkarkime aplikacionesh dhe mbi 4 milionë shikime. Duke e ruajtur momentin e reformës, OKB-ja e mbështeti zhvillimin dhe shtypjen e të gjitha teksteve shkollore për klasën e parë, zhvillimin e teksteve ndërvepruese digjitale për klasën IV dhe një platformë për përdorimin e tyre pa dhe me lidhje interneti (E-biblioteka).

Prezantimi i formulës së re të financimit për arsimin fillor të bazuar në nxënës dhe i studimit mbi shfrytëzimin optimal të rrjetit të shkollave, i kryer në partneritet me Bankën Botërore, rezultoi në optimizimin e arsimit fillor dhe të mesëm duke i rritur alokimet buxhetore në buxhetin shtetëror për vitin 2022 në 8 milionë dollarë për arsimin fillor, gjegjësisht 1.5 milionë dollarë për arsimin e mesëm.

Prezantimi i programit novator nacional të mësimin social dhe emocional (MSE) u përfundua në të gjitha entet parashkollore publikë me trajnime të afër 100% të edukatorëve aktivë të kopshteve dhe enteve parashkollore. Programi MSE vazhdon t'i ndihmojë fëmijët të zhvillojnë aftësi themelore që i mbështesin rezultatet e tyre të ardhshme të të nxënës, ndërveprimet sociale, shëndetin mendor dhe mirëqenien.

Bazuar në pilotimin e suksesshëm të prezantimit të Edukimit gjithëpërfshirës seksual të përfunduar në 3 nga 4 shkollat dhe mësimet e nxjerra nga ky angazhim, u nënshkrua një memorandum mirëkuptimi me Byronë për Zhvillimin e Arsimit (BZHA) për t'i përshkruar fushat kryesore të mbështetjes së gjerë në nivel nacional deri në fund të vitit 2025.

Vlerësimi i situatës ekzistuese për mbrojtjen e fëmijëve në internet ka prodhuar rekomandime, të cilat do të shërbejnë si bazë për Qeverinë për zhvillimin e një strategjie nacionale të sigurisë në internet dhe planit të veprimit.

Përfshirja e plotë e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat dhe ente parashkollore të zakonshme e ruajti vullin e saj. OKB-ja e mbështeti transformimin e shkollave speciale në qendra burimore për të ofruar mbështetje për shkollat e zakonshme dhe asistencë arsimore sipas nevojës. Forcimi i kapaciteteve për përfshirje në institucionet parashkollore ka vazhduar edhe me trajnime për komunikim alternativ dhe shtues për identifikimin dhe ndërhyrjen e hershme.

Përfshirja e fëmijëve të refugjatëve, emigrantëve dhe



Nxënësit e shkollave të mesme që ndjekin orën e parë pas hapjes së shkollave. OKB-ja mbështeti arsimin nga distanca gjatë pandemisë COVID-19 dhe mbrojti hapjen e shkollave. Fotografia: UNICEF

azilkërkuesve ka qenë një sfidë dhe fokus për OKB-në. Shkollat lokale që pranojnë fëmijët e refugjatëve dhe institucionet nacionale tani janë në gjendje t'i identifikojnë sfidat në edukimin e refugjatëve dhe të planifikojnë veprime që mund ta përfshijnë aplikimin e duhur të instrumenteve për përcaktimin e njohurive të mëparshme të fëmijëve dhe të përgatisin programe përgatitore të përshtatura për këta fëmijë.

Autoritetet shtetërore tani mund të ofrojnë kurse gjuhësore falas dhe sistematike (niveli bazë i gjuhës maqedonase) përmes një platforme digjitale të gjuhës – “[Mësoni maqedonisht](#)”, të menaxhuar nga Fakulteti Filologjik “Bllazhe Koneski”, për azilkërkuesit dhe refugjatët, me qëllim të përmirësimit të aftësive të tyre gjuhësore, me rëndësi qenësore për përfshirje sociale dhe ekonomike.

Vlerësimi i aftësive digjitale i ndërmarrë me mbështetjen e OKB-së, i dha qeverisë një pasqyrë të gjendjes aktuale në vend. Rekomandimet do ta strukturujnë zhvillimin e një strategjie të aftësive digjitale, që do t'i plotësojë nevojat e qytetarëve dhe do të kontribuojë në rritjen e mëtejshme të ekonomisë dhe shoqërisë digjitale. Më shumë detaje të mbështetjes së gjerë për MASH-in në mbështetjen e arsimit profesional dhe të të rriturve mund të gjenden nën rezultatit e Prosperitetit Gjithëpërfshirës.

PRODHIMI 2.3

Sistemi i mbrojtjes sociale është rezistues ndaj goditjeve të jashtme dhe i forcuar për të ofruar shërbime të përmirësuara në mënyrë progresive për të gjithë personat në nevojë, veçanërisht për ata që kanë ngelë pas.

Agencies: **IOM, UNHCR, UNICEF, UNDP**

Zbatimi i reformave sociale që rrjedhin nga ligji i ri për mbrojtjen sociale përparoi në mënyrë të qëndrueshme në vitin 2021, duke u fokusuar më së shumti tek ata të prekur nga pandemia COVID-19. OKB-ja vazhdoi ta mbështesë reformën në përmirësimin e kontributeve sociale, mbrojtjen e fëmijëve, de-institucionalizimin dhe mbrojtjen sociale të grupeve të cenushme, duke përfshirë personat me paaftësi, migrantët, refugjatët dhe azilkërkuesit.

Me mbështetjen e OKB-së, Qeveria ka aftësuar mbi 50 profesionistë dhe ka themeluar tre organe të reja të vlerësimit funksional për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara në rajonin e Pellagonisë, atë Juglindor dhe të Pollogut, të cilat së bashku me ndryshimet e legjislacionit

4 STRATEGJI TË REJA TË HARTUARA NË VITIN 2021

27 SHËRBIME TË HARTUARA QË NGA 2016

27,648 SHFRYTËZUES TË SHËRBIMEVE NË 2021

111,646 SHFRYTËZUES TË SHËRBIMEVE QË NGA 2016



OKB-ja zhvilloi indeksin e parë shumëdimensional të varfërisë së fëmijëve për të vlerësuar më mirë profilin e fëmijëve në rrezik të varfërisë. Fotoarafia: UNICEF

përkates do ta konsolidojnë ofrimin e vlerësimeve funksionale për fëmijët dhe të rinjtë në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (KNF). Kjo do të krijojë një pikë hyrëse të vetme të shërbimeve mbështetëse për fëmijët, duke u mundësuar atyre të marrin pjesë plotësisht në jetën shoqërore dhe t'i gëzojnë të drejtat e tyre njerëzore.

Për ta përcaktuar më mirë profilin e fëmijëve që janë më të rrezikuar nga varfëria dhe efektet e COVID-19, duke përdorur metodën Alkire-Foster, OKB-ja e zhvilloi indeksin e parë shumëdimensional të varfërisë së fëmijëve në vend. Kjo evidencë e re do t'i mundësojë qeverisë t'u japë përparësi politikave dhe shërbimeve, që e reduktojnë pabarazinë dhe fokusohen te më të cenuarit, si fëmijët romë dhe fëmijët që jetojnë në komunitetet rurale.

OKB-ja vazhdoi ta mbështesë rritjen e shërbimeve të prindërimit për zhvillimin socio-emocional të fëmijëve. Në këtë drejtim u prezantua programi "Prindërimi i butë" (Mellow Parenting), duke ofruar një qasje fleksibël me kosto të ulët për ndërhyrjen e hershme dhe mbështetjen e prindërve, duke i synuar prindërit nga familjet më të rrezikuara, si romët dhe familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjet që vuajnë nga privimi i shumëfishtë. Disa qindra prindër dhe kujdestarë u mbështetën drejtpërdrejt përmes linjës së ndihmës nacionale të prindërimit, duke marrë këshilla mbi teknikat e prindërimit pozitiv, që synonin gjithashtu parandalimin dhe adresimin e ndikimeve të mundshme detyësore negative të COVID-19. Mbi 430,000 njerëz arritën dhe u angazhuan në mediat sociale gjatë muajit të prindërimit.

Adresimi i nevojave të ndryshme të fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror, dhe fëmijëve që përjetojnë fatkeqësi dhe përjashtim, ishte në fokus të mbështetjes për forcimin e sistemit të kujdesit për fëmijët, i orientuar kah përmirësimi i cilësisë së kujdesit dhe atij familjar. Pika kryesore ishte hapja e dy qendrave mbështetëse për familjet kujdestare, për ta promovuar shërbimin e familjes kujdestare, për t'i vlerësuar dhe edukuar familjet e ardhshme kujdestare, për të vëzhguar dhe për të ofruar mbështetje për familjet kujdestare ekzistuese.

Për më tepër, gjatë pandemisë fëmijëve, të rinjve, prindërve dhe kujdestarëve në sistemin e kujdesit për fëmijët, iu ofrua mbështetja e synuar për shëndetin mendor dhe psikosocial. Të gjithë fëmijët në shtëpitë me grupe të vogla përfituan nga aktivitete kreative dhe edukative, të cilat e synonin përmirësimin e shëndetit të tyre mendor. Mbështetja e individualizuar përmes internetit iu ofrua më shumë se 200 fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre nëpërmjet një platforme posaçërisht të zhvilluar për ofruesit e shërbimeve të internetit. U zhvillua kapaciteti i 80 qendrave ditore dhe i personeli të enteve parashkollore mbi mënyrën e përdorimit të platformës për ofrimin e shërbimeve përmes internetit, duke e zgjeruar rrjetin e profesionistëve që ofrojnë shërbime përkatëse. 19,640 (93% meshkuj; 2% femra / 4% fëmijë meshkuj; 1% fëmijë femra) refugjatë, migrantë dhe azilkërkues që kalojnë transit jashtë vendit ose kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare janë asistuar përmes mbështetjes së vazhdueshme dhe

mbrojtjes sociale të OKB-së. Mbështetja përfshinte kushtet e jetesës dhe pritjes dhe shërbimet e ndihmës, ofrimin e mbështetjes psikosociale dhe shërbimeve mjekësore, ndërmjetësimin/përkthimin (interpretimin) kulturor, mbështetjen arsimore për fëmijët migrantë si dhe ndihmën për kthimin vullnetar të migrantëve që nuk kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.

Me mbështetjen e OKB-së, qeveria i ka përmirësuar kapacitetet për konsolidimin e sistemit formal të integritimit lokal të refugjatëve si pjesë e përpjekjeve të vendit për forcimin e politikave dhe mekanizmave të menaxhimit të migracionit në përgjithësi. Me ndihmën e partnerëve socialë, u mbështetën përpjekjet e qeverisë për integrimin e ofrimit të shërbimeve të mbrojtjes sociale dhe mbështetjen e integritimit për refugjatët dhe personat nën mbrojtje shtesë, duke rezultuar në përmirësimin e qasjes në të drejta dhe shërbime, rritjen e kapaciteteve integruese të komunave lokale, përmirësimin e mjedisit integruese lokal dhe opinionin publik dhe përmirësimin e mirëqenies psikosociale të refugjatëve.

Prodhimi 2.4

Përgjigje e përmirësuar multisektorale për t'i parandaluar dhe adresuar të gjitha format e dhunës të bazuar në qasjen e përqendruar të viktimat/të mbijetuarit, përfshirë praktikatat e dëmshme dhe normat diskriminuese gjinore dhe stereotipat.

Agjencitë: UN Women, UNFPA, ITU

Gjatë pandemisë të gjitha format e dhunës shënuan rritje, duke çuar në rritjen e aktiviteteve të parandalimit dhe reagimit dhe në forcimin e mbështetjes së OKB-së. Në nivel politikash, janë bërë hapa të rëndësishëm, siç është miratimi i Ligjit të ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave (DHG) në përputhje me angazhimet rregullatore të Konventës së Stambollit. Mbështetja për funksionalizimin e Ligjit të ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, në përputhje me Konventën e Stambollit, u inicua përmes zhvillimit të akteve nënligjore dhe ndërtimit të partneritetit për përmirësimin e reagimit multisektorial për t'i parandaluar dhe adresuar të gjitha format e dhunës ndaj grave.

Nëntë organizata të shoqërisë civile i fituan njohuritë më të mira mbi monitorimin e bazuar në fakte të zbatimit të Konventës së Stambollit dhe përgatitjen e raporteve në hije për Grupin e ekspertëve për veprimin kundër dhunës ndaj grave (DhKG) dhe dhunën në familje (DhF) (GREVIO). Po ashtu është përgatitur një projekt raport hije për GREVIO. 120 nxënës dhe 18 mentorë shkollor u fuqizuan të punojnë si mbështetës kundër stereotipeve të dëmshme gjinore, dhunës kundër grave dhe dhunës në familje. 68 gazetarë dhe profesionistë të tjerë të mediave, që punojnë anekënd Maqedonisë së Veriut i kanë rritur njohuritë mbi raportimin me ndjeshmëritë gjinore të dhunës kundër grave. 477 gra, burra, vajza dhe djem romë u fuqizuan për DhKG, DhF, stereotipet e dëmshme gjinore dhe martesat e hershme. 18 përfaqësues të ofruesve të shërbimeve të përgjithshme dhe të specializuara nga komunat e Strumicës, Shtipit dhe Velesit i kanë rritur kapacitetet për ofrimin e këshillimit dhe mbështetjes psiko-sociale në përputhje me Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW) dhe Konventën e Stambollit. 15 gra, të mbijetuara të dhunës, kanë filluar të përfitojnë nga mentorimi social për fuqizim ekonomik, duke përfshirë gratë e pakicave. Katër mentorë socialë i kanë rritur kapacitetet për ofrimin e shërbimeve të riintegritimit ekonomik për gratë e mbijetuara të dhunës.

68 GAZETARË TË TRAJNUAR PËR RAPORTIM PËR DHUNËN NDAJ GRAVE me mbështetjen e OKB-së

REZULTATI 3

Mjedis i shëndetshëm



Deri në vitin 2025, njerëzit në Maqedoninë e Veriut përfitojnë nga veprimet ambicioze të klimës, burimet natyrore të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme dhe biodiversiteti i ruajtur mirë përmes qeverisjes së mirë mjedisore dhe komuniteteve të qëndrueshme ndaj katastrofave.

Kontributi për:



Fillimisht parimet themelore: Zhvillimi Ekonomik dhe Konkurrueshmëria
Kapitulli 15: Energjia;
Kapitulli 27: Mjedisi

Shpenzimet e OKB-së në 2021

\$9,169,225

Partnerët e zhvillimit:

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Bujqësisë, Ministria Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Ministria e Kulturës, Ministria e Financave, Ministria e Arsimit; Ministria e Punës dhe Politikës Sociale; Ministria e Ekonomisë; Kabineti i Zëvendës Presidentit të Qeverisë për Çështje Ekonomike; Qendra për Menaxhimin e Krizave; Drejtorija për Mbrojtje dhe Shpëtim; vetëqeverisjet lokale; shoqatat e fermerëve; odat tregtare; OJQ-të, sektori privat, Fondacioni Ballkanik për Zhvillim të Qëndrueshëm, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Qyteti i Shkupit, Lidhja e vlerave natyrore dhe njerëzve - Zyra, DEKONS EMA, Drejtorija e Shëndetësisë Elektronike, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Fondi për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik, Unioni Ndërkombëtar për Ruajtja e Natyrës - Evropa Lindore dhe Azia Qendrore, Shoqëria Ekologjike Maqedonase, Komuna e Resnjës, Instituti Shtetëror i Shëndetit Publik, Komisioni Nacional i UNESCO-s, Federata Nazionale e Fermerëve, Instituti Shtetëror i Bujqësisë.

PRODHIMI 3.1

Mundësimi i politikave, mjedisit rregullator, kapaciteteve në nivelin qendror dhe lokal dhe fuqizimi i veprimeve të komunitetit për zhvillimin e emisioneve të ulëta dhe rezistencës multi-sektoriale ndaj ndryshimeve klimatike.

Agjencitë: **FAO, UNDP, UNECE, UNICEF, UNIDO**

Qeveria me mbështetjen e OKB-së ka arritur rezultate të rëndësishme në vitin 2021 në **politikën e ndryshimeve klimatike**. Është zhvilluar një pako gjithëpërfshirëse e dokumenteve politikave dhe mjeteve që e formësojnë angazhimin e vendit për ndryshimet klimatike, duke përfshirë [Kontributin e Përcaktuar Nacional të zgjeruar \(KPNz\)](#), duke përcaktuar politikën e vendit për ndryshimet klimatike deri në vitin 2030; Platformën e Monitorimit, Raportimit dhe Verifikimit (MRV), duke mundësuar raportim gjithëpërfshirës dhe efikas në UNFCCC; [Udhërrëfyesin e KPNz](#), i cili i përshkruan aktivitetet për ta arritur reduktimin e synuar të emetimit të gazeve serrë; [Strategjinë e Financimit të KPNz](#), [Politikën për heqjen e rrezikut financiar](#) për të gjithë sektorët e zgjeruar të KPNz-së; dhe legjislacionin për menaxhimin e kontrolluar/uljen e **substancave që shkatërrojnë ozonin (HCFCs)** të përdorura në frigoriferë, ngrirës, kondicionerë, pompa nxehtësie dhe pajisje të tjera në përputhje me Protokollin e Montrealit.

Për sa i përket **financimit të klimës dhe angazhimit të sektorit privat**, OKB-ja e mbështeti vendin në zhvillimin e një

[Udhërrëfyesi të taksave të karbonit](#) dhe metodologjisë së **etiketimit të buxhetit për klimën**. Ministria e Financave e ka inkuorporuar etiketimin e klimës në projektligjin përkatës. Gjithashtu, vendi është mbështetur për ta paraqitur **Programin e Punës Vendore të Fondit të parë të Klimës së Gjellbër (FKGJ)**. Më tej, janë zhvilluar harta dhe mjete të detajuara për një angazhim më të madh të sektorit privat dhe udhëzime për NMVM-të në ofrimin e produkteve me efikasitet të energjisë dhe pajisjeve të energjisë së rinovueshme.

Gjithashtu vazhduan aktivitetet për **bujqësi rezistente ndaj klimës**, me punë të mëtejshme për zhvillimin e **platformës së vetme të Hartës së Tokës**, duke integruar të dhëna nacionale dhe globale për klimën, tokën, terrenin, statistikën dhe më shumë, për ta ndihmuar politikën bujqësore të bazuar në dëshmi; për [përmirësimin e sistemit të farës së vendit](#), duke e përmirësuar prodhimin vendor të farërave me cilësi të lartë dhe tolerante ndaj klimës të kulturave strategjike; dhe në ngritjen e kapaciteteve të **mbikëqyrjes nacionale të dëmtuesve të bimëve** dhe sistemeve të certifikimit fitosanitar.

Ndërgjegjësimi i të rinjve është forcuar ndjeshëm me integrimin e temave të mjedisit dhe ndryshimeve klimatike të mbështetur nga OKB-ja **në kurrikulat për klasat I dhe IV** dhe trajnimin e mbi 60 edukatorëve të enteve parashkollore dhe të arsimitarëve të shkollave fillore. **Aktivitetet e angazhimit të të rinjve** për ndryshimet klimatike u mbështetën gjithashtu, duke filluar nga **Deklarata Rinore për Klimën** e zhvilluar nga të rinjtë, e mbështetur nga Presidenti i vendit dhe e prezantuar në Konferencën e OKB-së për Ndryshimet Klimatike në Glasgou, duke përforcuar zërin e më shumë se 300 të rinjve përmes U-Raportit dhe duke i mbështetur **inovacionet shoqërore** të zhvilluara nga të rinjtë për mbrojtjen e mjedisit (10 ekupe me 46 nxënës të shkollave të mesme përmes UPSHIFT).

E PARA
Zhvillimi i
HARTËS SË
PARË TË TAKSËS
KLIMATIKE



Udhërrëfyesi i KPNz (eNDC), i cili përshkruan aktivitetet për të arritur reduktimin e synuar të emetimit të gazeve serrë. Fotoarafia: UNDP

PRODHIMI 3.2

Zgjidhjet identifikohen dhe shkallëzohen në nivelet qendrore dhe lokale për menaxhim të integruar, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të burimeve natyrore (ujë, toka, pyjet, biodiversiteti)

Agjencitë: **FAO, UNDP, UNECE, UNEP, UNESCO**

Të arritura të rëndësishme janë shënuar në **shtrirjen e rrjetit të zonave të mbrojtura. Mali Sharr është shpallur park i ri, e ndërkohë po vazhdon rishpallja e Liqenit të Ohrit si monument natyre. Me mbështetjen e OKB-së janë përgatitur studimet për valorizimin e vlerave natyrore dhe projekt planet për menaxhimin e Parkut Nacional Mali Sharr dhe Liqenit të Ohrit, duke marrë parasysh interesat dhe nevojat e komuniteteve lokale dhe prioritetet nacionale për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Për më tepër, përmes një sërë trajnimesh u forcuan **kapacitetet e rojeve të parqeve nacionale** në të gjithë vendin.**

Gjithashtu është arritur progresi në **mbrojtjen e pyjeve dhe habitateve të bimëve, shpendëve dhe specieve tjera shtazore** përmes **identifikimit të 188 pyjeve me vlerë të lartë natyrore (55,988 hektarë)** të mbështetur nga OKB-ja dhe janë përgatitur udhëzimeve për menaxhimin e ardhshëm; janë **zhvilluar harta të vegjetacionit pyjore** për tre seksione pilot (Maleshevë dhe Ograzhden), janë propozuar udhëzime për menaxhimin e pyjeve në dy lokacione pilot për ta mbështetur mbrojtjen e mishngrënësve të mëdhenj



Në bashkëpunim me Qytetin e Shkupit, në vitin 2021 u hap për publikun e gjerë çatia e gjelbër e shtëpisë së kulturës "Koço Racin" si pjesë e një grupi më të gjerë aktivitetesh të dizajnuara për ta rritur qëndrueshmërinë e qytetit ndaj ndryshimeve klimatike dhe rritjes së temperaturave urbane. Fotoarafia: UNDP

(Bukoviç dhe Pletvar/Bellasicë); pastaj MMJPH urdhëroi për kufizimin e **grumbullimit të rrushit të arushës** për përdorim dhe tregtim, si rezultat i një veprimtarie kërkimore të produkteve pyjore jodurorore. Për më tepër, janë përgatitur **listat e para nacionale të kuqe/librat e zvarranikëve dhe ujëtokësorëve**, duke ofruar informacione mbi rreziqet e zhdukjes si pjesë e Listës së Kuqe Ndërkombëtare të Llojeve të Kërcënuara™. Për sa i përket **jetesës së komunitetit të peshqve**, u krijua **metodologjia e të dhënave dhe udhëzimet** me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të qëndrueshëm të peshkimit në brendësi të territorit, koordinimin e trupave të përbashkët ujorë dhe reduktimin e peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar.

Njashtu është përgatitur një dokument udhëzues për aftësimin e njësive të vetëqeverisjes lokale mbi zbatimin e **legjislacionit mjedisor dhe rekomandimeve për Rishikimin e performancës mjedisore (RPM)**.

Është përgatitur **harta nacionale e ndjeshmërisë ndaj erozionit dhe thatësisë** dhe është bërë identifikimi i **zonave me rrezik të lartë dhe ndikimi i tyre në biodiversitet** përmes hetimeve në terren dhe modelimit të erozionit. Gjithashtu, të dhënat e nevojshme për **shkallën e vulosjes së tokës dhe humbjen e lëndës organike** të tokës janë pilotuar në tre lokacione në rajonin e Strumicës, Prilepit dhe Ohrit.

Zhvillimi i gjelbër në rajonin e Shkupit, si rajoni më i madh urban në vend, gjithashtu u forcua përmes një sërë masash. Është ndërtuar **çatia e gjelbër në Shtëpinë e Kulturës**

"Koço Racin", si masë për uljen e temperaturës në blloqet urbane në qendër të qytetit. Gjithashtu, **Kadastri e gjelbër** për Qytetin e Shkupit është përmirësuar me **12,537 pemë dhe shkurre të gjeo-referencuara dhe të inventarizuara**. Gjithashtu, janë instaluar pesë stacione automatike me rrejt pa tel (zhytës) në piezometrat e rrjetit të ri monitorues në zonën e puseve në Nerez – Lepenec për të vendosur monitorim të vazhdueshëm, në kohë dhe preciz të **ujërave nëntokësore**. Janë identifikuar shtigjet e mundshme të transmetimit të kromit gjashtëvalent në ujërat nëntokësore të malit Zheden dhe ndikimi i tyre në burimin e Rashçes.

Dy aktivitete që kanë të bëjnë me **trashëgiminë natyrore dhe kulturore të rajonit të Ohrit** i kemi zbatuar për ta ndihmuar mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Liqenit të Ohrit në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s.


PRODHIMI 3.3

Kapacitetet në nivelet qendrore dhe lokale janë forcuar për ta parandaluar dhe për t'u përgjigjur ndaj kërcënimeve të ndotjes së ajrit dhe pasojave shëndetësore në komunitetet më të cenueshme.

Agjencitë: **IOM, UNDP, UNESCO**

Është rritur ndërgjegjësimi i gazetarëve, OSHC-ve dhe shitësve me pakicë të pajisjeve të ngrohjes për arsye të shkaqeve dhe efektet të ndotjes së ajrit. Është mbështetur **gazetaria hulumtuese** për ndotjen e ajrit, 20 përfaqësues të OSHC-ve janë aftësuar për mbështetjen e kauzës lidhur me ndotjen e ajrit, ndërsa 15 shitës **me pakicë** të pajisjeve ngrohëse janë trajnuar për promovimin argumentues të veçorive të efijencës së energjisë. Ministria e Ekonomisë është mbështetur në hartimin e 15 tabelave korresponduese për **Rregulloren mbi etiketimin e produkteve të ndërlidhura me energjinë** (formulari BE-MK dhe MK-BE).

Si ngrohen amvisëritë në Shkup



Përpjekjet e intensifikuara të të gjitha palëve të interesuara dhe qytetarëve të Shkupit për ndryshimin e praktikave ndotëse kanë rezultuar në ulje modeste, por të qëndrueshme të niveleve të ndotjes së ajrit në Shkup. Burimi: Studimet e UNDP-së për narohien e amvisërive. 2017 dhe 2021

Gjithsej 128 shtëpi në vendbanimin Lisiçe, Komuna e Aerodromit, janë përkrahur për blerjen e kondicionerë të rinj dhe zëvendësimin e stufave (shporetëve) joefikase me dru, pompave të ngrohjes, si dhe sobave me pelete, me qëllim të reduktimit të ndotjes së brendshme dhe të jashtme. Njashtu janë bërë disa intervenime më komplekse në amvisëritë, siç është instalimi i fasadave të reja, ndërrimi i kulmeve, dritareve dhe dyerve për ta përmirësuar efikasitetin e energjisë. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është të pilotohet një model për **reduktimin e ndotjes së ajrit nga amvisëritë**, i cili mund të përsëritet në lokacione tjera.

PRODHIMI 3.4

Në përputhje me Kornizën Sendai janë forcuar kapacitetet në nivelet qendrore dhe lokale për t'i identifikuar rreziqet e shumfshita dhe për ta planifikuar, financuar dhe zbatuar zvogëlimin dhe përgjigjen efektive ndaj rrezikut të katastrofave, përfshirë edhe zhvendosjen e njerëzve.

Agjencitë: **FAO, IOM, UNDP, UNDRR, WHO**


OKB-ja mbështeti fuqizimin e **vendimmarrjes së bazuar në prova për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë (ZRF)**, përmes krijimit të një indeksi të rrezikut të modelit INFORM nën nivelin nacional, hartimit të cënueshmërisë, ekspozimit dhe kapacitetit përbalues nëpër entitetet nën nivelin nacional në Maqedoninë e Veriut, në bashkëpunim me Qendrën e Përbashkët Hulumtuese të Komisionit Evropian.

Rezistenca e sektorit të bujqësisë u forcua përmes zhvillimit për herë të parë të **Strategjisë Nacional të Ujitjes dhe Kullimit 2021-2031**, përditësimit të **Analizës së sistemeve nacionale të ZRF-së për Sektorin e Bujqësisë** dhe rishikimit të të gjitha politikave dhe planeve nacionale në lidhje me ndryshimet klimatike dhe bujqësisë në drejtim të harmonizimit me rregulloren e BE-së. Për më tepër, u dhanë rekomandime për përmirësimin e **sistemit ekzistues të informacionit për vlerësimin nacional të dëmeve dhe humbjeve (D&H)**. Për sa i përket aktiviteteve në terren, **teknologjitë inovative të bujqësisë së mençur në raport me klimën (BMK)** u prezantuan nga komunitetet lokale bujqësore në tre lokacione demonstruese në Strumicë, Gjevgjeli dhe Resnjë.

Qëndrueshmëria ndaj rrezikut nga vërshimet e komuniteteve të rajonit të Pollogut u përmirësua përmes përditësimit të Planit për Menaxhimin e Rrezikut nga Përmblytjet për basenin e epërm të Lumit Vardar dhe identifikimit të masave për rritjen e rezistencës së dy qendrave më të mëdha urbane në Pollog, qyteteve të Tetovës dhe Gostivarit. Janë identifikuar burimet kryesore të sedimentit (rrëshqitjet e dheut dhe përrenjtë) në rajon dhe është finalizuar dokumentacioni teknik për **stabilizimin e përroit të Shipkovicës** dhe rregullimin e shtratit të **lumit të Bogovinës. Menaxhimi i integruar i rrezikut ndërkufitar nga përmblytjet** rezistente ndaj klimës në pellgun e lumit Drin u forcua gjithashtu. Me mbështetjen e OKB-së, **17 stacione hidrologjike dhe 9 meteorologjike** janë shtuar rishtazi në pjesën e pellgut të lumit Drin në pjesën e Maqedonisë së Veriut. Për më tepër, saktësia më e madhe e planifikimit të rrezikut të parashikuar nga përmblytjet dhe menaxhimit të rrezikut u mundësua përmes mbledhjes së **të dhënave historike hidrologjike dhe meteorologjike** që nga viti 1960 e në vazhdim dhe nga zhvillimi i **modeli digjital të terrenit me rezolucion të lartë (MDT)**, duke përdorur teknologji të sofistikuar (metoda e anketimit LiDAR, zonë e përafërt 4125 km²). Është përgatitur dokumentacioni teknik për restaurimin e **lumit Sateska dhe devijimin në shtratit e tij natyror**. Është bërë edhe vlerësimi i kapacitetit për zbatimin e **planeve të menaxhimit të pellgjeve të lumenjve**.

Për sa i përket **qëndrueshmërisë urbane**, u përditësua/zhvillua **Vlerësimi i rrezeqeve dhe Plani i Qytetit të Shkupit për mbrojtje dhe shpëtim nga zjarri**. Është përgatitur dokumentacioni teknik për masat anti-erozive në Malin e Zi të Shkupit, për t'i parandaluar përmblytjet e rënda si ajo e vitit 2016. OKB-ja e mbështeti zbatimin e **Planit të veprimit për rimëkëmbjen nga COVID-19 të vendbanimeve joformale** në Ballkanin Perëndimor. OKB-ja e siguroi ndërtimin e kapaciteteve dhe mësimin mes kolegëve për vendet e Evropës Juglindore për koordinimin e **planifikimit të përdorimit të tokës dhe procedurat e sigurisë industriale**.

Gatishmëria e emergjencës shëndetësore u rrit duke **forcuar kapacitetet e zbulimit** të laboratorëve të Shëndetit Publik (sigurimi i pajisjeve, furnizimeve dhe pajisjeve për mbrojtje personale, trajnimi i javor, infrastruktura e përfurcuar e TI-së), zhvillimi i **Strategjisë Nacionale të Sekuencës Gjenomike**, krijimi i **Platformës COVID-19 për trajnim përmes internetit**, e cila ofron kurse të akredituara për profesionistët e shëndetësisë, komunikimi i rrezikut dhe angazhimi i komunitetit mbi sjelljet mbrojtëse dhe parandaluese nga Covid-19, prokurimi i **pajisjeve kryesore dhe furnizimeve mjekësore për repartet e spitalit me Covid-19 dhe ngritja e Qendrës Inteligjencës Epidemike dhe Qendrës Operative të Emergjencës**, rritja e kapaciteteve për menaxhimin strategjik dhe monitorimin e emergjencave



Profesionisti shëndetësor hyn në platformën e trajnimit përmes internetit <https://obuki.zdravstvo.gov.mk>, e cila përfshin module specifike trajnimi për COVID-19, të prezantuara si pjesë e mbështetjes së OBSH-së për përgjigje ndaj pandemisë në Maqedoninë e Veriut. Fotografia: OBSH

shëndetësore. OKB-ja dha një kontribut të rëndësishëm në **digjitalizimin** dhe forcimin e sistemit elektronik shëndetësor "Moj Termin" (Takimi im) në lidhje me Covid-19 duke përfshirë: digjitalizimin dhe ndërveprueshmërinë/shkëmbimin e të dhënave mbi testimin për Covid midis të gjithë laboratorëve, mjekëve familjarë dhe epidemiologëve; digjitalizimi i sistemit të mbikëqyrjes së kontakteve; **pyetësor elektronik epidemiologjik; një evidencë e plotë e pacientit me COVID-19** me importim dhe analitikë retroaktive të të dhënave; zhvillimi i një Moduli të telemjekësisë dhe moduli bazë të të dhënave mbi burimet njerëzore shëndetësore dhe vlerësuesin e furnizimit dhe pajisjeve.

PRODHIMI 3.5

Kapacitetet nacionale dhe lokale janë fuqizuar dhe është ngritur vetëdija për zvogëlimin e mbeturinave (plehrave) dhe menaxhimin efikas të plehrave (kimike, ujit, mbeturinave komunale, mbeturinave të rrezikshme, mbeturinave mjekësore - përfshirë zonat rurale)

Ajencitë: ITU, UNEP, UNIDO, UNITAR, UNOPS

Për menaxhimin efikas të mbeturinave, OKB-ja ka zhvilluar udhëzime profesionale për komunitatet dhe qendrat rajonale të menaxhimit të mbeturinave dhe e ka vlerësuar nivelin e zbatimit të **planeve rajonale të menaxhimit të mbeturinave**, gjegjësisht dhe kapacitetin për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të ndërmarrjeve komunale.

OKB-ja gjithashtu i mbështeti aktivitetet për **pastrimin/riparimin e mbetjeve të rrezikshme**. Aktivitetet për pastrimin e **pellgut të vogël në kompleksin OHIS (IKOSH)** janë në vazhdim e sipër, duke përfshirë punimet ndërtimore në themel për përfshirjen e zonës për gjurmimin e tokës së kontaminuar. Gjithashtu, Instituti i Shëndetit Publik u pajisi me **pajisje laboratorike** për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit nga efektet e dëmshme të substancave të rrezikshme.



Vazhdojnë aktivitetet për pastrimin e pellgut të vogël në kompleksin OHIS. Fotografia: UNOPS

REZULTATI 4

Qeverisja e mirë



Deri në vitin 2025 i gjithë shteti përfiton nga sundimi i përmirësuar i ligjit; politikat e bazuara në dëshmi, politikat parashikuese dhe të përgjegjshme gjinore; kohezioni më i madh shoqëror; dhe ofrimi efektiv i shërbimeve nga institucione transparente, llogaridhënëse dhe të përgjegjshme.

Kontributi për:



Fillimisht parimet themelore
Kapitulli 3.23 Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore
Kapitulli 3.24 Drejtësia, Liria dhe Siguria

Shpenzimet e OKB-së në 2021

\$9,084,881

Partnerët e zhvillimit:

Kabineti i Presidentit, Kabineti i Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit përgjegjës për Integrimin Evropian dhe Euroatlantik, Çështjet Ekonomike, Sistemin Politik dhe Qeverisjen e Mirë, Sekretariati për Çështjet Evropiane, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Vetëqeverisjes Lokale, të Punës dhe Politikës Sociale, Punëve të Jashtme, Financave, Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Drejtësisë, Kulturës, Arsimit dhe Shkencës, Mbrojtjes, Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Shëndetësisë, Parlamenti, Banka Popullore, Enti Shtetëror i Statistikës, Enti Shtetëror për Revizion, Byroja për Zhvillim Rajonal, Qendrat për Zhvillimin e 8 rajoneve planore, Gjykata Supreme, Gjyqësori, Prokuroria Publike për Krim të Organizuar dhe Korrupsion, Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Avokati i Popullit, Komisioni kundër Diskriminimit, Grupi i punës ndërmënyre për miratimin e politikës së migracionit, Këshilli Nacional për Barazi Gjinore, Drejtoria e Doganave, Agjencia për Rini dhe Sport, Organizata Botërore e Doganës, INTERPOL, OSBE, Komisioni Nacional për UNESCO, Oda e Avokatëve, Fakulteti Juridik "Justinian Prima", Akademia e Shkencave dhe Arteve, Asociacioni i Zyrtarëve Financiar, Asociacioni i Njësisë të Vetëqeverisjes Lokale, Rrjeti i Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS), Qyteti i Shkupit. Komuna e Aerodromit, Manastirit, Bogdancit, Bogovinës, Qendërs, Çashkës, Dellçevës, Gazi Babës, Gjevgjeliës, Gjoçe Petrovit, Gostivarit, Karposhit, Kavadar, Kisella Vodës, Kočanës, Kriva Pallankës, Kumanovës, Makedonski Brodit, Makedonska Kamenicës, Mavrovë-Rostushe, Novacit, Ohri, Shtipit, Nagoricit të Vjetër, Strugës, Strumicës, Sveti Nikollës, Tetovës, Velesit, Vinicës, Shoqata e Juristëve të Rinj Maqedonas, "Akocija Zdruzenska", organizatat e personave me aftësi të kufizuara dhe organizatat tjera të shoqërisë civile.

PRODHIMI 4.1

Avancimi i sundimit të ligjit, qasjes në drejtësi dhe mbrojtjes, promovimit të të drejtave të njeriut për të gjithë, veçanërisht për ata të lënë pas, përmes përmirësimit të kornizës ligjore, politike dhe institucionale dhe të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe ndërtimit të kapaciteteve.

Agjencitë: IOM, UNICEF, OHCHR, UNOPS, UNHCR, UNODC, UNESCO, UN Women, UNFPA

Në një kontekst sfidues politik dhe socio-ekonomik, mbështetja kolektive e OKB-së ishte parësore në përshtetimin e reformave të nevojshme për integrimin e vendit në BE dhe rritjen e qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të gjelbër. Politika dhe vendimmarrja largpamëse, gjithëpërfshirëse dhe transparente, e mbështetur me prova dhe e lehtësuar me zgjidhje digjitale inovative, kontribuoi në avancimin e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit në vend.

OKB-ja kontribuoi në zhvillimin dhe përafrimin e 21 politikave dhe 98 ligjeve dhe akteve nënligjore me legjislacionin e BE-së dhe standardet ndërkombëtare, të cilat i promovojnë të drejtat themelore, barazinë gjinore, qasjen në drejtësi dhe shërbime për viktimat e dhunës me bazë gjinore, së bashku me kompensimin për dëmin e pësuar nga krime tjera të dhunshme. Në sektorin e drejtësisë, u rishikuan ligji civil dhe ai penal, përfshirë drejtësinë për fëmijët. OKB-ja e

ka inkorporuar gjithandej parimin "Askush të mos lihet pas" në zhvillimin dhe zbatimin e politikave. Grupet e përjashtuara dhe të marginalizuara u fuqizuan për t'i kërkuar të drejtat e tyre dhe për të marrë pjesë në mënyrë efektive dhe për të ndikuar në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre. U promovua angazhimi me mekanizmat ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut dhe u krijua një kornizë e pavarur monitoruese për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

524

**PERSONA
PASHTETËSI
PRANUAN
ndihmë juridike**

OKB-ja i mbështeti autoritetet në gjetjen e një zgjidhjeje sistematike për pashtetësinë, duke e ndryshuar legjislacionin. Në këtë drejtim veçohet fushata #UnëIËrkas (#IBelong) dhe ofrimin e ndihmës juridike për 524 persona pa shtetësi në vend. 33 persona pa shtetësi janë asistuar me konfirmimin e shtetësisë, ndërsa 512 persona kanë marrë këshillim juridik. Në mediat nacionale është prodhuar dhe transmetuar një video, që e rrit ndërgjegjësimin për pashtetësinë dhe regjistrimin civil në Maqedoninë e Veriut.

OKB-ja i mbështeti autoritetet në gjetjen e një zgjidhjeje sistematike për pashtetësinë, duke e ndryshuar legjislacionin. Në këtë drejtim veçohet fushata #UnëIËrkas (#IBelong) dhe ofrimin e ndihmës juridike për 524 persona pa shtetësi në vend. 33 persona pa shtetësi janë asistuar me konfirmimin e shtetësisë, ndërsa 512 persona kanë marrë këshillim juridik. Në mediat nacionale është prodhuar dhe transmetuar një video, që e rrit ndërgjegjësimin për pashtetësinë dhe regjistrimin civil në Maqedoninë e Veriut.

Transpozimi i legjislacionit të BE-së mbi çështje gjinore është iniciuar nga Sekretariati për Çështje Evropiane. Strategjia e re Nacionale për Barazinë Gjinore (2021-2026) është në procedurë legjislative, e ndërkohë janë miratuar dy strategji të tjera sektoriale - Strategjia Nacionale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2021-2027 dhe Strategjia për Zhvillimin Rajonal 2021-2031, duke vendosur për herë të parë, objektiva të qarta për tejkalimin e boshllëqeve gjinore.

Angazhimi i OKB-së me Qeverinë në menaxhimin e migracionit dhe dinamikën e popullsisë, çoi në një Politikë gjithëpërfshirëse të migracionit 2021-2025 dhe Planin e veprimit të miratuar nga Parlamenti në dhjetor të vitit 2021, dhe zhvillimin e profilit të vendit të migracionit. Në fushën e drejtësisë penale, 40 profesionistë i avancuan aftësitë e tyre për trajtimin e çështjeve të trafikimit të personave, duke i mbrojtur të drejtat e viktimave.

#IBelong

LET'S END STATELESSNESS

NOW

Pamje nga fushata e drejtuar nga OKB-ja për pashtetësinë në Maqedoninë e Veriut naa dhietori i vitit 2021. Fotoarafia: UNHCR

PRODHIMI 4.2

Kapacitete të fuqizuara të autoriteteve qendrore dhe lokale për: a) plan më të mirë, buxhet, monitorim dhe gjurmim të shpenzimeve dhe burimeve të grumbulluara në mënyrë të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe në mbështetje të zhvillimit të përshtetshëm, b) përmirësimi i dizajnit dhe ofrimit efikas i shërbimeve publike cilësore (duke synuar grupe të përjashtuara, përfshirë menaxhimin e refugjatëve/migracionit), me llogaridhënie të përmirësuar sociale dhe pjesëmarrje në vendimmarrje.

Agjencitë: IOM, UNDP, UNOPS, UN Women, UNICEF



OKB-ja i avancoi sistematikisht kapacitetet e palëve shtetërore dhe joshetërore, duke përfshirë zyrtarët qeveritarë, administratën qendrore dhe lokale, gjyqësorin, prokurorinë, Avokatin e Popullit, Komisionin kundër Diskriminimit, ESHS-në, organet tjera të pavarura, si dhe shoqërinë civile. Administrata fitoi njohuri kryesisht në politikat dhe legjislacionin e ri të harmonizuar, Agjendën 2030 dhe OZHQ-të, dhe metodologjinë e zgjerimit të BE-së, duke fituar gjithashtu aftësi negociuese për anëtarësim në BE. Në këtë drejtim janë përmirësuar kapacitetet e përgjithshme në fushat e dinamikës së popullsisë, migrimit, azilit dhe mbrojtjes ndërkombëtare.

Një gjurmë e rëndësishme ishte zhvillimi i një Metodologjie kompresive që do ta drejtojë vendin në përcaktimin e vizionit të tij afatgjatë të zhvillimit, duke e formuluar Strategjinë Nacionale të Zhvillimit, të dalë nga një konsensus i gjerë i gjithë shoqërisë. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor ka vazhduar të zbatohet në 13 ministri dhe 31 komuna, pra në 10 komuna më shumë krahasuar me vitin e kaluar, kryesisht në politika dhe buxhete në shëndetësi, punë dhe sektorët socio-ekonomikë. Perspektiva gjinore u integrua gjithashtu në 15 përgjigje strategjike të rëndësishme për anëtarësimin në BE. Rritja e kapaciteteve dhe udhëheqja e Departamentit për Mundësi të Barabarta të MPPS-së ka rezultuar në rolin e tij më të fortë si **Makineri Gjinore Nacionale** që i inicion dhe koordinon reformat për avancimin e barazisë gjinore. Në këtë drejtim, u krijua **Qendra e parë Burimore për Politikbërje dhe Buxhetim të Përgjegjshëm Gjinor**, e cila do të shërbejë si një qendër njohurish, duke lehtësuar zhvillimin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të kapaciteteve të administratës publike.

OKB-ja ka kontribuar në mënyrë thelbësore për **financimin më të barabartë të arsimit fillor dhe të mesëm**. Metodologjitë e reja për shpërndarjen efikase të burimeve kanë mundësuar një rritje të transferimeve të mjeteve në komuna me 8 milionë dollarë amerikanë për arsimin fillor dhe 1.5 milionë dollarë amerikanë për arsimin e mesëm në ciklin e buxhetit të shtetit për vitin 2022. Kjo do të mundësojë ushqim falas për nxënësit nga klasa e parë deri në të pestën, tableta falas për nxënësit nga familjet më të varfra, ndarje adekuata për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe mësimi në gjuhët e bashkësive më të vogla etnike. Rreth **1000 të rinj u angazhuan** në ri-imagjinimin e proceseve të konsultimit, sondazhet e U-Raportit, kanalet e mediave sociale dhe krijuan partneritet me Presidentin e vendit për t'i mbështetur thirrjet e tyre për veprim.

Përpjekjet për decentralizim u përforcuan me Programin e ri për Zhvillim të Qëndrueshëm Lokal dhe Decentralizim 2021-2026, dhe dy instrumente të reja financiare (Fondet e Barazimit dhe Performancës) për financimin komunal, të cilat pritet të miratohen në Parlament. **55 komuna përfituan nga zgjidhjet inovative digjitale që siguruan pjesëmarrje efikase dhe ofrim të shërbimeve**, politikbërje të bazuar në dëshmi dhe bashkëpunim ndërkomunal, që përfshinte 26 komuna. E-platformat për pjesëmarrjen e qytetarëve, iu dhanë 700 personave mundësinë për të marrë pjesë aktive në procesin e vendimmarrjes në komunitetet e tyre.



Të rinjtë, duke marrë pjesë në një ngjarje në Parkun e Qytetit të Shkupit për ta nisur platformën U Report të mbështetur nga UNICEF, e cila është zhvilluar për t'i fuqizuar të rinjtë që t'i ndajnë mendimet e tyre për çështjet që u interesojnë dhe të bëhen agjentë pozitivë të ndrvshimit në komunitetet e tyre. Fotoarafia: UNICEF

PRODHIMI 4.3

Përdorimi i shtuar i të dhënave të nuara për parashikim të cilësisë dhe të dhënave për politikbërje të përmirësuar në të ardhmen, të bazuara në dëshmi, të orientuara drejt rezultateve dhe transparente, të përgjegjshme ndaj të drejtave të grave, burrave, vajzave dhe djemve dhe vulnerabilitetit të grupeve të lëna pas, në të gjitha nivelet dhe në të gjitha kontekstet, përfshirë edhe ato humanitare.

Agjencitë: UNDP, UNFPA, UN Women, UNHCR, UNICEF

1,000 YOUNG PEOPLE INVOLVED IN REIMAGINING consultations in 2021

Proceset transparente dhe pjesëmarrëse të politikbërjes në të gjitha degët dhe nivelet e qeverisjes e fituan një fokus më të fortë në evidenca dhe të dhëna, objektiva të matshëm dhe indikatorë të përafuar me OZHQ-të. **Indeksi i Zhvillimit të Komunave**, si burimi më i besueshëm i të dhënave për zhvillimin socio-ekonomik të komunave në vend, u përditësua, u bë më i ndjeshëm për çështjet gjinore dhe më i përafuar me Strategjinë për Zhvillimin Rajonal 2021-2031 dhe me Programin për Zhvillim të Qëndrueshëm Lokal dhe Decentralizim 2021-2026.

Strategjia e komunikimit, e udhëhequr bashkërisht nga OKB-ja dhe Enti Shtetëror i Statistikës (ESHS), ndikoi pozitivisht në procesin e mbledhjes së të dhënave të ndara sasiore dhe cilësore gjatë Regjistrimit të vitit 2021. Kapacitetet analitike dhe raportuese të ESHS-së u rritën në raport me indikatorët e OZHQ-ve, veçanërisht me indikatorin 5.1.1 të OZHQ-së, duke përfshirë indikatorët e ndarë sipas gjinisë dhe një pjesë e grupit të pyetjeve të Uashingtonit për vetëvlerësimin e aftësisë së kufizuar gjatë grumbullimit të të dhënave. OKB-ja vazhdoi të sigurojë të dhëna dhe kërkime analitike mbi ndikimin socio-ekonomik të KOVID-19 te fëmijët, gratë, viktimat e dhunës dhe grupet e tjera të cenueshme. Një fushatë multimediale i shënjestroi qëndrimet negative ndaj fëmijëve me qasje në drejtësi. Fushata në fjalë u realizua në partneritet me OSHC-të dhe partnerët tjerë nacionalë.

OKB-ja në partneritet me aktorët kryesorë nacionalë e filloi një program të përbashkët, i cili synon t'i forcojë kapacitetet dhe sistemet për qeverisje novatore dhe parashikuese në fushën e menaxhimit të migracionit. Për më tepër, puna mbi të dhënat e mëdha dhe flukset e remitancave përmes kanaleve joformale rezultoi me një metodologji anketimi dhe instrumente anketimi. Në mbështetje të kësaj, **4 video të fushatës në mediat sociale kanë arritur më shumë se 740.000 shikime ose 450.000 persona**, që është pothuajse 45 herë më shumë se objektivi i caktuar, dhe prezantimi i

fushatës edhe në televizionet nacionale.

OKB-ja mbështeti formulimin e **Strategjisë Nacionale të Drejtësisë për Fëmijët**, duke propozuar një program gjithëpërfshirës dhe pragmatik të aktiviteteve për ta arritur gradualisht një ndryshim pozitiv për fëmijët në kontakt ose konflikt me ligjin dhe për t'i forcuar kapacitetet e Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve, por edhe palëve tjera të interesuara, duke siguruar pjesëmarrjen aktive të rinjve në procesin e vendimmarrjes.

"Analiza e rasteve të femicideve në Maqedoninë e Veriut 2017-2020" zbuloi një numër të madh të grave viktime, duke u bërë thirrje autoriteteve përgjegjëse që të ndërmarrin veprime të vendosura. Më shumë se 1000 përdorues e kanë shkarkuar aplikacionin celular "BE SAFE" (Bëhu e sigurt). Aplikacioni, së bashku me mediat sociale dhe fushatat e informimit në zonat rurale, e përmirësoi ndërgjegjësimin dhe qasjen në shërbimet e DHBGJ-së.

PRODHIMI 4.4

Kohezioni dhe besimi shoqëror i përmirësuar përmes dialogut dhe pjesëmarrjes kuptimplote të të gjithëve, e në veçanti të grupeve të lëna pas.

Agjencitë: **UNDP, UN Women, UNHCR**

Gjatë gjithë vitit 2021, u promovua kohezioni më i madh dhe qëndrimet pozitive publike ndaj grupeve të cenueshme dhe të përjashtuara përmes avokimit, strategjive të komunikimit, veprimeve dhe përpjekjeve konkrete për përfshirjen dhe integrimin e njerëzve të lënë pas, duke përfshirë gratë, migrantët, refugjatët, azilkërkuesit, personat pa shtetësi dhe disa minoritete etnike.

Mjeti i rëndësishëm për të ndihmuar në transformimin e narracionit në shoqëri është **Strategjia e Komunikimit për Ndryshimet Sociale**, e cila u hartua në vitin 2021 nga UNHCR me ekspertë nga Universiteti i Kentakit. Për të promovuar dhe ndihmuar Strategjinë për të ecur përpara, u krijua një Trup Këshillëdhënës, i përbërë nga përfaqësues të sektorëve të ndryshëm të shoqërisë, si dhe një Qendra e Komunikuesve, një grup komunikuesish nga i gjithë bordi me qëllim të ngritjes së kapaciteteve reciproke dhe veprimtari të përbashkët për ndryshime shoqërore.

Grantet e posaçme për mediat kanë mundësuar që 140 forume televizive të shërbejnë si mekanizëm për pjesëmarrjen drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrjen e komunave. Metodologjia e Demokracisë Lokale është

miratuar nga 44 komuna të reja. 44 nëpunës civilë janë përzgjedhur për të marrë pjesë në fazën

3,300

GRA U PËRFSHINË NË AKTIVITETET E NDËRGJEGJËSIMIT NË VITIN 2021

e dytë të projektit ReLoAD. Së fundi, modeli i ri i projektuar i financimit të bazuar në projekte nga buxhetet e qeverisjes vendore e mbështeti agjencinë e shoqërisë civile, të rinjve dhe grave në nivel vendor.

OKB-ja përforcoi përkrahjen për mundësi të barabarta të grave të marginalizuara. Partneriteti me OSHC-të dhe komunat rezultoi në 36 masa politikash, që ofrojnë shërbime të ndjeshme ndaj gjinisë, moshës dhe aftësisë së kufizuar në sferën e shëndetësisë, mbrojtjes sociale, transportit publik si dhe dhunës mbi bazë gjinore. Me mbështetjen e OKB-së, **mbi 3,300 gra u përfshinë drejtpërdrejt në informimin dhe ngritjen e ndërgjegjësimin të kryer nga OSHC-të dhe organizatat bazë të grave, si dhe në fushatën "Bëhu i zëshëm dhe i qartë".**

PRODHIMI 4.5

Rritja e kapaciteteve nacionale dhe lokale në konfiskimin (rikuperimin) e pasurive dhe luftimin e korrupsionit në jetën publike përmes zbatimit më të mirë të ligjeve kundër korrupsionit dhe masave parandaluese.

Agjencitë: **UNODC, UNDP**

Duke përafuar legjislacionin nacional me standardet ndërkombëtare, gjegjësisht duke i miratuar protokollet e kontrollit të armëve dhe duke i rritur kapacitetet e praktikuesve të zbatimit të ligjit dhe të drejtësisë penale, OKB-ja siguroi një përgjigje më efektive dhe bashkëpunim ndërkufitar dhe rajonal në kontrollin e armëve dhe në luftën kundër trafikimit të personave, kontrabandës së migrantëve dhe të formave tjera të krimit të organizuar, njëkohësisht duke i mbrojtur të drejtat e viktimave. Gjithë rajoni i Ballkanit Perëndimor përfitoi nga dokumentet kryesore të politikave të mbështetura nga OKB - **Strategjia për Konfiskimin (Rikuperimin) e Pasurive dhe Udhërrëfytesin kundër korrupsionit dhe financave të paligjshme.**

САМО ЗДРУЖЕНИ МОЖЕ ДА ИНИЦИРАМЕ КВАЛИТЕТНИ ПРОМЕНИ!

ВКЛУЧИ СЕ ВО ПРОЦЕСИТЕ НА ОДЛУЧУВАЊЕ ЗА ДА ГИ ПРЕКИНЕМЕ СУПСТАНДАРДНИТЕ УСЛОВИ ЗА ЖИВЕЕЊЕ НА УЛИЦА ЧЕРЕЊА - ШТИП.

Барање до Општината за асфалтирање на улицата Черенја!

Иницијатива на жени Ромки од Штип.

Биди ЈАСНА И ГЛАСНА

Fushata "Bëhu e zëshme dhe e qartë!" tregon punën dhe iniciativat e grave në nivel lokal, rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në proceset vendimmarrëse, angazhimin, organizimin dhe vullnetin e tyre për të inicuar ndryshime për të mirën e komunitetit. Fotografia: UN Women



Ngjarje në Ohër ku më 25 qershor 2021, Ministri e Drejtësisë, Ministri e Brendshëm, Zëvendësministri, Sekretarët e Shtetit dhe Drejtuesit e Agjencive Kundër Korrupsionit nga rajoni kanë miratuar zyrtarisht Udhërrëfytesin Rajonal Kundër Korrupsionit dhe Financave të Paligjshme për Ballkanin Perëndimor. Fotografia: UNODC

Financimi i OZHQ-ve dhe partneriteti

Konferenca Vjetore e OKB-së e vitit 2021 u organizua, me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe debatit publik mbi financimin e OZHQ-ve në vend. Evenimenti i fokusuar në **financat publike dhe private**, mbledhi së bashku politikbërësit kryesorë, përfaqësuesit e sektorit financiar dhe komunitetin ndërkombëtar, duke i njohur përpjekjet e adoptuesve të hershëm. Për më tepër, [Analiza e Pasqyrës së Financimit të OZHQ-së në Maqedoninë e Veriut në vitin 2021](#) e zhvilluar nga OKB-ja dha një përmbledhje të flukseve të financimit publik, privat, ndërkombëtar dhe nacional dhe një sërë rekomandimesh se si të forcohet më tej fokusi në financimin e Agjendës 2030.

Ekipi i OKB-së e mbështeti Qeverinë në integrimin e Agjendës 2030 në financat publike të vendit përmes futjes së **buxhetimit të përgjigjshëm gjinor** në nivel qendror dhe lokal (OZHQ 5) dhe prezantimit të metodologjisë së detajuar për **etiketimin e buxhetit për klimën** (OZHQ 13). OKB-ja gjithashtu e mbështeti vendin në **aspekte të ndryshme tatimore** për ta rritur pakon e financimit publik në dispozicion për përmblidhjen e objektivave të qëndrueshmërisë, duke përfshirë politikën tatimore për **çmimet e transfertave dhe shkëmbimin e informacionit tatimor**, dhe me zhvillimin e Udhërrëfyesit për futjen e **taksës së karbonit** (OZHQ 13). Mbështetja është ofruar me reduktimin e **ekonomisë joformale** (OZHQ-të 8 dhe 10) dhe **flukseve të paligjshme financiare** (OZHQ 16), përmes zhvillimit të treguesve për monitorimin e ekonomisë joformale dhe një **fushatë të ndërgjegjësimit publik**, si dhe me zhvillimin e **Udhërrëfyesit të Ballkanit Perëndimor kundër Korrupsionit dhe Financimit të Paligjshëm**.

OKB-ja njashu e ka mbështet qeverinë në zhvillimin e **instrumenteve novatore financiare** për të mundësuar alokim më efektiv të fondeve të OZHQ-së përmes:

- **financimit të gjelbër – zhvillimit të Instrumentit për Financim të Gjelbër, rritjes së qasjes në Fondin e Gjelbër Klimatik** (OZHQ-të 7 dhe 13)
- **financimi komunal – mbështetja e Fondit të Performansit të themeluar rishitas dhe Fondit të Barazimi për fuqizim të kapaciteteve fiskale dhe rritje të të ardhurave për komunën** (OZHQ 16)
- **financimi i mjedisit - zbatimi i Fondit Mjedisor Multi-Partner në nivel të shtetit, duke mundësuar bashkim efikas të kontributeve financiare nga mbështetës të ndryshëm për pastrimin e mbeturinave të rrezikshme në kompleksin e fabrikës OHIS** (OZHQ 12)

Për shembull, [Instrumenti për Financim të Gjelbër](#), një nga instrumentet e reja financiare inovative, në vlerën e pritur prej 46 milionë dollarësh, do të ndihmojë në përzjerjen e financave nga Fondi i Përbashkët i OKB-së për OZHQ, Qeveria e Maqedonisë së Veriut, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH/EBRD) dhe bankat private në vend, për ta përshpejtuar adoptimin e zgjidhjeve të energjisë së rinovueshme dhe eficientës së energjisë nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe amvisëritë.

Për të promovuar **financimin e qëndrueshëm privat**, OKB-ja nisi diskutime dhe identifikoi kampionë për përfshirjen e standardeve të qeverisjes mjedisore, sociale



Konferenca vjetore e OKB-së e vitit 2021 u kushtua financimit të OZHQ-ve në Maqedoninë e Veriut. Fotografia: ZKP të OKB-së

të korporatave (QMS), qëndrueshmërinë e korporatave dhe **raportimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme** dhe **parimet përgjegjëse bankare** midis sektorit bankar dhe atij privat.

OKB në Maqedonia e Veriut vazhdoi të jetë partnere me një grup të gjerë dhe të larmishëm partnerësh, me bashkëpunim të drejtpërdrejtë kontraktual me mbi 130 partnerë. Partneriteti me institucionet financiare ndërkombëtare rritet nëpërmjet një partneriteti të ri me BERZH-in për GFF (shih më lart). Janë shqyrtuar mundësitë për partneritet me entitete të përzgjedhura të sektorit privat në tema si prezantimi i **raportimit të qëndrueshmërisë së korporatave** dhe iniciativave të përbashkëta për **rritjen e ndërgjegjësimit për OZHQ-të** me Unionin e Dhomave të Tregtisë dhe Klubin e Biznesit Zvicerano-Maqedonas.

SDG Financing Landscape in North Macedonia
November 2021



Konferenca vjetore e OKB-së e vitit 2021 u kushtua financimit të OZHQ-ve në Maqedoninë e Veriut. Fotografia: ZKP të OKB-së

Koherenca, efektivitet dhe efikasiteti i OKB-së

Viti i parë i zbatimit të 2021-2025 KBZHQ-së u karakterizua nga përpjekjet e intensifikuara kolektive dhe individuale të entiteteve për ta kthyer në praktikë reformën e sistemit të zhvillimit të OKB-së në Maqedoninë e Veriut – përmes zbatimit rigoroz të parimeve, udhëzimeve dhe mjeteve që e mbështesin ofrimin më të harmonizuar dhe koherent të mbështetjes së OKB-së, të fokusuar në rezultate dhe në efikasitetet.

Harmonizimi dhe koherenca programatike

KBZHQ-ja funksionalizohet çdo vit përmes një plani të përbashkët pune (PPP), i cili i përmbledh të gjitha aktivitetet e zhvillimit të OKB-së brenda një viti të caktuar, duke e ndjekur diskutimin dhe harmonizimin kolektiv përmes një procesi konsultativ brenda OKB-së dhe me partnerët shtetëror.

PPP 2021 ishte plani i parë i tillë vjetor në Maqedoninë e Veriut, i miratuar nga Komiteti i përbashkët drejtues për KBZHQ në shkurt të vitit 2021, pasi u konsultua me më shumë se 70 partnerë të OKB-së dhe të qeverisë. PPP 2021 përfshinte aktivitetet prioritare, standardet dhe objektivat e detajuara, të përpiluara në një vend dhe që shërbejnë si një mjet që e rrit përgjegjshmërinë dhe fokusohet në rezultatet e arritura nëpërmjet eliminimit të dyfishimit dhe maksimizimit të komplementaritetit brenda katër fushave prioritare të KBZHQ-së. PPP 2021 gjithashtu e përvijoi qartë **zhvendosjen e vazhdueshme të mbështetjes së sistemit të zhvillimit të OKB-së nga zbatimi i drejtpërdrejtë drejt një roli më të synuar si mundësues dhe ofrues i këshillave dhe ekspertizës për zhvillim dhe mbështetje të politikave.**

OKB-ja vazhdoi me përpjekjet e përkushtuara për të zhvilluar programe të përbashkëta të agjencive të shumta të OKB-së, për të mundësuar ofrimin e një grupi gjithëpërfshirës të njohurive dhe ekspertizës së OKB-së për vendin mbi sfidat komplekse dhe shumëplanëshe. Në vitin 2021, OKB kishte **tre programe të përbashkëta në zbatim** – mbi politikën e migracionit dhe të dhënat cilësore për migracionin; Reagimi dhe rikuperimi ndaj COVID-19, duke u fokusuar në e-imunizimin, hezitimin lidhur me dhe qasjen në shërbimet shëndetësore në zona të largëta; dhe në avancimin e të drejtave për personat me aftësi të kufizuara, duke u fokusuar në politikën, të dhënat

administrative, aspektet financiare dhe pjesëmarrjen më të madhe të personave me aftësi të kufizuara në politikëbërje. Tre programe të reja të përbashkëta ishin në zhvillim e sipër – krijimi i instrumenteve inovative të financimit (Instrumenti për Financim të Gjelbër); forcimi i dialogut dhe ndërtimi i narrativave konstruktive mes të rinjve në rajon; dhe mobiliteti rajonal i punës.

Transparenca dhe llogaridhënia

Përveç rritjes së shtrirjes dhe koherencës së ndërhyrjeve, PPP 2021 e shtoi ndjeshëm transparencën e punës së OKB-së. Informacioni i detajuar – duke përfshirë informacionin financiar – është vënë në dispozicion të partnerëve zbatues dhe të jashtëm gjatë fazës së planifikimit dhe zbatimit, duke përfshirë kanalet publike si UN-INFO. Kjo jo vetëm që e rriti përgjegjshmërinë për përmbushjen e rezultateve, por gjithashtu e promovoi bashkëpunimin, partneritetet, shkëmbimin e informacioneve dhe shmangien e dyfishimit të veprimeve në programim - të agjencive të OKB-së dhe partnerëve të qeverisë.

Korniza e financimit si shembull – e rrit më tej përgjegjshmërinë dhe transparencën duke ofruar një referencë dhe pasqyrë të vetme të situatës së financimit të KBZHQ-së si dhe burimeve financiare të nevojshme për t'i përmbushur rezultatet e KBZHQ-së së OKB-së. Korniza e financimit ofron informacion të detajuar në lidhje me **sasinë, burimin, kohëzgjatjen dhe sekuencën e burimeve financiare të nevojshme, të disponueshme dhe të parashikuara për të qenë të disponueshme dhe që synohen të mobilizohen** nga ekipi i OKB-së në vend, me qëllim që të përmbushen rezultatet e KBZHQ-së. Kjo është e gërshetuar në Planet e Përbashkëta të Punës dhe azhurnohet në bazë të rregullt, duke ofruar një pasqyrë aktuale dhe të detajuar të gjendjes financiare.

Në vitin 2021 në Maqedoninë e Veriut u prezantua plotësisht dhe u promovua përdorimi i platformës qendrore përmes internetit **UN-INFO** – për planifikim, monitorim dhe raportim nga ekipi i OKB-së në vend - e cila e digjitalizon kornizën e përbashkëta të rezultateve, strategjive dhe mjeteve tjera të koordinimit operacional, si mjet kyç për gjurminin, mbështetjen dhe ofrimin e një "një pike të përbashkët" për të gjitha informacionet mbi kontributin e OKB-së në Agjendën 2030 dhe OZHQ-të në vend.

Qeverisja e përbashkët dhe koordinimi

Struktura e qeverisjes së KBZHQ-së u zbatua plotësisht gjatë vitit 2021 për të siguruar harmonizim strategjik dhe të përditshëm midis agjencive të OKB-së dhe të gjithë aktorëve tjerë.



Komiteti i Përbashkët Drejtues (KBD) i nivelit të lartë të OKB-së dhe Qeverisë në muajin mars ofroi udhëzime strategjike dhe miratim të PPP 2021, i cili u funksionalizua përmes ndërveprimit dhe koordinimit të rregullt dypalësh dhe shumëpalësh midis njësisë të OKB-së dhe ministrive partnere dhe institucioneve tjera.

Paraprakisht po në vitin 2021, u krijuan katër Grupe të Rezultateve të KBZHQ-së. Grupet e rezultateve janë mekanizmi kryesor koordinues për të siguruar një qasje koherente të analizës, planifikimit, zbatimit dhe monitorimit në të gjithë sistemin e OKB-së në nivel të rezultatit. Grupet në fjalë zhvilluan rregullisht takime gjatë gjithë vitit 2021 dhe deri në fund të vitit u bënë platforma kryesore për planifikimin e përbashkët, që gjithashtu nënkuptonte angazhim me homologët përkatës të qeverisë lidhur me rezultatin. Kjo kulmoi në nëntor dhe dhjetor të priorizimit të përbashkët për PPP 2022, që për herë të parë është projektuar në një mënyrë të tillë konsultative.

Ekipi i OKB-së në vend (UNCT) ngeli shtylla kurrizore për shtrirjen e OKB-së brenda vendit. Koordinimi i brendshëm i OKB-së gjithashtu u rrit ndjeshëm nëpërmjet krijimit dhe punës së Ekipit të Menaxhimit të Programit (EMP), që



Për herë të parë Raporti vjetor 2020 i rezultateve të OKB-së për Maqedoninë e Veriut u vu në dispozicion në tri gjuhë - anglisht, maqedonisht dhe shqip


ofroi këshilla dhe mbështetje teknike për ekipin e OKB-së në vend gupet e rezultateve mbi mundësitë dhe sfidat programatike, me qëllim të përgjithshëm për të siguruar koherencë programore.

Intensifikimi i mëtejshëm i punës përmes këtyre dhe forumeve tjera të përbashkëta të koordinimit të brendshëm – Grupi i Komunikimit; Grupi i Menaxhimit, Vlerësimit dhe Mësimit; dhe grupe të ndryshme tematike të brendshme – kontribuuan jashtëzakonisht shumë në rritjen e koherencës dhe përafrimin e punës së OKB-së përgjatë rezultateve dhe mandateve dhe zbatimit në nivel vendi të reformës së Sistemit të Zhvillimit të OKB-së.

Ngritja dhe funksionimi i plotë i strukturave të forcuara koordinuese u mundësua nga rritja e rolit drejtues të ekipit të OKB-së në vend, dhe iu mundësoi atyre pozicionimin dhe avokimin më të mirë për punën dhe ndikimin e përgjithshëm të OKB-së në vend. Kjo ka qenë e mundur vetëm për shkak të mbështetjes dhe burimeve të investuara globalisht nga donatorët që nga viti 2019, duke përfshirë Fondin e Mirëbesimit të OKB-së për Qëllime Speciale që ofron fonde të përforcuar për ekipit të OKB-së në vend.

Mbrojtja e përbashkët

Mbrojtja e përbashkët dhe aktivitetet e komunikimit publik për ta avancuar dukshmërinë e OKB-së dhe për ta afruar punën e saj me njerëzit u forcuan përmes tregimit të zgjeruar në faqen e internetit të korporatave brenda vendit (<https://northmacedonia.un.org>) dhe Buletinit mujor të Zhvillimit të Qëndrueshëm, i shpërndarë rregullisht në më shumë se 2000 abonentë. Për të forcuar më tej komunikimin dhe avokimin e drejtuar nga të dhënat, u krijuan mjete dhe shërbime të reja kolektive për ekipet e



16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës mbi Bazë Gjinore. Fotografia: ZKP të OKB-së

komunikimit të OKB-së (shtypja e përmirësuar e shtypit, shërbimet e dëgjimit të mediave sociale) gjatë vitit 2021.

Përveç fushatave të rregullta - 16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës mbi Bazë Gjinore dhe fushata e OZHQ-ve rreth Ditës së OKB-së - u filluan disa nisma dhe fushata të reja, gjegjësisht u forcuan partneritetet ekzistuese gjatë vitit 2021, duke përfshirë Delegacionin e BE-së për mjedisin dhe ndryshimet klimatike.

Viti 2021 e shënoi gjithashtu nxjerrjen e Raportit të parë të konsoliduar të rezultateve të OKB-së për Maqedoninë e Veriut, i cili e vuri në pah ofrimin kolektiv të punës së OKB-së dhe Qeverisë dhe mbështetjen e domosdoshme të partnerëve ndërkombëtarë në vitin 2020, ku në fakt vend qendror zuri COVID-19 dhe mbyllja e ciklit programor të OKB-së 2016-2020.

Efikasiteti

OKB-ja e Maqedonisë së Veriut e filloi zbatimin e Strategjisë së Operacioneve të Biznesit (BOS) 2.0 në vitin 2021 për ta realizuar Agjendën Globale të OKB-së mbi Efikasitetin. Plani i përbashkët pesëvjeçar (2021-2025) për operacionet e OKB-së pritet të gjenerojë efikasitete operacionale, sinergji dhe koherencë dhe vlerësohet se do të kursejë 1.1 milion dollarë nëpërmjet eliminimit të kostove të transaksionit, kursimit të kohës së stafit dhe përfitimt nga ekonomitë e shkallës. OKB-ja e Maqedonisë së Veriut ndërmori hapa drejt zhvillimit ose zbatimit të shërbimeve të përbashkëta në fushat e menaxhimit të objekteve dhe ambienteve të punës, teknologjisë informatike, burimeve njerëzore dhe financave dhe prokurimit.

Meqenëse në vitin 2021, COVID-19 vazhdoi të ndikojë në modalitetet e punës në vend, OKB-ja e siguroi vazhdimësinë e punës dhe funksionimin pa ndërprerje, duke u përkujdesur për sigurinë dhe shëndetin e personelit si prioritet kryesor. Organizimi fleksibël dhe puna nga distanca u vunë gjithashtu në zbatim, të shoqëruara me kalimin gradual nga kthimi në zyrë kur një gjë e tillë është e mundur.

Vlerësimi dhe mësimet e nxjerra

PZHQ vlerësim

Vlerësimi përfundimtar i pavarur i strategjisë që e parapriu KBZHQ-në, Partneriteti për Zhvillim të Qëndrueshëm (PZHQ) 2016-2020, u realizua në fund të vitit 2019, me rezultatet që vënë në pah zhvillimin e KBZHQ-së për periudhën 2021-2025.

Raporti i vlerësimit të PZHQ-së veçoi pesë fusha të rekomandimeve për OKB-në, me qëllim të përmirësimit të rezultateve ose koordinimit të tyre.

1. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional
2. Menaxhimi i të dhënave, hartimi dhe monitorimi i programit
3. Qëndrueshmëria e ndërhyrjeve të ndërmarra
4. Qëndrueshmëria e financimit; dhe
5. Fuqizimi i rolit të ekipit të OKB-së në vend në koordinim me partnerët e zhvillimit

Ekipi i OKB-së në vend është angazhuar t'i merr në konsideratë plotësisht pesë grupet e rekomandimeve të vlerësimit. Nga observimet e bëra iu mundësua Koordinatorit të përhershëm të OKB-së dhe ekipit të OKB-së në Maqedoninë e Veriut, ta krijojë një përmbledhje bazë për menaxhim të operacioneve të mëtejshme gjatë vitit 2021. Një përgjigje shumëvjeçare e menaxhimit, e përgatitur qysh në vitin 2020 dhe u rishikua në vitin 2021.

Deri në fund të vitit 2021, ekipi i OKB-së në vend përmbushi plotësisht 12 nga 38 veprime, ndërsa 17 të arritura në vitin 2021, ende vazhdojnë të jenë të zbatueshme. Krahasuar me një vit më parë (45% në 2020), shkalla e zbatimit është 67%. Në proces e sipër janë 5 veprime, të cilat do të përfundojnë deri në vitin 2022, ndërsa vetëm 3 veprime u vonuan ose u

përmbushën pjesërisht në vitin 2021. Më shumë se gjysma e këtyre veprimeve mbeten të zbatueshme dhe vazhdojnë gjatë gjithë ciklit të KBZHQ-së.

Mësimet e nxjerra

Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet subjekteve të OKB-së zakonisht shfaqet në ato fusha ku ekziston një agjendë e qartë reformash, e mbështetur nga një problem i identifikuar qartë dhe një angazhim i fortë për ndryshim nga qeveria.

Pra, pronësia nacionale është faktor i rëndësishëm, që e formon ndërveprimin e agjencive të OKB-së në nivel të shtetit.


Sistemi i OKB-së mund të bëhet me shpejtësi i rëndësishëm dhe të japë një kontribut të madh në fushat, ku më parë ka pasur angazhim minimal. Nëse ka një nevojë të qartë në një fushë të ekspertizës, kapacitetit dhe përvojës së OKB-së, është e mundur që agjencitë e OKB-së të bashkohen dhe të bashkërendohen në mënyrë efektive dhe efikase përmes bashkëpunimit të ngushtë me njëri-tjetrin.

Ndryshimi i vazhdueshëm i mjedisit, i ndikuar nga kombinimi i sfidave lokale, rajonale dhe globale, ndikon ndjeshëm në ritmin dhe qëndrueshmërinë e rezultateve. Qasjet e reja dhe inovative që mund t'i përshpejtojnë rezultatet e zhvillimit drejt Agjendës 2030 duhet ta përfshijnë (1) planifikimin dhe vendimmarrjen strategjike sistematike dhe largpamëse brenda operacionit; (2) angazhimin strategjik me një spektër të gjerë aktorësh të përgjedhur për ta mobilizuar mbështetjen dhe për t'u angazhuar me të gjithë aktorët e ndryshimit; dhe (3) mbështetjen e vendin në zhvillimin e një vizioni kolektiv dhe përcaktimin e prioriteteve për të ardhmen, në mënyrë që ta avancojnë mirëkuptimin e përbashkët dhe ta ndjekin vizionin e përbashkët afatgjatë.

UNCT management response to PSD Evaluation

Status of implementation as of 31 December 2021

UNCT Management Response to PSD Evaluation Recommendations - Action Plan Implementation Status as of end-2021



Mobilizimi i financave dhe burimeve

Përmbledhje financiare

Në vitin 2021, 44.9 milionë dollarë u vunë në dispozicion të OKB-së për Maqedoninë e Veriut, nga të cilat 35.6 milionë dollarë u shpenzuan, duke rezultuar në normën e dorëzimit prej 79%. Shikuar rezultatet e KBZHQ-së, shërbimet cilësore për të gjithë (10.0 milion dollarë të shpenzuar), mjedisi i shëndetshëm (9.2 milion dollarë) ishin burimet më intensive, të ndjekur nga qeverisja e mirë (9.1 milion dollarë) dhe prosperiteti gjithëpërfshirës (7.4 milion dollarë). Shkalla e përfundimit ka qenë pak më e ulët në krahasim me një vit më parë për shkak të shpërthimit të COVID-19, zgjedhjeve lokale dhe tranzicionit qeveritar në tremujorin e fundit të vitit, procedurave të vonuara për dhënien e lejeve të ndërtimit dhe vonesave në zbatimin e disa projekteve ndërtimore të vlerë më të madhe. Dorëzimi pritet të jetë në rrugën e duhur në vitin 2022.



OKB-ja i ka mobilizuar me sukses 92% të burimeve të nevojshme për vitin e parë të KBZHQ-së, duke mundur zbatimin e qetë. Aktivitetet e OKB-së për Maqedoninë e

Veriut në vitin 2021 u morën nga 34 burime financimi. Pjesa më e madhe e financimit në dispozicion është marrë në formën e financimit të projektit dhe programit specifik (42%), të ndjekur nga financimi i qeverisë (21%), financimi bazë (17%), fondet vertikale globale (13%), fondet e bashkuara (5%), fondet tematike (2.5%) dhe fondet e sektorit privat (0.1%).

Dhjetë burimet kryesore jo thelbësore të financimit të bazuara në shpenzimet e vitit 2021 për punën e OKB-së në Maqedoninë e Veriut ishin Maqedonia e Veriut, Zvicra, Suedia, Fondi Global i Mjedisit, Bashkimi Evropian, Norvegjia, Mbretëria e Bashkuar dhe Qyteti i Shkupit.


Totali i burimeve të kërkuara për vitin 2021, Burimet në dispozicion dhe Shpenzimet në vitin 2021

Të dhënat e 31 marsit të vitit 2022, për 1 janar 2021 – 31 dhjetor 2025, në miliona dollarë amerikanë



Shpenzimet e vitit 2021 për burim financimi

Të dhënat e 31 marsit të vitit 2022, për 1 janar 2021 – 31 dhjetor 2025, në miliona dollarë amerikanë



Source: UN North Macedonia, 2022; available funding and expenditures are based on UN entities' financial systems or financial statements information as of 31 March 2022. UNHCR expenditures are estimates based on historic delivery rate as their expenditure reporting is consolidated only in April.

Mobilizimi i resurseve

Në fund të vitit 2021, OKB-ja e Maqedonisë së Veriut e [zhvilloi Strategjinë e Mobilizimit të Burimeve dhe Partneritetit të KBZHQ-së \(SMBR\)](#), e cila i përcakton objektivat e përbashkëta sasiore dhe qasjet cilësore për mobilizimin e burimeve dhe partneritetet për periudhën pesëvjeçare të KBZHQ-së. Strategjia i përvijoi objektivat e ekipit të OKB-së në mobilizimin dhe partneritetin e burimeve të përbashkëta, si dhe e përcakton fokusin e aktiviteteve dhe qasjeve për të siguruar një qasje më koherente, më të efektshme dhe transparente. Për mobilizimin e burimeve, u përcaktuan katër objektiva sasiore dhe dy qasje. Më poshtë është dhënë raportimi mbi progresin në përmbushjen e këtyre objektivave për KBZHQ në fund të vitit të parë.

Për sa i përket **mobilizimit të financave të nevojshme për përmbushje të rezultateve të planifikuara sipas KBZHQ-së (objektivi 1 i SMBR)**, OKB-ja e Maqedonisë së Veriut është në **rugën e duhur**. Në fund të vitit 2021, **89 milionë** dollarë ishin në dispozicion për aktivitete në periudhën pesëvjeçare. Kjo përfaqësonte 50% të 178 milionë dollarëve të kërkuara për t'i përmbushur rezultatet e parashikuara në KBZHQ-në pesë-vjeçare. Çdo vit, 92% e burimeve të kërkuara të vitit 2021 janë mobilizuar dhe vënë në dispozicion, ndërsa 76% e burimeve të nevojshme për vitin 2022 janë mobilizuar para fillimit të vitit; 88.8 milionë dollarë ose 50% e fondeve të përgjithshme të kërkuara ngelin për t'u mobilizuar.

Për sa i përket **cilësisë së përzierjes sigurimit të fondeve/financimit**, pjesa më e madhe e financimit të marrë deri më sot


është në formën e burimeve jo thelbësore (79.3 milionë dollarë, 88%). Shumica e kontributeve erdhën nga financimi specifik i projektit dhe programit (48%), të ndjekur nga financimi i qeverisë (15%), fondet e bashkuara (12%), fondet bazë (12%), fondet vertikale globale (10%), fondet tematike (3%), dhe sektori privat (më pak se 1%). Përqindja e **bashkëfinancimit të qeverisë (Objektivi 4 SMBR)** dhe **fondeve të bashkuara dhe vertikale është rritur** dhe mbështetja në financimin e projekteve dhe programeve të caktuara u zvogëlua, duke rezultuar në një përzierje të **përmirësuar financimi (Qasja SMBR)**.

Në fund të vitit 2021, **dhjetë burimet kryesore të financimit jo-thebësore** për periudhën 2021-2025 ishin Maqedonia e Veriut, Zvicra, Bashkimi Evropian, Suedia, Fondi i Përbashkët i OZHQ-së, Fondi Global i Mjedisit, Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Norvegjia dhe Qyteti i Shkupit.

OKB-ja në Maqedoninë së Veriut e vazhdoi punën e saj të përkushtuar në **ritjen e programimit të përbashkët (shumë agjencish)** dhe është në përputhje me objektivin vjetor të përcaktuar në SMBR Objektivi 3. Në vitin 2021, u zhvilluan katër ide të reja programore të përbashkëta: programe të përbashkëta për financat e gjelbra, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, migrimi rajonal për motive punësimi dhe rinia nga rajoni dhe dialogu; ndërsa njëra u financua me sukses (të drejtat për personat me aftësi të kufizuara). Rreth 500,000 dollarë u mobilizuan në vitin 2021 për programe të përbashkëta.


2021-2025 SDCF required and available resources

Data as of 31 March 2022, for 1 January 2021 – 31 December 2025, in million US\$



2021-2025 mobilized funds per funding modality and funding source

Data as of 31 March 2022, for 1 January – 31 December 2021, in million US\$



OKB në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022

Në vitin e dytë të KBZHQ-së, OKB-ja e Maqedonisë së Veriut do të vazhdojë të ofrojë këshilla dhe mbështetje për politikatat dhe institucionet shtetërore, me qëllim të përsheptimit të zbatimit të Agjendës 2030, siç është rënë dakord me Qeverinë në Planin e Përbashkët të Punës 2022. Agjencitë e OKB-së do të vazhdojnë të sigurojnë që aktivitetet e tyre të reflektojnë dhe përputhen me rrjedhat kryesore nacionale të punës dhe prioritetet strategjike, duke përfshirë Strategjinë Nacionale të Zhvillimit, procesin e anëtarësimit në BE dhe programin aktual të qeverisë.

Në fushën e **prosperitetit gjithëpërfshirës** (Rezultati 1 i KBZHQ-së), OKB-ja do të vazhdojë të krijojë dhe mbështesë vendë pune dhe NVM-të e qëndrueshme, duke nxitur teknologji dhe aftësi të avancuara të përshtatura me nevojat e ardhshme, duke promovuar mundësitë e biznesit dhe njohuritë në sektorët e kulturës dhe krijimtarisë, dhe forcimin e kapaciteteve për ekonomi rurale të qëndrueshme dhe konkurruese. **Mundësia e punësimit të të rinjve, grave, njerëzve me të vështirësi për t'u punësuar dhe personave me aftësi të kufizuara** do të rritet përmes masave aktive të punës dhe trajnimit për modelin e të mësuarit gjatë gjithë jetës. **Rregulloret** do të harmonizohen më tej me standardet e ILO-s dhe BE-së, duke e lehtësuar qasjen në punë për të gjithë, dhe duke i përfshirë shërbimet e digjitalizuara. Do të mbështeten kapacitetet në lehtësimin e tregtisë dhe bujqësisë së qëndrueshme dhe do të bëhen përpjekje për ta nxitur angazhimin produktiv të diasporës. **Cilësia e punësimit** do të përfitojë nga ratifikimi i politikës së Konventës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, formalizimi në sektorin HORECA dhe forcimi i kapaciteteve inspektuese. Menaxhimi i shëndetit të kafshëve dhe konsolidimi i tokës bujqësore do të vazhdojë në nivel politikash dhe praktik, duke përfshirë më tej aspektet gjinore në politikatat dhe buxhetimin e zhvillimit rural.

Në fushën e shërbimeve sociale (Rezultati 2 i KBZHQ-së), OKB-ja do të vazhdojë ta mbështesë zbatimin e reformës nacionale të kujdesit shëndetësor primar nëpërmjet riorganizimit dhe fuqizimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore; Aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit në nivel të sistemit, por edhe me fokus në segmente të veçanta të sistemit; përmirësimet e kornizës rregullator si dhe zhvillimin e kapaciteteve të fuqisë punëtore shëndetësore. Mbështetje e vazhdueshme do të ofrohet në zhvillimin e politikave **arsimore** dhe programeve shoqëruese të favorshme për mjedisë të sigurta, të shëndetshme, të përgjegjshme ndaj gjinisë, gjithëpërfshirëse dhe me burime adekuate duke mbështetur zhvillimin e kurrikulave të arsimit fillor dhe zhvillimin e një koncepti të ri për arsimin e mesëm të përgjithshëm (kurrikula dhe të tjera aktivitete). OKB-ja do t'i mbështesë partnerët nacionalë për të siguruar që personat në nevojë të mbrohen dhe të përmirësohet më tej ofrimi i **shërbimeve të mbrojtjes sociale** për kategoritë vulnerabile. **Parandalimi i dhunës** dhe lufta kundër dhunës në familje dhe dhunës mbi bazë gjinore do të mbeten gjithashtu prioriteti kryesor. Mbështetja për forcimin e sistemit të **kujdesit ndaj fëmijëve** do të vazhdojë ta trajtojë në mënyrë efektive ndarjen e familjes, fatkeqësitë dhe përjashtimin, duke krijuar mekanizma dhe shërbime, si dhe zhvillimin e kapaciteteve të fuqisë punëtore të shërbimit social.

Në fushën e **mjedisit të shëndetshëm** (Rezultati 3 i KBZHQ-së), OKB-ja do të vazhdojë punën për ndryshimet klimatike, duke e zgjeruar mbështetjen për përshtatjen, menaxhimin e burimeve natyrore, reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, ndotjen e ajrit dhe menaxhimin e mbeturinave. Disa aktivitete kyçe të parashikuara përfshijnë rritjen e **kapacitetit adaptues ndaj ndryshimeve klimatike** nëpërmjet zhvillimit të Strategjisë Nacionale të Përshtatjes dhe nëpërmjet zbatimit të masave praktike të përshtatjes në bujqësi (përmirësimi i infrastrukturës së ujtit dhe menaxhimit efikas të burimeve tokësore dhe ujore); më tej, rritja e **financimit të gjelbër** (Instrumenti i Financimit të Gjelbër), mbështetje për mbrojtjen e përmirësuar të natyrës, bujqësi

dhe turizëm më të gjelbër, menaxhim të ujërave të zeza dhe mbetjeve të ngurta në Prespë, aktivitete të reja për **neutralitetin e degradimit të tokës** dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tokës dhe pyjeve, finalizimi i Studimit të Përhapjes së Burimeve për Shkupin, përsëritja e mundshme e aktiviteteve për reduktimin e **ndotjes së ajrit** përmes përmirësimit të ngrohjes në qytete të caktuara jashtë Shkupit, vazhdimi i aktiviteteve për reduktimin e rrezikut nga përmbytjet në Pollog dhe në lumin Drin dhe përfundimi i **pastrimit të HCH (lindanit)** të rrezikshëm në basenin e mbeturinave të vogla të kompleksit OHIS.

Në fushën e **qeverisjes së mirë** (Rezultati 4 i KBZHQ-së), OKB-ja do ta vazhdojë avancimin e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë, duke forcuar institucione më transparente, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet, si dhe politikëbërje largpamëse, parashikuese dhe të orientuara nga dëshmitë. OKB-ja do të vazhdojë ta mbështesë procesin e KPN-së që do ta përcaktojë vizionin afatgjatë të zhvillimit të vendit për dy dekadat e ardhshme, bazuar në qasjen e të gjithë shoqërisë. Mbështetja e OKB-së për **procesin e përafrimit të legjislacionit të BE-së dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare** do të fokusohet në të drejtat themelore dhe barazinë gjinore, reformat gjyqësore, veçanërisht drejtësinë penale dhe drejtësinë për fëmijët, menaxhimin e migracionit, luftën kundër korrupsionit dhe konfiskimin (rikuperimin) e pasurive, dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe mbrojtjen e viktimave. OKB-ja do të vazhdojë t'i përsheptojë politikatat dhe reformat institucionale që synojnë të sigurojnë planifikim dhe buxhetim të përgjegjshëm ndaj gjinisë, me ndjeshmëri ndaj moshës dhe aftësisë së kufizuar, si dhe shërbime cilësore me njeriun në qendër të vëmendjes. Duke e promovuar pjesëmarrjen e qytetarëve dhe ndërmjetësimin e të rinjve, grave dhe njerëzve të lënë pas nga vendimmarrja, OKB-ja do të kontribuojë në rritjen e qeverisjes demokratike dhe një kohezion më të madh të shoqërisë së larmishme të vendit.

Parimi askush të mos lihet pas, barazia gjinore, të drejtat e njeriut dhe vlerat dhe parimet e OKB-së të mishëruara në Kartën dhe traktatet e OKB-së do të vazhdojnë ta udhëheqin punën, planifikimin dhe mbështetjen e OKB-së për Maqedoninë e Veriut.

OKB-ja do të vazhdojë t'i promovojë dhe përmirësojë qasjet e koordinuara ndaj partneriteteve, mundësitë e përbashkëta dhe të koordinuara të financimit të KBZHQ-së dhe financimin dhe mbështetjen e OZHQ-së; dhe do t'i parashikojë, parandalojë dhe menaxhojë rreziqet që ndërlidhen me goditjet e brendshme dhe të jashtme që mund ta dëmtojnë përmbytshjen e Agjendës 2030.

Puna do të vazhdojë drejt objektivave të përcaktuara për mobilizimin e burimeve, duke përfshirë përpjekjet e përsheptuara për **ta rritur koordinimin e brendshëm në afrimin e donatorëve (Objektivi SMBR 2), përmirësimin e transparencës (Objektivi 5 SMBR) dhe shfrytëzimin e flukseve më të mëdha financimi (Qasja SMBR).**

Në fushën e inovacionit të biznesit, OKB-ja e Maqedonisë së Veriut më tej do t'i vlerësojë, rregullojë dhe nxisë proceset e brendshme për të promovuar dhe gjeneruar efikasitet më të madh operacional, sinergji dhe koherencë përmes zbatimit të Strategjisë së saj të Operacioneve të Biznesit dhe rrjedhave të tjera të përbashkëta të punës.

Link to the [2022 Joint Workplans](#)

Links to the SDCF document:

ENG MKD ALB



Shtojcat

Partnerët për vitin 2021 në Maqedoninë e Veriut

Qeveria dhe agjencitë shtetërore

Akademia e Gjykatëve dhe Prokurorëve
Gjykata Administrative
Agjencia e Kadastrës Shtetërore të Pasurisë së Patundshme
Agjencia për Rini dhe Sport
Komisioni kundër Diskriminimit
Byroja për Zhvillimin Rajonal
Byroja për Zhvillimin e Arsimit
Qendra për Punë Sociale
Qendrat për Zhvillimin e Rajoneve Planifikuese
Qyteti i Shkupit
Qendra e Menaxhimit të Krizave
Agjencia e Doganave
Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
Kabineti i Zëvendëskryeminit për përgjegjësi për Çështjet Ekonomike
Kabineti i Zëvendëskryeminit për përgjegjësi për Integrimin Evropian dhe Euro-Atlantik
Kabineti i Zëvendëskryeminit për përgjegjësi për Sistem Politik dhe Qeverisjen e Mirë
Drejtoria e Shëndetësisë Elektronike
Agjencia e Shërbimeve të Punësimit
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
Fondi për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik
Fondi i Sigurimeve Shëndetësore
Gjykata e Lartë Administrative
Instituti i Vepimtarive Sociale
Grupi i Punës Ndërmiror për Miratimin e Politikës së Migracionit
Gjyqësori
Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave
Ministria e Kulturës
Ministria e Mbrojtjes
Ministria e Ekonomisë
Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministria e Financave
Ministria e Punëve të Jashtme
Ministria e Shëndetësisë
Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës
Ministria e Punëve të Brendshme
Ministria e Drejtësisë
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
Ministria e Vetëqeverisjes Lokale
Ministri pa Portofol Përgjegjës për Diasporën
Qendrat Komunale për Mirëqenie Sociale (QKMS)
Komunat
Banka Popullore
Komiteti Nacional për Luftë kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe kundër Terrorizmit dhe Grupi i Punës Ndërinstitucional për Riintegrim
Komiteti Nacional për Luftë kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe kundër Terrorizmit
Trupi Koordinues Nacional për Zbatimin e KDPAK
Agjencia Nationale për Promovimin e Zhvillimit të Bujqësisë
Instituti Nacional i Shëndetit Publik
Parlamenti
Kabineti i Presidentit
Kabineti i Kryeminit
Prokuroria Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit
Drejtoria e të Ardhurave Publike
Enti Rajonale të Punësimit
Sekretariati për Çështjet Evropiane
Enti e Revizionit Shtetëror
Inspektorati Shtetëror i Punës
Enti Shtetëror i Statistikave
Gjykata Supreme

Zyra e Koordinatorit Nacional për Luftë kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe kundër Terrorizmit
Institutet për Trajnim Profesional

Organizatet e shoqërisë civile

Delegati Nacional i Rinisë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së
Akcija Zdruzenska
Shoqata e Zyrtarëve Financiar (AFO)
Shoqata e Punonjësve Sociale
Shoqata e Pedagogëve Specialë
Asociacioni i Njësive të Vetëqeverisjes Lokale
Shoqata ZMAI
Fondacioni Ballkanik për Zhvillim të Qëndrueshëm
Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje
Odat tregtare
Zyra e Lidhja së Vlerave Natyrore dhe të Njerëzve
Këshilli për Parandalimin e Delikucencës së të Miturve - SPPMD
Organizatet e punëdhënësve
Shoqatat e fermerëve
Projekti Opsionet e Shëndetit Shkup
Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës - Evropa Lindore dhe Azia Qendrore
IZBOR STRUMICA
Shoqëria Ekologjike Maqedonase
Kryqi i Kuq i Maqedonisë
Shoqata e Juristëve të Rinj Maqedonas
Federata Nazionale e Fermerëve
Qendra Nazionale Rome
OJQ SEGA PRILEP
Avokati i Popullit
Hapni dritare
Organizatet e personave me aftësi të kufizuara
Organizatet e prodhuesve
Shoqatat Profesionale
Sindikata e punëtorëve shëndetësorë
Sindikatat
Forumi Arsimit Rinor

Bota akademike

Shoqata për Kërkim, Komunikim dhe Zhvillim
Fakulteti i Shkencave të Bujqësisë dhe Ushqimit
Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë
Fakulteti Juridik "Justinian Prima"
Fakulteti i Mjekësisë Veterinare - Shkup
Shoqata e Edukimit dhe Kërkimit Shëndetësor
Akademia e Shkencave dhe Arteve e Maqedonisë
Fakulteti i Mjekësisë Shkup
Universiteti i Evropës Juglindore
Instituti Shtetëror i Bujqësisë
Klinika Universitare e Psikiatrisë
Universiteti "Goce Dellçev", Shtip
Universiteti i Sauthemptonit

Këshillat shumë partnerësh

Këshilli Ekonomik dhe Social i Maqedonisë së Veriut
Këshillat Lokale Ekonomike dhe Sociale të Maqedonisë së Veriut
Komisioni Nacional për UNESCO-n
Trupi Koordinues Nacional për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi dhe Neglizhenca
Këshilli Nacional për Barazinë Gjinore
Këshilli Nacional Trepalësh Social dhe Ekonomik

Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikucencës së Fëmijëve
Komisioni Nacional i UNESCO-s

Partnerët Ndërkombëtarë

Ambasada e Austrisë (ADA)
Ambasada e Britanisë
Banka Qendrore Evropiane (CEB)
Zyra Konsullore e Republikës së Sllovakisë
Delegacioni i Bashkimit Evropian në Maqedoninë e Veriut (DBE)
Nisma për Përgatitjen dhe Parandalimin e Fatkeqësive për Evropën Juglindore (NPPF E.JL)
Ambasada e Francës
Ambasada e Suedisë (SIDA)
Ambasada e Zvicrës (SDC, SECO)
Ambasada e Republikës së Turqisë
Ambasada e Federatës Ruse
Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)
Banka Evropiane e Investimeve
Fondacioni Evropian i Trajnimit (FET)
Konsullata e Përgjithshme e Belgjikës
Qendra e Gjenezës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë (DCAF)
Ambasada Gjermane
Ministria Federale Gjermane e Punës dhe Çështjeve Sociale
Ministria Federale Gjermane e Shëndetësisë
Partneriteti Global i Ujit - Mesdheu
Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ)
Qendra Ndërkombëtare për Migracionin
INTERPOL
Zhvillimi i Politikave (ICMPD)
Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës, Zyra Rajonale për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore (IUCN - ECARO)
Fondacioni Ndërkombëtar i Klubit Lions
Nisma Rajonale për Migrim, Azil, Refugjatë (MARRI)
Ambasada e Holandës
Rrjeti i Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS)
Misioni i OSBE-së në Shkup
Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë
Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO)
Programi Pan-Evropian i Transportit, Shëndetit dhe Mjedisit (THE PEP)
Ambasada e Shteteve të Bashkuara (USAID)
Grupi i Ekspertëve të UNECE për Efikasitetin Energjetik

Sektori privat dhe të tjerët

Oda e Avokatëve
Konfederata e Biznesit të Maqedonisë
Dhoma e Ndërmjetësuesve
Diaspora
Oda e Mjekëve
Media
Entet e Kujdesit Parësor
Kompanitë e ndryshme

[2] Programet e përbashkëta në vitin 2021

- **Planifikimi dhe diskursi i politikave të migracionit të bazuara në dëshmi në Maqedoninë e Veriut**, financuar nga [MPTF për Migracionin](#), implementuar nga IOM, UNHCR dhe UNFPA, 1.5 milion dollarë amerikanë, 30 muaj (tetor 2020 – prill 2023)
- **Shërbime shëndetësore të sigurt dhe novatore gjatë Covid-19**, financuar nga Fondi i Përgjigjes dhe Rimëkëmbjes nga Covid-19, implementuar nga UNFPA, OBSh dhe UNICEF, 850,000 USD, 14.5 muaj (janar 2021 – mars 2022)
- **Nga Njohuria dhe Angazhimi – drejt Fuqizimit dhe Pjesëmarrjes (KEEP)**, financuar nga UN PRPD dhe zbatuar nga UNDP, UNICEF dhe UNFPA, 400,000 USD, 36 muaj (shkurt 2021 - shkurt 2024)

[3] Trendet e treguesve të rezultateve të KBZHQ-së

INDIKATORI I REZULTATIT	KATEGORIA	PIKA THEMELORE	VITI BAZË	SYNIMI NACIONAL (2025)	VLERA MË E FUNDIT	TRENDI
Prosperitet gjithëpërfshirës						
Shkalla e punësimit (20-64)	Gjithsej (20-64 vjeç)	59.2	2019	63.1	59.44	↗
	Femra	48.4	2019	49.2	49.7	↗
	Meshkuj	69.8	2019	74.3	68.9	↘
	Gjithsej të rinj (15-29)	34.4	2019	34.9	32.63	↘
	Femra	28	2019	28.2	27.79	↘
	Meshkuj	40.4	2019	41.8	37.2	↘
Përqindja e punësimit informal në ekonominë totale	Gjithsej	16.1	2019	14	12.93	↗
	Femra	13	2019	nuk është caktuar	10.1	↗
	Meshkuj	18.1	2019	nuk është caktuar	14.89	↗
	Gjithsej të rinj (15-24)	24.01	2019	nuk është caktuar	16.53	↗
Përqindja e të rinjve që nuk janë as të punësuar e as në arsim dhe trajnim	15-29 vjeç	24.5	2019	22	24.26	↗
	Femra	28.3	2019	28.2	25.48	↗
	Meshkuj	20.9	2019	20	23.1	↘
	15-24 vjeç	18.1	2019	15.8	17.82	↗
	Femra	19.2	2019	19.1	16.83	↗
	Meshkuj	17.1	2019	16.9	18.75	↘
	25-29 vjeç	34.9	2019	33.3	34.7	↗
	Femra	43.1	2019	43	39.45	↗
	Meshkuj	27.1	2019	25.6	30.19	↘
Norma vjetore e rritjes së BPV-së reale për personat e punësuar		-1.3	2019	2.7	1.54	↗
Indeksi global i konkurrencës 4.0	Kategorizimi	82/141	2019	67	82	↔
	Pikë	57.3	2019	nuk është caktuar	57.3	↔
Shkalla e varfërisë së punës	Gjithsej	8.8	2019	7	10	↘
	Femra	6	2019	nuk është caktuar	nuk është e disponueshme	↔
	Meshkuj	10.6	2019	nuk është caktuar	nuk është e disponueshme	↔
Shërbime cilësore për të gjithë						
Përqindja e fëmijëve të moshës 36-59 muajsh që ndjekin një program edukimi në fëmijërinë e hershme (shkalla e pjesëmarrjes)	Gjithsej	39.8	2019	60	nuk është e disponueshme	↘
	Vajza	47.76	2019	55	Sondazhi i radhës në vitin 2022	↔
	Djem	52.24	2019	49	Sondazhi i radhës në vitin 2022	↔
Përqindja e fëmijëve dhe të rinjve në fund të arsimit të mesëm të ulët, që arrijnë të paktën nivelin minimal të aftësisë	Lexim	45	2018	2	2.5 (2019)	↔
	Matematikë	39	2018	2.2	2.4	↔
Nevoja e vetë-raportuar të paplotësuar për ekzaminim dhe kujdes mjekësor, % e popullsisë nga 16 vjeç e më lart	Gjithsej	2.3	2018	1.8	2.6	↘
	Femra	2.6	2018	>95	<90 (2020)	↗
	Meshkuj	2	2018	95	83.9	↘
Përqindja e popullsisë së synuar e mbuluar nga të gjitha vaksinat e përfshira në programin e tyre nacional	Mbulimi i të gjitha vaksinave	95	2018	95	68.5	↘
	3 doza të DTP3	92.5	2018			↘
	Doza e dytë e MCV2	74.8	2018	18.5	22.73 (2019)	↘
Probabiliteti i vdekjes nga ndonjë prej sëmundjeve kardiovaskulare (SKV), kancerit, diabetit, sëmundjet kronike të frymëmarrjes (SKF) midis moshës 30 dhe 70 vjeç		20.3	2016	20	Sondazhi i radhës në vitin 2023	↘
Shkalla e prevalencës së kontraktivëve modernë		14	2018	3.5	4.2	↔
Shkalla e vdekshmërisë neonatale		3.8	2019	14.5	Ende nuk ka të dhëna	↘
Përqindja e amvisërive të mbuluara nga transfertat e parave të mbrojtjes sociale		8	2019	0.78	0.774	↔
Indeksi i Zhvillimit Njerëzor	Pikët e indeksit	0.759	2019	nuk është caktuar	82	↗
	Kategorizimi	82/189	2019	not set	82	↔

INDIKATORI I REZULTATIT	KATEGORIA	PIKA THEMELORE	VITI BAZË	SYNIMI NACIONAL (2025)	VLERA MË E FUNDIT	TRENDI
Përqindja e popullsisë që jeton nën kufirin nacional të varfërisë	Total	21.9	2018	15.5	21.6	↗
	Female	22	2018	16.8	22	↘
	Male	21.8	2018	14.2	21.1	↗
	0-17 years old	29.3	2018	nuk është caktuar	27.8	↗
	Youth (15-24)	29.7	2018	nuk është caktuar	27.4	↗
	Adult (16+)	20.6	2018	nuk është caktuar	20.4	↗
	25+	19.2	2018	nuk është caktuar	19.3	↘

Mjedis i shëndetshëm



Emisja e gazrave serrë (Gg CO2-eq)		8,021	2016	6196	12,290* (2019)	↘
Shkalla e zonës së përgjithshme të mbrojtur, të përcaktuara nga shteti		10.34	2019	15	13.47	↗
Nivelet mesatare vjetore të grimcave të imta PM10 (µg/m3)		51.32	2019	<40	41.90	↗
INFORM Indeksi i rrezikut (2020) (në shkallë nga 1 deri në 10 ku 1 është shumë e ulët dhe 10 është shumë e lartë)	pikë	2.6	2020	2	2.5	↗
	niveli i rrezikut	Ulët	2020	shumë ulët	Ulët	↔
Ekziston sistemi për menaxhimin e integruar të dëmtuesve		Nuk ka sistem	2020	Sistemi ekziston dhe është plotësisht funksional	jo	↗
Përdorimi mesatar i pesticideve për sipërfaqe të tokës bujqësore (kg/ha)		0.22	2017	Mesatarja e BE-së: 3.14	0.3	↗
Shkalla e zbatimit të menaxhimit të integruar të burimeve ujore (0-100)	pikë			Shqipëria: 2.02		↗
	niveli	33	2020	60	40	↗
Pjesëmarrja e energjisë së rinovueshme në bruto totalin përfundimtar	konsumim i energji	mesatarisht-i ulët	2020	mesatarisht-i lartë	mesatarisht-i ulët	↗
	konsumi i energjisë elektrike	24.84	2018	46	23.53 (2020)	↘

Qeverisja e mirë



Indeksi i sundimit të ligjit (në përgjithësi, në një shkallë nga 0 në 1)		0.53	2020	Nuk është përcaktuar	0.53	↔
Indeksi i barazisë gjinore		62	2019	65	Sondazhi i radhës në vitin 2022	↔
Niveli i krijimit të mekanizmit të përhershëm koordinues nacional të të drejtave të fëmijëve		i dobët	2020	është themeluar	i dobët	↔
Vendi ka një sistem të vendosur për të gjurmuar dhe për të bërë ndarje publike për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave		Jo	2020	Po	Jo	↔
Indikatorët e qeverisjes anekënd botës	Average	49.72	2018	>60	52.92	↗
	Voice & accountability				50.24	↗
	Political stability & absence of violence/terrorism				50.47	↗
	Government effectiveness				57.69	↗
	Regulatory quality				68.75	↗
	Rule of law				52.4	↗
	Control of corruption				37.98	↗
Indeksi i buxhetit të hapur	Transparency	41	2019	>=45	41	↔
Përqindja e statistikave zyrtare në përputhje me legjislacionin e BE-së		67	2019	95	67 (2019)	↔
Niveli i kënaqësisë së përgjithshme me shërbimet publike në nivel lokal (në një shkallë nga 1 deri në 5)	Total	3.07	2020	3.5	2.97	↘
	Female					↘
	Male	3.12	2020	3.6	2.97	↘
	Urban	3.02	2020	3.4	2.97	↘
	Rural	3.09	2020	3.5	2.83	↗
Niveli i përafrimit të sistemeve të mbrojtjes dhe migrimit të refugjatëve me standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-së		3.05	2020	3.5	3.08	↗
Përqindja e popullsisë, që beson se vendimmarrja është gjithëpërfshirëse dhe e përgjegjshme	Pjesërisht e harmonizuar		2020	Plotësisht e harmonizuar	Kryesisht e harmonizuar	↘
		19.8	2020	25	19.3	

* Kjo shifër nuk paraqet rritje të shpejtë të emetimeve GS, por pasqyron ndryshimin e metodologjisë (duke përfshirë sektorin pyjor dhe emetimet nga numri i madh i zjarreve në pyje) dhe disponueshmërinë e të dhënave shtesë dhe të sakta. Me këtë përditësim, pritjet që objektivi nacional të rishikohet dhe të pasqyrohet në planet dhe raportet e ardhshme.

Shtojca:

**Rezultat e detajuara për vitin
2021**



REZULTATI 1

Prosperiteti gjithëpërfshirës



Deri në vitin 2025, niveli i jetesës së të gjithë njerëzve në Maqedoninë e Veriut të jetë përmirësuar përmes qasjes së barabartë në punë të denjë dhe punësimin produktiv të gjeneruar nga një ekosistem biznesi gjithëpërfshirës dhe inovativ

Kontributet për:



Parimet themelore: Zhvillimi Ekonomik dhe Konkurrenca

19. Politika sociale dhe punësimi;

20. Politika e ndërmarrjeve dhe industriale;

26. Arsimit dhe kultura

Shpenzimet e OKB-së në vitin 2021

\$7,394,489

Партнери:

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave; Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Sekretariati për Çështje Evropiane, Agjencia për Punësim; Zyrat Rajonale të Punësimit; Fondi për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik; Sindikatat tregtare; Shoqatat e punëdhënësve, Këshilli Ekonomik dhe Social; Këshillat Vendore Ekonomike dhe Sociale; Shoqatat e fermerëve, Organizatat e prodhuesve, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare - Shkup, Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati Shtetëror i Punës, Sindikatat, Agjencia për kadastrë të patundshmërisë, Qendra për punë sociale, Fakulteti i Bujqësisë dhe Shkencave Ushqimore, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Fondi për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik, IZBOR STRUMICA, Këshillat Lokale Ekonomike dhe Sociale të Maqedonisë së Veriut, Shoqata e Juristëve të Rinj Maqedonas, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Komuna e Gostivarit, Komuna e Prilepit, Komuna e Shtipit, Komuna e Manastirit, Komuna Çeshinové - Obleshevë, Komuna e Dollnenit, Komuna e Shuto Orizarit, Komiteti nacional për luftë kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe luftë kundër terrorizmit, Federata Nationale e Fermerëve, Agjencia Nationale për Promovimin e Zhvillimit të Bujqësisë, Këshilli Kombëtar Trepalësh Social dhe Ekonomik, OJQ "SEGA" PRILEP, Ombudsmeni, Universiteti i Evropës Juglindore, Inspektorati Shtetëror i Punës, Enti Shtetëror i Statistikës, Zyra e Koordinatorit Nacional luftë për kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe luftë kundër terrorizmit.

PRODHIMI 1.1. NDËRMARRJET E QËNDRUESHME TË KRIJUARA

Në vitin 2021, OKB-ja e vuri fokusin në mbështetjen e biznesit për ta përballuar krizën e zgjatur të COVID-19 dhe për të ndërtuar qëndrueshmërinë përmes [shërbimeve këshillimore dhe të digjitalizuara](#) me përmbajtje të zhvilluar në bashkëpunim me sektorin privat. Në kuadër të këtyre programeve, përmes UNDP-së, rreth **500 ndërmarrje të mesme, të vogla dhe mikro (NMVM)**, nga të cilat 30% të menaxhuar nga gratë, u mbështetën me mentorim dhe shërbime këshillimi biznesi, kryesisht në fushën e marketingut në internet dhe atë digjital. **Programet e vetëpunësimit të UNDP-së dhe UNOP-it** rezultuan me **72 biznese fillestare që krijuan rreth 80 vende të reja pune**, nga të cilat 28 për personat me aftësi të kufizuara, 5 prej tyre gra. Gjithsej, me ndërhyrje të ndryshme, duke përfshirë kryesisht në kuadër të **Programit të Punëve në Komunitet të UNDP-së**, OKB-ja asistoi në krijimin e mbi **1000 vendeve të punës**, nga të cilat 391 për të rinjtë.

ILO kontribuoi në mundësinë e punësimit të të rinjve, duke e mbështetur zbatimin e **Planit të garancisë rinore** që krijoi **6,787 vende pune për të rinjtë** në vitin 2021. Për më tepër, UNDP-ja punoi në ndërtimin e aftësive, duke përfshirë angazhimin përmes **Qendrës së Burimeve Rinore – iCan**, ofruar i sapokrijuar shërbimeve të trajnimit dhe qendër inovacioni, e cila ofron mbështetje për të rinjtë në rajonin e Pollogut në realizimin e punësimit përmes kërkimit të punës, krijimit të biznesit, karrierës, inovacionit dhe zhvillimit të aftësive, inkubacionit fillestar dhe të tjera. Qendra është njohur edhe zyrtarisht si zbatuese e "Programit të Praktikës" në kuadër të Planit Operativ Nacional të Punësimit 2021.

UNDP ndihmoi me ndërtimin e aftësive "të së ardhmes" përmes **platformës** që i bashkon bizneset, profesionistët e industrisë, botën akademike, sektorin publik, rrjetet e zhvillimit ekonomik për të bashkëpunuar mbi futjen e teknologjive të reja dhe për të arritur ndryshime transformuese. **Qendra e Trajnimit të Aftësive në të Ardhmen (FSC), SkillsNext**, u themelua dhe u pajis plotësisht në kampusin e UEJL-së, duke ofruar trajnime për aftësi digjitale, si modelimi i informacioneve për ndërtesat (MIN), dizajni 3D dhe energjia diellore për **mbi 306 persona**, duke përfshirë 156 nga industria e tekstilit, e ndërtimit dhe e

burimeve të rinovueshme. Përveç kësaj, **6 standarde të reja profesionale** u zhvilluan së bashku me 6 programe të reja të trajnimit për arsim profesional dhe trajnim. **ILO gjithashtu pajisi Laboratorin e aftësive të realitetit virtual me mjedise 3D**, animacion dhe ndërveprime me realitetin virtual si vend pune të simuluar për nxënësit e drejtimt arsimi profesional dhe trajnim (APF) në elektrikë dhe elektronikë, së bashku me një trajnim të zhvilluar në konsultim me Organizatën e Punëdhënësve të Maqedonisë. **Pasqyra profesionale** u përmirësua dhe u zgjerua teknikisht nga ILO në vitin 2021 dhe tani përmban profile të 60 profesioneve.

Projekt i zbatuar nga UNDP synonte forcimin e zinxhirëve të vlerës, duke futur teknologjinë e Paketimit të Atmosferës së Modifikuar (PAM) për të zgjatur jetëgjatësinë e produkteve



Qendra Burimore Rinore iCan, e mbështetur nga UNDP, shënoi një vit nga themelimi i saj në vitin 2021. Qendra me seli në Gostivar ofron shërbime unike për mësim, inovacion dhe punësim për të rinjtë nga rajoni i Pollogut. Foto: UNDP

të freskëta bujqësore, si dhe duke lehtësuar bujqësinë me kontratë për 30 familje bujqësore që punojnë në bujqësi organike.

UNESCO i promovoi **industritë kreative** si mundësi ekonomike përmes forumit ndërkombëtar Rrjeti i Qyteteve Kreative: "Industritë kreative - urë e së ardhmes midis kulturës dhe ekonomisë kreative" dhe ofroi mbështetje për zbatimin e projekteve të ndërlidhura në vend që do të vazhdojnë në vitin 2022.

PRODHIMI 1.2. PUNË PËR GRATË DHE PERSONAT E CENUESHËM/TË PËRJASHTUAR

Askush të mos lihet pas është pjesa qendrore e punës së OKB-së në të gjithë globin. Në këtë kontekst, UNDP-ja punoi për fuqizimin e grave, personave me aftësi të kufizuara (PAK) dhe atyre që kanë vështirësi të punësohen në Maqedoninë e Veriut me ndërhyrje të ndryshme për përfshirjen e tyre në tregun e punës. Si rezultat i kësaj, nga numri total i mbi 1000 vendeve të punës të krijuara, **të paktën 653 u përkasin grave, 52 romëve dhe 42 personave me aftësi të kufizuara**, duke përfshirë 28 në suaza të 20 bizneseve fillestare të krijuara nga PAK-të. Shumica e këtyre vendeve të punës janë mundësuar nga Programi i UNDP-së për Punë në Komunitet, përmes të cilit personat e papunë kanë ofruar mbi **120 shërbime të ndryshme sociale për mbi 8560 përfutues final në 46 komuna**.

Studimet e ndikimit socio-ekonomik treguan se shumica e vendeve të punës të humbura në tregun zyrtar gjatë krizës së COVID-19 u përkasin **grave**, të cilat, në të njëjtën kohë, kryejnë kryesisht shërbime të kujdesit të panjohur për të moshuarit, të sëmurët dhe personat me aftësi të kufizuara. Prandaj, **UNDP** e ka ndihmuar Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) për zhvillimin, financimin dhe zbatimin e dy masave të reja të punësimit në Ekonominë e kujdesit në vlerë prej 1.3 milionë dollarësh, me qëllim të njohjes dhe rishpërndarjes së punës së papaguar në këtë sektor. Të dyja masat pritet të sigurojnë një rrjet prej 150 kujdestarësh dhe individësh profesionistë të aftë dhe të kualifikuar në dispozicion për 600 persona në nevojë në kujdesin në shtëpi dhe asistencën dhe shërbimet e kujdesit të afatit. Përveç kësaj, **Qendra e Burimeve Rinore e mbështetur nga UNDP – iCan** fokusohet në ndihmën e grave sipërmarrëse veçanërisht në fushën e marketingut digjital. Deri më tani, më shumë se 500 gra morën pjesë në ngjarjet e organizuara nga qendra, ndërsa më shumë se **300 gra dhe vajza morën pjesë në kurse**, nga të cilat 70% ishin të moshës 29 vjeç e më lart.

UNDP i mbështeti ndërhyrjet e nivelit të politikave për ta lehtësuar përfshirjen e **personave me aftësi të kufizuara** në tregun e punës me qëllim të sigurimit të ofrimit efikas të shërbimeve të qëndrueshme dhe të standardizuara për PAK. Gjithashtu, u iniciua një program i ri për ngritjen e kapaciteteve të Organizatës së personave me aftësi të kufizuara (OPAK) për ta përfaqësuar në mënyrë efektive interesin e PAK-së. Në marrëveshje me MPPS-në, u përmirësua më tej mjedisi stimulues përmes tri qendrave të pushimit që punojnë me **PAK-të** – një qendër publike në Demir Kapi, një në Gostivar dhe e treta e udhëhequr nga një OJQ Humanost. Trajnimi për kujdesin dhe asistencën për të sëmurët afatgjatë, i zhvilluar për 80 persona në fund të vitit 2020 dhe i ofruar në partneritet me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Qendrën e Arsimit të të Rriturve dhe Qendrën për Arsim Profesional dhe Trajnim, mundësoi fillimin pa probleme të shërbimeve aktuale në fillim të vitit 2021. Përveç kësaj, **UNDP i mbështeti Qendrat Reha në Shkup dhe Strumicë**, të cilat ofruan shërbime për PAK, 150 në rehabilitim të orientuar drejt punës, 14 punësime të plota, 20 rekomandime për vetëpunësim, 25 të regjistruar në trajnime pune dhe 60 persona nën kujdesin institucional morën mbështetje psiko-sociale.

UNDP punoi gjithashtu në përfshirjen në tregun e punës së njerëzve që kanë vështirësi për t'u punësuar, duke u mundësuar **900 personave ta plotësojnë të paktën një program të të mësuarit të aftësive**, ku mbi 70% prej tyre ishin gra. Gjithsej **474 persona përfutuan nga shërbimet e aktivizimit dhe mbështetjes së punës**, nga të cilët të paktën

206 romë dhe 150 PAK. Në kuadër të programit ACCEDER, mbi 2000 gra rome u informuan për mundësitë e punësimit. Romët u fuqizuan më tej me finalizimin e kopshtit të vetëm në vendbanimin me **romë**, në Shuto Orizarë, duke i zgjeruar kapacitetet në gjithsej 306 fëmijë. UNDP gjithashtu punon në modelin e parë funksional të qendrës së angazhimit në komunitet për përfshirjen e 100 fëmijëve në rrezik. Gjithashtu, në 10 komuna 43 përfutues të asistencës minimale të garantuar janë angazhuar në shërbime që kanë të bëjnë me COVID-19. **Sistemi arsimor i burgjeve** u mbështet gjithashtu nga **UNDP, duke rezultuar me 16 gra dhe 12 të mitur nga gjithsej 67 të burgosur**, që e kanë përfunduar arsimin fillor, për t'i përmirësuar perspektivat e tyre për riintegrim në shoqëri. Përfundimi i arsimit fillor është vënë në dispozicion edhe për 52 romë (nga mbi 206).

Në bashkëpunim me Shoqatën e Juristëve të Rinj Maqedonas dhe Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, **UNHCR-ja** punoi së bashku me entitete tjera përkatëse nacionale për t'i identifikuar sfidat dhe mundësitë e lehtësimit të njohjes adekuate të aftësive profesionale dhe njohurive të specializuara të atyre që nuk kanë dëshmi formale se kanë certifikatë ose diplomë, siç janë **refugjatët. Tryeza e organizuar me 15 aktorë institucionalë** e rriti të kuptuarit e tyre për praktikat pozitive dhe kufizimet e kapaciteteve të refugjatëve për t'u angazhuar në jetesë të qëndrueshme, mbetet më shumë punë për t'i bërë në këtë fushë së bashku me partnerët përkatës. Për më tepër, UNHCR dhe partnerët (Kryqi i Kuq i Qytetit) e mbështetën qasjen në punësim për refugjatët, duke u fokusuar në fuqizimin e shkathhtësive të buta, trajnime të aftësive kompjuterike, mbështetje për lehtësimin e qasjes në programet nacionale të trajnimit profesional dhe masat e punësimit, duke ofruar informacion dhe mbështetje për punësimin formal. Pavarësisht përpjekjeve, zyrtarisht në vitin 2021 nuk u punësua asnjë nga refugjatët.

Për të mundësuar partneritetet lokale të sektorit publik dhe privat, **ILO** e mbështeti një **Plan pilot lokal të punësimit (PLP)** në Manastir, ku Qendra e themeluar e Startup-it rezultoi në 35 vende pune të krijuara (10 - përmes programit fillestar, 10 përmes trajnimit për IT dhe 15 përmes panairit të karrierës). Për më tepër, bazuar në vlerësimin e dobësive të të kthyerve, **UNDP** nënshkroi memorandume të mirëkuptimit me 3 komuna, të cilat e synojnë forcimin e sistemit lokal për **riintegrim** më efektiv socio-ekonomik të **të kthyerve**. Për këtë qëllim u mobilizuan 1,5 milionë dollarë amerikan nga Komisioni i BE-së, (Drejtoria e Regjistrimit për Politika të Fqinjësisë dhe Negociatave për Zgjerim) si pjesë e projektit më të madh rajonal të zbatuar në 3 vitet e ardhshme. Ndërhyrjet mbështetëse të deritanishme kanë rezultuar me 518 të papunë të cilët e kanë përfunduar formimin profesional, mbi 77% e tyre gra dhe 87% konkretisht në shërbime të kujdesit.

PRODHIMI 1.3. POLITIKA DHE MASA RREGULLATORE TË ZGJERUARA DHE TË PËRGJEGJSHME NDAJ GJINISË

Gjatë gjithë vitit, OKB-ja asistoi në hartimin e dokumenteve të politikave, duke përfshirë ligjet, masat dhe strategjitë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Punës (SNP) dhe legjislacionin e BE-së. Fokus i u vu edhe në krijimin dhe zbatimin e shërbimeve të punësimit për kompanitë dhe grupet e cenueshme, si dhe në ngritjen e kapaciteteve për dialog social funksional në procesin e konsultimeve ligjore.

Strategjia e re Nacionale e Punësimit (SNP) 2021-2027, së bashku me Planin të ri të Veprimit për Punësim 2021-2023 dhe Planin e Punës për Perspektivat Profesionale 2022-2026 janë zhvilluar dhe miratuar me mbështetjen e ILO-s. SNP-ja përfshin tre objektiva kryesore të politikave: 1. përmirësimin e cilësisë së rezultateve të arsimit dhe trajnimit për të gjithë (përfshirë adresimin e mospërputhjes së aftësive); rritja e përqindjes së rezultateve të PISA 2025 në arsimin e të rriturve); 2. rritjen e politikave të zhvillimit ekonomik dhe të ndërmarrjeve për të krijuar vende të denja pune (p.sh. përmirësimi i indeksit të konkurrencës; rritja e punësimit në 60% dhe ulja e papunësisë së të rinjve në 27/23%) dhe 3. forcimi i përfshirjes së politikave të tregut të punës, duke përfshirë zvogëlimin e hendekut gjinisë për punësimin në

15%; papunësia afatgjatë me 10% dhe njerëzit në rrezik të varfërisë dhe përjashtimit social në 18%.

Gjithashtu, **UNDP-ja** asistoi në hartimin e **Strategjisë së parë Nacionale për Zhvillimin e Ndërmarrjeve Sociale (2021-2027)** me një **Plan Veprimi trevjeçar**, si hap i parë drejt krijimit të një ekosistemi të favorshëm për zhvillimin e ndërmarrjeve sociale, të miratuar në vitin 2021.

Me ndihmën e **UN Women dhe FAO** dhënë Grupit të punës për barazinë gjinore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEE), aspektet gjinore u përfshinë në Strategjinë e re **Nacionale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2021-2027**, të miratuar nga Qeveria në fillim të vitit 2021.

Mbështetja ligjore përfshinte mbështetjen e **ILO** për hartimin e **Ligjit për marrëdhëniet e punës**, i cili përmban dispozita, të cilat i vënë në pah realitetet e reja në tregun e punës (p.sh. puna nga distancë), në veçanti rregulloret e formave jostandarde të punësimit bazuar në diagnozën nacionale të kryer nga OKB-ja për format e ndryshme të punës, aranzhimet e punës në vend me rekomandime politikash për të siguruar mbrojtje efektive të punës dhe mbrojtje sociale.

UNDP-ja gjithashtu e mbështeti hartimin e **Ligjit të ri për punësimin dhe sigurimet** duke adresuar boshllëqet strukturorë ndërmjet rregulloreve të ndryshme dhe aspekteve ligjore që mundësojnë ose pamundësojnë përfshirjen e PAK-së në tregun e punës. Modelet e zhvilluara përmes partneritetit publiko-privat (PPP) do ta përfshijnë gjithashtu zhvillimin e mekanizmave financiarë, që do t'i mbështesin shërbimet e rehabilitimit të orientuar drejt punës dhe mekanizmat për kontraktimin social.

Mbështetja teknike është ofruar nga **UNDP** për hartimin e një **Ligji të ri për arsimin e të rriturve**, bazuar në Konceptin dokumentin për arsimin e mesëm të të rriturve dhe Konceptin për qendrat rajonale të APT-së, që rregullon **arsimin gjithëpërfshirës** në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF), Konventën mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe OZHQ-të. Në këtë fushë OKB-ja siguroi 68 asistentë për nxënësit me aftësi të kufizuara në shkollën e mesme si pjesë e Programit të Punës në Komunitet.

Ligji i ri për shitjen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Udhëzimet Vullnetare për Qeverisjen Përgjegjëse të Zotërimit të Tokës, Peshkimit dhe Pyjeve, u përgatit me ndihmën e FAO-s dhe konsultimin e gjerë publik. Ky hap i rëndësishëm për vënien e tokës bujqësore në pronësi shtetërore, përfshirë tokën e braktisur, në funksion të zhvillimit bujqësor dhe prodhimit të ushqimit do të përfundojë me miratimin e tij në vitin 2022.

Me **mbështetjen** e **ILO-s**, **Këshilli Ekonomik dhe Social (KES)** u pozicionua si protagonist i rëndësishëm në zhvillimin e politikave ekonomike, të punës dhe sociale. Për shembull, Agjencia për Punësim e udhëhoqi me sukses diskutimin trepalësh mbi masat kundër krizës, duke zgjatur subvencionet e pagave për një periudhë më të gjatë në përputhje me rekomandimet në dokumentet e politikave të ILO-s; madje ka ndikuar në Ligjin e Marrëdhënieve të Punës dhe zgjidhjen ligjore për të dielën si ditë jopune. Dokumentet analitike të ILO-s mbuluan më tej tema në fushën e sipërmarrjeve të qëndrueshme dhe kulturës sipërmarrëse, negociatave kolektive, treguesve të punës dhe varfërisë dhe strategjive të aktivizimit të punës. Përveç kësaj, **ILO mbështeti 12 këshilla lokale ekonomike dhe sociale (KLES)** me diagnostikimin dhe rekomandimet e tregut lokal të punës për ta mbyllur boshllëkun e aftësive dhe për të kapërcyer mospërputhjen e tregut, si dhe përpiloi dy Plane Lokale të Veprimit për Punësim (Strumicë dhe Kumanovë). Vizibiliteti dhe komunikimi i KLES-it është përmirësuar përmes **platformës** së komunikimit.

ILO i ofroi ndihmë **KES-së** për ta zgjeruar numrin e shërbimeve të ofruara për anëtarët, gjë që rezultoi me rritjen e anëtarësimit, duke përfshirë 5400 anëtarë të rinj (deri në 9%) në Federatën e Sindikatave Tregtare (FST) dhe 1 degë të re sindikale në Konfederatave e Sindikatave të Pavarura (KSP), 4 anëtarë të rinj me 1,800 punëtorë në

Organizatën e Punëdhënësve (OP) dhe 20 anëtarë të rinj me 600 punëtorë në Konfederatën e Bizneseve të Maqedonisë (KBM). Shërbimet e reja përfshijnë **10 shërbime të reja dhe të digitalizuara të FST-së**, duke përfshirë një këshillatë virtuale Cindy për ndihmën juridike të disponueshme në faqen e internetit dhe **aplikacionin celular** për të raportuar shkeljen e të drejtave të punëtorëve; **Platforma e-learning** me trajnime për Legjislacionin e Punës dhe Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në dispozicion nga OP, si dhe analiza dhe të dhëna krahasuese për pagat brenda dhe ndërmjet industrive. Konfederata e Sindikatave të Pavarura (KSP) ofroi **udhëzime për të drejtat e punëtorëve** dhe ofroi një platformë onlajn për **regjistrim** të anëtarëve. Një Këndi Ligjor dhe Platforma e Qendrës Burimore për ndërmarrjet mikro të vogla dhe të mesme është tashmë në dispozicion në **KBM** me mbështetjen e ILO-s, si dhe trajnime për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe mbrojtjen e punëtorëve nga ngacmimet në punë, duke përfshirë një linjë SOS me gjithsej 506 thirrje në degët e Sindikatës të Sigurisë dhe Mbrojtjes (SSM).

Agjencia për Punësim (AP) u mbështet nga **UNDP** për të ofruar shërbime këshillimore të digitalizuara përmes Platformës së Biznesit në internet për t'i kundërshtuar kufizimet e kontakteve fizike dhe për ta rritur efikasitetin e ofrimit të shërbimeve. Në këtë kontekst, qasja onlajn për të papunët është mbështetur me Sistemin e Menaxhimit të Dokumenteve dhe ndërvëprimin me bazat e tjera të të dhënave, kryesisht me Drejtorinë e të Ardhurave Publike. **ILO** ka asistuar gjithashtu me **modulet e mësimit onlajn të disponueshme për stafin e AP-së** në fushën e vlerësimit të shërbimeve dhe programeve; ii) hartimin dhe zbatimin e programeve aktive të tregut të punës dhe profilizimit, iii) segmentimin dhe targetimin e klientëve. Kapaciteti i AP-së për monitorim dhe raportim është zhvilluar më tej me ndërhyrjet e **UNDP-së**, duke u fokusuar të këshilltarët e trajnuar të biznesit dhe këshilltarët transportues.

Me ndihmën e **UNDP-së**, AP-ja ka ofruar trajnime me kërkesa të larta për 150 të papunë, të përfunduar me sukses nga 139 pjesëmarrës, prej të cilëve 34 ishin të punësuar. Gjithashtu, në kuadër të masave aktive të tregut të punës për aftësim profesional dhe trajnim, rreth 74 punëdhënës kanë aplikuar përmes programit të APT-së të hartuar në bazë të nevojave të tyre, ndërsa 182 të papunë janë trajnuar, duke garantuar të paktën 91 punësime pas përfundimit të trajnimit. Sistemi për trajnimin e 200 mentorëve për APT në kompani është përkrahur në mënyrë plotësuese.

Gjithashtu janë dizajnuar dhe zbatuar **shërbime të reja sociale**, me ndihmën e UNDP-së, siç janë dy masat e reja të ekonomisë së kujdesit të përfshira në planin operativ 2021 për punësim të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (MPPS).

Në përgjigje ndaj COVID-19 dhe goditjeve të tjera të mundshme, **FAO** punoi në forcimin e kapaciteteve në sistemet e informimit për çmimet dhe tregun dhe për monitorimin e politikave për mallrat ushqimore dhe zinxhirin e vlerës. Në këtë kontekst, përfaqësuesit e Maqedonisë së Veriut morën pjesë në trajnimin ndërkombëtar për Monitorimin dhe Analizën e Çmimeve të Ushqimit (MNÇU), të zhvilluar pas rritjes së çmimeve të vitit 2008 me të dhëna nga pothuajse 90 vende globale për të ofruar një qasje të lehtë në të dhënat dhe krahasimet e trendeve në nivel nacional. Për shkak të COVID-19 përgatitjet për MNÇU në Maqedoninë e Veriut u vonuan disi, andaj ky mekanizëm do të testohet dhe zhvillohet plotësisht në vitin 2022. Trajnimi përfshinte gjithashtu Bilanci i gjendjes së drithërave të vendit (BGJDV), duke ofruar një pasqyrë gjithëpërfshirëse të modeleve të ofertës dhe kërkesës së përgjithshme për ushqim të vendit, për kushtet gjatë një periudhe të caktuar të referimit, si dhe Observim të Tokës për Monitorimin e kulturave, si një pasqyrë e vlefshme mbi disponueshmërinë e ujit dhe shëndetin e vegjetacionit gjatë sezoneve të mbjelljes. Në këtë drejtim është siguruar ndërtimi i kapaciteteve nëpërmjet projektit rajonal të **UNECE**, i cili synon rritjen e kapaciteteve të ekonomive në tranzicion të Ballkanit Perëndimor për zbatim të **masave të lehtësimit të tregtisë dhe Dritares së vetme**.

PRODHIMI 1.4. PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË PUNËSIMIT

Në vitin 2021, OKB-ja vazhdoi të punojë me institucionet shtetërore për trajtim të çështjes së nivelit të ulët të punësimit, punësimit joformal dhe mbrojtjen në punë. Në këtë kontekst, ILO e mbështeti zbatimin e **Strategjisë për formalizimin e ekonomisë joformale**, bazuar në një konsensus trepalësh të masave për luftë kundër informalitetit. Përveç kësaj, platforma sektoriale HORECA u zhvillua në partneritet me Shoqatën e Punëdhënësve të Hotelarisë dhe Furnizimit me Ushqim (HOTAM), që gjendet në [faqen e tyre të internetit](#), në mënyrë që të ndihmojë në zbatimin e masës në vitin 2022.

Bazuar në analizën e boshllëqeve të **ILO-s për Konventën 190 të ILO-s për dhunën dhe ngacmimin dhe Udhëzuesin për Konventën për Dhunë dhe Ngacmim**, të botuar në gjuhën maqedonase dhe numrin e produkteve për [ngritjen e vetëdijes](#), Këshilli Ekonomik dhe Social e mbështeti plotësisht ratifikimin e Konventës. Në fakt puna për ratifikimin do të vazhdojë në vitin 2022.

Për më tepër ILO ka ndihmuar me një sërë ndërhyrjesh të ndërlydhura, duke përfshirë dy fushata: [Puna ime, të drejtat e mia!](#) (më shumë se 20.000 përdorues) dhe fushata për zyrtarizimin e punës së padeklaruar - [Kujdesuni për stafin tuaj](#).

Këshilltarja virtuale Cindy për **ndihmën juridike** e disponueshme në faqen e internetit të Konfederatës së Sindikatave të Pavarura (KSP) dhe aplikacionin celular për raportimin e shkeljeve të të drejtave të punëtorëve, e zhvilluar me ndihmën e ILO-s, rezultoi me mbrojtje ligjore të ofruar për 3000 punëtorë bazuar në 95 raporte, të realizuara në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Punës. Nëpërmjet Departamentit të Ndhmës Juridike Falas, KSP ka zgjidhur 83 raste së bashku me 450 konsulta ligjore telefonike/onlajn për çështje juridike.

Më shumë se 600 të rinj e kanë shkarkuar aplikacionin e zhvilluar nga ILO dhe kanë marrë pjesë në konkursin Youth Rights @ Work (Të drejta e rinisë @ Puna), si pjesë e fushatës Puna ime, të drejtat e mia. Përveç kësaj, materialet mësimore të zhvilluara nga ILO (Youth Rights@Works) u miratuan zyrtarisht nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit dhe **iu dorëzuan 500 nxënësve të shkollave të mesme nga 12 qytete**, ndërsa 500+ nga 56 shkolla të mesme morën pjesë në kuisin për të drejtat bazë të punëtorëve.

PRODHIMI 1.5. EKONOMIA RURALE E QËNDRUESHËM DHE KONKURRENTE

OKB-ja ofroi ndihmë të konsiderueshme për autoritetet nacionale për ta forcuar konkurrencën dhe qëndrueshmërinë e ekonomisë rurale, duke i rritur mundësitë për gratë dhe fermerët e vegjël.

Në kuadër të projektit të **FAO**, fokusi është vënë në **konsolidimin e tokës** bujqësore prej rreth 3 000 hektarësh në tetë zona aktive të konsolidimit të tokës, duke mbuluar 2 455 pronarë tokash dhe fermerë të vegjël (nga të cilët 608 ose 24,7 % janë gra). Në vitin 2021, me përfshirjen aktive të palëve përkatës, përfshirë Agjencinë e Kadastrës së Pasurive të Patundshme, Agjencinë Nacionale për Promovimin e Zhvillimit të Bujqësisë, pushtetin vendor, organizatat e fermerëve dhe sektorin privat, ky procesi është finalizuar në fshatin Egri, me evidentimin e ri të tokës së konsoliduar dhe të mbështetur me infrastrukturë të plotë ndërtimore (kanalet kulluese, vaditje dhe rrugë me zhavorr) dhe pothuajse i përfunduar në fshatin Dabjan. Toka e përgjithshme e konsoliduar në të dy fshatrat arrin në 1 078 hektarë, nga e cila kanë përfituar 300 pronarë tokash bujqësore, familjet dhe komunitetet e tyre. Numri i parcelave në Egri është **reduktuar pothuajse katërfish**, nga 874 parcela në 260, me një madhësi mesatare parcelash prej 1.30 hektarë, krahasuar me vetëm 0.38 hektarë përpara konsolidimit të tokës. Në **Dabjan** numri i parcelave të tokës është reduktuar nga 602 në 127 parcela, me një madhësi mesatare prej 5,84 hektarë, nga vetëm 1,23 hektarë para konsolidimit të tokës. Parcelat e sapoformuara kanë formë të rregullt dhe mundësojnë praktika më efikase bujqësore.

Ndërhyrjet mundësojnë gjithashtu qasjen e barabartë të grave në pronësi dhe kontroll mbi tokën bujqësore, duke kërkuar pëlqimin e bashkëshortëve për pronën e fituar gjatë martesës në fazën e rindarjes së tokës dhe duke promovuar regjistrimin e parcelave të reja të tokave të konsoliduara në emër të të dy bashkëshortëve.

Përveç përfshirjes së aspekteve gjinore në Strategjinë e re Nacionale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2021-2027 të ndihmuar nga **UN Women dhe FAO**, barazia gjinore në Programin Nacionale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2018-2022 u përmirësua gjithashtu me mbështetjen e **UN Women**. [Me Masën 115](#) të këtij programi, 250 gra prodhuese bujqësore morën mbështetje financiare për fuqizim të bizneseve të tyre. Për më tepër, **UN Women** e nënshtroi një marrëveshje partneriteti me Fakultetin e Shkencave Bujqësore dhe Ushqimit – Shkup për të mbështetur MBPEE-në me hulumtime relevante, analiza të politikave dhe forcimin e kapaciteteve për fuqizimin e grave në sektorin e bujqësisë.

FAO e ndihmoi MBPEE-në **për t'i forcuar kapacitetet për analizën dhe programimin e politikave** me udhëzime të bazuara në dëshmi për përafrimin e skemës nacionale të pagesave të drejtpërdrejta me rregulloret e Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE-së (CAP) të përpunuara në **ndikimin e politikave** "Ndikimi i pagesave të drejtpërdrejta të shpërndajtura në të ardhurat e fermerëve në Maqedoninë e Veriut". Duke llogaritur koston e dhjetë produkteve bujqësore me rëndësi të konsiderueshme ekonomike, sociale dhe strategjike për sektorin e ushqimit dhe bujqësisë në Maqedoni në pesë skenarë të ndryshëm, analiza tregon se, mesatarisht, veçimi i pagesave të drejtpërdrejta do të ketë efekt pozitiv në të ardhurat e fermerëve. Gjithashtu, **FAO** ofroi trajnime të specializuara për 35 këshilltarë në Agjencia Nacionale për Promovimin e Zhvillimit të Bujqësisë dhe pesë zyrtarë të MBPEE-së për mbledhjen e të dhënave dhe llogaritjen e koston së marzhit bruto të prodhimit për dhjetë mallra bujqësore.

FAO gjithashtu i forcoi **kapacitetet për zhvillimin e integruar të komunitetit lokal** në gjashtë fshatra, me investime në shkallë të vogël (p.sh. rinovimi i objekteve, riparimi, pajisja) të bazuar në analizën themelore të komunitetit, që synon ta rrisë atraktivitetin dhe cilësinë e jetës rurale, në sinergji me mbështetjen e vazhdueshme për tokën bujqësore konsolidimi në të njëjtat zona.

REZULTATI 2

Shërbime cilësore për të gjithë



Deri në vitin 2025, njerëzit në Maqedoninë e Veriut kanë qasje universale në shërbime sociale cilësore të bazuar në të drejta, si kujdesi shëndetësor, arsimit dhe mbrojtje e nevojshme sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve, të rrënjosura në sisteme të qëndrueshme ndaj situatave emergjente

Shpenzimet e OKB-së në vitin 2021

\$9,967,640

Kontributi për



Grupi 2, Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorëve dhe shëndetit
Grupi 3, Kapitulli 19: Politika Sociale dhe Punësimi; Kapitulli 25:
Shkencë dhe hulumtimi, Kapitulli 26: Arsimit dhe kulturë

Partnerët e zhvillimit:

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Arsimit dhe Shkencës; Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Enti Shtetëror i Statistikës, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Instituti Shtetëror i Shëndetësisë Publike, Komunitet, Institutet e formimit profesional; Sindikata e punëtorëve shëndetësorë; Shoqëria civile; bota akademike; sektori privat; Shoqata për Hulumtim, Komunikim dhe Zhvillim, Qendra Nacionale e Romëve, Qendra për Kërkim dhe Krijim Politikash, organizata të shoqërisë civile (OSHC), Drejtoria e Shëndetit Elektronik, Shoqata për Arsim dhe Kërkim Shëndetësor, Fondi për Sigurim Shëndetësor, Projekti Opsionet e Shëndetit Shkup, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Shoqata e Juristëve të Rinj Maqedonas, Fakulteti i Mjekësisë Shkup, Qendrat Komunale për Mirëqenie Sociale (QKMS), shoqatat profesionale,

PRODHIMI 2.1. QASJE UNIVERSALE NË SHËRBIME SHËNDETËSORE ME CILËSI TË LARTË TË PËRBALLUESHME

Menaxhimi i përmirësuar i pandemisë KOVID-19 dhe shërbime më të mira të kujdesit shëndetësor për pacientët me KOVID-19

OBSH-ja ofroi mbështetje gjithëpërfshirëse dhe thelbësore në ndërtimin e kapaciteteve nacionale për menaxhim më të mirë të pandemisë dhe kujdesin për pacientët me KOVID-19 përmes:

- ndërtimit të kapaciteteve të zbulimit të SARS CoV 2 të laboratorëve të Shëndetit Publik, duke siguruar gatishmërinë e testimit të laboratorit nacional të virologjisë. Më pas, u siguroa realizimi i pandërprerë i testimit cilësor përmes prokurimit në shkallë të gjerë të pajisjeve, furnizimeve dhe pajisjeve për mbrojtje personale për laboratorët, bazuar në vlerësimin e fuqishëm të kapacitetit si dhe trajnimin javor të pandërprerë për testimin, raportimin dhe biosigurinë. Gjithashtu janë bërë investime në infrastrukturë dhe përmirësimin e serverëve për mbikëqyrjen dhe punën laboratorike dhe Strategjinë Nacionale të Sekuencës Gjenomike, të zhvilluar dhe miratuar nga Ministria e Shkencës.

- krijimit të një Qendre Operative të Inteligjencës Epidemike dhe Emergjencave, e cila i rriti kapacitetet për realizim të menaxhimit strategjik dhe monitorimit të emergjencave, e forcoi komunikimin dhe koordinimin, si dhe mundësinë e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve për gjurmimin e kontakteve.

- krijimit të një Platforme Trajnimi Onlajn për KOVID-19 në gjuhët lokale (maqedonisht dhe shqip), duke mundësuar

trajnimet dhe asistencë teknike në kohë të duhur për të gjithë profesionistët shëndetësorë për menaxhimin e rasteve të pacientëve me KOVID-19, kontrollin dhe parandalimin e infeksioneve (PKI), rehabilitimin, shëndetin mendor e të ngjashme. duke siguruar një qasje të qëndrueshëm për kurse të akredituara për dhe një shkallë të lartë përvetësimi në nivele të ndryshme të kujdesit.

- zbatimit të vazhdueshëm të aktiviteteve të komunikimit të rrezikut dhe angazhimit të komunitetit për ndërtimin e besimit të komunitetit, që synojnë rritjen e marrjes së sjelljeve mbrojtëse dhe parandaluese të KOVID-19 me grupet e identifikuara përmes studimeve të vështrimeve të sjelljes, të realizuara nga OBSH.

- zhvillimit të kapaciteteve të menaxhimit infodemik të autoriteteve nacionale shëndetësore, organizatave të verifikimit të fakteve, agjencive të OKB-së dhe partnerëve ndërkombëtarë.

- mbështetjes së digjitalizimit dhe përmirësimit të sistemit elektronik shëndetësor "Moj Termin" (Takimi im), duke përfshirë: digjitalizimin e të gjithë laboratorëve që kryejnë testimin për KOVID dhe unifikimin e sistemit të të dhënave për testet pozitive dhe lidhjen me mjekët familjarë dhe epidemiologët; digjitalizimi i sistemit të mbikëqyrjes së kontakteve; zhvillimi i modulit të telemjekësisë për vazhdimin e shërbimeve shëndetësore; zhvillimi i një baze të dhënash të modulit të të gjitha profileve ekzistuese të burimeve njerëzore shëndetësore dhe modulit të vlerësuesit të furnizimit dhe pajisjeve; digjitalizimi i pyetësorit elektronik epidemiologjik për KOVID-19, si dhe regjistri i plotë i pacientit me KOVID-19 me importim dhe analitikë të të dhënave retroaktive.

- digjitalizimit të sistemit nacional të vaksinimit dhe integritet të tij në sistemin nacional të e-shëndetit "Moj Termin", për ta garantuar një proces efikas të vaksinimit, regjistrimeve të duhura dhe lëshimin e certifikatave të pacientëve si dhe afrimin më të shpejtë me popullatën e synuar.

UNOPS e mbështeti Qeverinë në prokurimin dhe dorëzimin e një liste të dakorduar të pajisjeve mjekësore me Ministrinë e Shëndetësisë për të kontribuar në parandalimin, zbulimin dhe përgjigjen ndaj kërcënimit të paraqitur nga KOVID-19, dhe për ofrimin e kontributit në forcimin e sistemeve nacionale për përgatitshmërinë e shëndetit publik. Instituti për radiologji iu dhanë dy kabina me radiofrekuencë, dy sisteme të rezonancës magnetike dhe dy sisteme tomografie kompjuterike. Një citometër rrjedhës iu dha klinikës universitare për hematologji. UNICEF-i gjithashtu dhuroi pajisje për mbrojtje personale (PMP) (200.000 maska dhe 200.000 mbulesa çizmesh) për Ministrinë e Shëndetësisë ndërsa OBSH siguroi pajisje dhe furnizime mjekësore: pajisje biomjekësore, PMP, pajisje diagnostikuese dhe jo mjekësore.



Një burrë duke pranuar vaksinën e parë kundër KOVID-19 gjatë Javës Evropiane të Imunizimit në Shkup. Foto: WHO

Rishikimi i **Planit nacional të vendosjes dhe vaksinimit për vaksinimin kundër COVID-19** siguroi veprim nacional koherent dhe efikas, i forcoi kapacitetet e imunizimit dhe futjen e modaliteteve të reja të ofrimit të shërbimit të vaksinimit për targetimin e grupeve të cënueshme. Me mbështetjen e **OBSH-së, baza nacionale e të dhënave e imunizimit elektronik** u lidh me të dhënat nacionale të shëndetit elektronik dhe sistemin e raportimit, duke mundësuar mbikëqyrjen e plotë të situatës së vaksinimit të të gjithë popullatës. Kapacitetet e **60 menaxherëve shëndetësorë** në qendrat shëndetësore dhe institutet e shëndetit publik dhe **340 punonjësve shëndetësorë** që punojnë në pikat e vaksinimit u forcuuan duke siguruar cilësi më të mirë të imunizimit dhe menaxhim efikas të zinxhirit të shpërndarjes së në pajisje me ftohje të vaksinave të reja kundër COVID-19.

UNICEF-i i bashkoi përpjekjet duke mbështetur Ministrinë e Shëndetësisë me fushatën **"Vaksina shpëton jetë"**, që synonte t'i adresonte dezinformatat, që po e nxinin hezitimin në lidhje me marrjen e hershme të vaksinave kundër COVID-19 dhe në përgjithësi ndërtimit të besimit në imunizim. Fushata e transmetuar në televizionin satelitar për **77% të popullsisë mbi 18 vjeç, të cilët e kishin parë të paktën një herë** dhe 62%, që e kishin parë të paktën tre herë. Përderisa fushata u zhvillua në të gjitha kanalet e mediave sociale, në fejsbuk rreth 30 postime arritën qasje mesatarisht të 75,000 njerëz dhe angazhuan rreth 21,000 njerëz. Si rezultat i kësaj, sipas **OBSH-së** të kryera rregullisht Anketat e Vështrimeve të Sjelljes, numri i njerëzve që besojnë se një vaksinë mund të ndihmojë në kontrollin e përhapjes së COVID-19 u rrit nga **56% në dhjetor të vitit 2020 në 69% në qershor të vitit 2021**.

Sondazhi i njohurive të sjelljes për vaksinën MMR1, i mbështetur në UNICEF, i përfunduar në fillim të vitit 2021, i identifikoi barrierat kryesore për marrjen e vaksinave si në anën e kërkesës ashtu edhe në atë të ofertës. Bazuar në gjetjet dhe rezultatet e fazës së testimit, u projektuan 5 prototipe, që do të shpërndahen në të gjithë vendin. Sondazhi mbi vetë-efikasitetin, qëndrimet dhe perceptimet e punonjësve të kujdesit shëndetësor për imunizimin rutinë u përfundua në shtator të vitit 2021. Në partneritet me SHBA-të, Qendrën Xhon Hopkins për Programe Komunikimi, modulet e trajnimit u zgjodhën dhe u përshtatën për **përmirësimin e aftësive të komunikimit ndërpersonal për punonjës të linjës shëndetësore**.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, si rezultat i rritjes së numrit të problemeve shëndetësore mendor, që lindin si një sfidë e re për shkak të pandemisë së zgjatur të COVID-19, me mbështetjen e **UNICEF-it** u trajnuan **200 vizitorë në shtëpi** (50% e fuqisë punëtore) dhe **350 mjekë familjarë** (30% e fuqisë punëtore) për këshillim bazë psiko-social dhe mbështetje për shëndetin mendor.

♦ Implementimi i reformës së kujdesit të shëndetit primar

Bërja e infermierëve efektivë dhe anëtarë të njohur të ekipit të kujdesit të KSHP në Maqedoninë e Veriut, u mbështet nga dizajnimi dhe zbatimi i **trajnimin të parë për kompetenca të infermierëve për fuqizimin e infermierëve** të kujdesit primar. Procesi u krijua për t'u siguruar anëtarëve të grupit të punës së infermierisë aftësi dhe praktikë për të vepruar si lehtësues trajnimi dhe për ta zhvilluar mësimdhënien e tyre. Rreth **430 infermierë dhe mami të kujdesit primar** morën pjesë në program dhe morën njohuri dhe aftësi të reja që synonin ofrimin e shërbimeve më cilësore të kujdesit shëndetësor. Po ashtu ka përfunduar studimi i fizibilitetit për krijimin e një diplome të fuqishme, të përshpejtuar (dhe të akreditueshme) të infermierisë, të përshtatur me kërkesat shëndetësore në vend, për t'i adresuar barrierat afatgjata ligjore, të sistemit shëndetësor dhe arsimit për profesionin e infermierisë.

Në partneritet me OKB-në vazhdoi zbatimi i reformës nacionale të kujdesit primar, të përshtatur me nevojat e COVID-19. Mbështetja kishte për qëllim adresimin e barrierave përmes ndërhyrjeve kryesore si avokimi, mbështetja teknike, gjenerimi i dëshmimeve dhe përmirësimi i cilësisë, vazhdimësisë dhe performancës së përgjithshme

të shërbimeve shëndetësore primare për të gjithë qytetarët.

Në vitin 2021, **OBSH-ja** e mbështeti një analizë të **ekspozimit financiar shëndetësor të popullsisë** që synonte të kuptonte nëse njerëzit mund të përballojnë të paguajnë për kujdesin shëndetësor, bazuar në nevojën për adresim të boshllëqeve në të tre dimensionet e mbulimit shëndetësor (të drejtat e popullsisë, pakoja e përfitimeve dhe participimi i përdoruesve) si dhe faktorë të tjerë që kontribuojnë në vështirësi financiare dhe nevoja të paplotësuara për kujdes shëndetësor.

Raporti "Pabarazia shëndetësore dhe COVID-19 në Maqedoninë e Veriut - Investimi në shëndetin dhe mirëqenien për një të ardhme më të drejtë dhe më të barabartë për të gjithë", i porositur nga OBSH-ja ofron rekomandime për prioritetet e Ministrisë së Shëndetësisë për investimet në shëndetësi, sistemet shëndetësore dhe përcaktuesit shëndetësorë si aspekt qendror i rimëkëmbjes socio-ekonomike. Raporti gjithashtu ofron rekomandime se si të integrohen këto në planet nacionale të rimëkëmbjes dhe kuadrin e rimëkëmbjes socio-ekonomike, duke përfshirë veprimet për reduktimin dhe monitorimin e pabarazive gjinore, pabarazive shëndetësore dhe diskriminimin.

Janë prezantuar instrumente të reja për matjen e performancës dhe cilësinë e shërbimeve përmes **Vlerësimit të gjendjes shëndetësore dhe qasjes në shërbimet shëndetësore për popullatën e moshuar**.

Me avokimin e **OBSH-së**, partnerët lokalë e kanë iniciuar përgatitjet për prezantimin e programit shkollor promovues të shëndetit, që do ta synojë rritjen e ndërgjegjësimit dhe praktikat e reja të fëmijët e moshës shkollore për masat preventive shëndetësore.

OBSH në bashkëpunim me Klinikën e Psikiatrisë i kanë ndërmarrë rekomandimet për hapat e mëtejshëm thelbësorë për **përmirësimin e shërbimeve të shëndetit mendor me bazë në komunitet**, të cilat e synojnë risocializimin dhe riintegrimin në shoqëri të personave me çrregullime të rënda mendore, duke u bazuar në vlerësimin dhe hartëzimin e Qendrave të shëndetit mendor me bazë në komunitet. Identifikimi dhe përcaktimi i nevojave për mbështetje psikosociale për punëtorët shëndetësorë dhe disponueshmëria aktuale e burimeve onlajn në Maqedoninë e Veriut me qëllim që të formësohen veprimet e mëtejshme drejt digjitalizimit të programeve të mbështetjes psikosociale.

UNICEF-i gjithashtu e mbështeti zhvillimin e kapaciteteve të **200 infermierëve vizitorë** në shtëpi në lidhje me këshillimin themelor psiko-social dhe të shëndetit mendor, duke e mbështetur gjithashtu procesin e digjitalizimit të integritetit të regjistrimit dhe raportimit për vizitorët në shtëpi (VSH) në "Moj termin" (Takimi im), duke mundësuar grumbullim dhe ndarja të të dhënave në kohë reale, përgjatë shumë përcaktuesve socialë të shëndetit.

Gjithashtu me **mbështetjen e UNICEF-it** u realizua analiza funksionale e sistemit të vizitave në shtëpi (HV) dhe e kujdesit pediatrik për ta formësuar zhvillimin e Planit të përgjithshëm 2030. Analiza mbulon aspekte që kanë të bëjnë me organizimin dhe zhvillimin institucional, zhvillimin e kapitalit njerëzor, më konkretisht sistemin e pozicioneve të punës, përshkrimet dhe kompetencat e punës (të përgjithshme dhe profesionale), si dhe menaxhimin dhe vlerësimin e performancës. Përfundimisht, përmirësimi i funksionimit të shërbimit të VSH-së si pjesë e sektorit të shëndetësisë do të kontribuojë ndjeshëm në mënyrë indirekte në mirëqenien e fëmijëve në vend.

Zhvillimi i kapaciteteve të mjekëve familjar dhe infermierëve vizitorë në shtëpi për sa i përket DHBGJ-së dhe bashkëpunimi ndërsektorial i ka zgjeruar më tej kapacitetet e këtyre profesionistëve të kujdesit primar shëndetësor, të cilat janë kontakti i parë me familjet dhe të gjitha çështjet që i ka iniciuar COVID-19.

Në mbështetje të përpjekjeve të vendit për **ngritjen e kujdesit shëndetësor primar të veçuar për traumat**, u zgjodhën 10 praktika të mjekut familjar, që do të zbatohen kërkime të synuara për **përvojat e pafavorshme të fëmijërisë (PPF)**.

Pas trajnimit nga një ekspert ndërkombëtar, kjo përvojë do t'i zhvillojë më tej njohuritë, besimin dhe aftësitë e tyre për të pyetur rreth PPF-ve, besimin dhe aftësinë për t'iu përgjigjur zbulimeve dhe të kuptuarit se çfarë kërkohet në një kontekst shërbimi. Po ashtu vazhduan aktivitetet avokuese për të siguruar mbështetjen e MSH-së, MASH-it, MPPS-së dhe Institutit të Shëndetit Publik, të përzgjedhur si ent nacional, që do ta sigurojë qëndrueshmërinë e përpjekjeve. Më shumë se 1600 artikuj dhe video me përmbajtje të detyrueshme në dy gjuhë lokale janë tani të disponueshme për t'i mbështetur përpjekjet e prindërve në gjurmimin e momenteve historike të fëmijës/fëmijëve të tyre, çështjet e zhvillimit, vaksinimin, ushqimin e përshtatshëm për moshën, shëndetin, mësimin dhe lojën.

UNFPA i mbështeti homologët nacionalë në sigurimin e rritjes së qasjes në mjetet e planifikimit familjar për grupet e cenushme. Gjetjet e anketës së planifikimit familjar të kryer në nivel rajonal japin rekomandime për veprime në të ardhmen, ndërsa këshillimi për planifikim familjar është ofruar edhe nëpërmjet klinikës mobile gjinekologjike, e cila funksionon në zonat rurale/pa qasje të mjaftueshme në shërbime.

Në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë, Klinikën Universitare për Gjinekologji dhe Obstetrikë, Shoqatën e Mjekëve të Maqedonisë, Shoqatën e Gjinekologëve dhe Obstetërve të Maqedonisë, Kryqin e Kuq dhe Drejtorinë e Shëndetësisë elektronike, **UNFPA** e ka mbështetur **ofrimin e vazhdueshëm dhe të pandërprerë të shërbimeve esenciale për parandalimin dhe mbrojtjen e shëndetit seksual dhe riprodhues të grave dhe vajzave (SHSR)** përmes projektimit dhe prezantimit të **klinikave mobile gjinekologjike**. Për të siguruar qëndrueshmërinë e ofrimit të shërbimit, u hartua protokoll për funksionimin e klinikave mobile, u përgatit dhe u shpërnda material informues për pacientët në 3 gjuhë, si dhe u përgatit dhe nda strategjia e komunikimit për inkurajim të përdorimit të shërbimeve të zhvilluara. Mjetet e nevojshme për SHSR, pajisjet të nevojshme për mbrojtje personale për ofrimin e sigurt dhe cilësor të shërbimeve janë furnizuar për ekipet që punojnë në terren. **21 ekipe të SHSR-së** të profesionistëve shëndetësorë (objekt/gjine + mami/infermiere) janë trajnuar për të vepruar në këtë lloj mjedisi. Puna filloi në dhjetor të vitit 2021, në qytetin e vogël të Sveti Nikollës (18,000 banorë me vetëm 1 gjinekolog në qytet), duke u shërbyer **188 grave dhe vajzave** në vetëm një muaj. Shërbimet e ofruara në terren përfshijnë depistimin e kancerit të qafës së mitrës, ekzaminimin me ultratinguj, këshillimin për planifikimin familjar dhe shëndetin e nënës, këshillimin për infeksioni seksualisht të transmetueshme dhe shërbime tjera të nevojshme. Përveç kësaj, ekipet e SHSR-së janë të sensibilizuara për ta ofruar referimin bazë të DHBGJ. Të gjitha të dhënat për shërbimet e ofruara në klinikat celulare futen në sistemin nacional të e-Shëndetësisë, andaj nuk ka raportim të dyfishtë dhe as raportim në formë të shtypur.

Për ta mbështetur zbatimin e Master Planit Nacional të Kujdesit Perinatal, **OBSH** i vazhdoi aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve për ofrimin e përmirësuar të kujdesit shëndetësor të nënës dhe të porsalindurve, në dy pilot lokacione (Manastir dhe Tetovë), të pasuar nga tre lokacione shtesë Strumicë, Shtip dhe Kumanovë. Në fakt, **UNFPA** e mbështeti ngritjen e kapaciteteve në 5 spitale tjera në Gostivar, Prilep, Kërçovë, Ohër, Strugë - duke arritur në total mbi **70% të gjithsej profesionistëve të shëndetit seksual dhe riprodhues (SHSR)** në spitale jashtë kryeqytetit.

Paralelisht, me mbështetjen e **UNICEF-it**, **32 neonatologë të nivelit I dhe II (100% e fuqisë punëtore)** u trajnuar për procedurat dhe praktikat bashkëkohore të kujdesit neonatal.

UNHCR-ja ka ofruar mbështetje për Spitalin e Përgjithshëm në Gjevgjeli dhe Qendrën lokale për Punë Sociale, për ta vazhduar ofrimin e shërbimeve për refugjatët, azilkerkuesit dhe migrantët, përfshirë edhe periudhën gjatë pandemisë COVID-19. UNHCR dhe partnerët tjerë punuan në tejkalimin e sfidave, me të cilat përballje Klinikat e Traumatologjisë në Shkup, kur është fjala për mjekimin e pacientëve të huaj. Përveç zhvillimit të një linje komunikimi për shtetasit e pranuar në klinikë për shkak të aksidenteve gjatë lëvizjes,

UNHCR-ja e mbështeti klinikën traumatologjike me pajisje mjekësore. Sfida që ka ngel të zgjidhet është fakti që azilkerkuesit janë vaksinuar shumë vonë kundër Covid-19, ndërsa personat pa shtetësi nuk kanë qasje në vaksinimin kundër Covid-it.

PRODHIMI 2.2. ARSIMI CILËSOR DHE I PËRBALLUESHËM

Përderisa në vitin e kaluar shkollor 2020/2021 shumica e nxënësve e ndoqën mësimin nga distanca, përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë, mjeteve të fuqishme monitoruese dhe kërkimit gjithëpërfshirës, **UNICEF-i** ndihmoi në rritjen e përqindjes së shkollave ku nxënësit e ndiqnin mësimin me prezencë fizike, andaj së bashku me Ministrinë e Arsimit dhe Shkenca çoi në rihapjen aktuale të të gjitha shkollave qysh në shtator. Për të mbështetur më tej ndjekjen e sigurt të mësimin në shkollë, **15 shkollave që kishin nevojë për mbështetje për ujë, pajisje sanitare dhe higjienë (WASH) (me afro 5000 nxënës) u pajisën me 52 stacione të lëvizshme për larjen e duarve.**

UNICEF ofroi **mbështetje teknike dhe eksperte për shumë dialogë në nivel politikash** në fushat e mëposhtme: mësimi në distancë dhe rihapja e shkollave, koncepti për arsimin fillor, ligji për tekstet shkollore, digitalizimi i teksteve shkollore, arsimit gjithëpërfshirës, shfrytëzimi optimal i shkollave, zhvillimi i një formule të re financimi për arsimin fillor dhe sigurimin e kontributit në formulën e arsimit të mesëm. Për të mbështetur zbatimin praktik të programeve mësimore të reja, **UNICEF-i** mbështeti **trajnimin e mbi 3,000 mësuesve në praktikat bashkëkohore pedagogjike** dhe disponueshmërinë e burimeve të mësimdhënies dhe mësimin me cilësi të lartë.

Duke iu përgjigjur momentumit të reformës, **UNICEF-i** mbështeti zhvillimin dhe shtypjen e **teksteve shkollore për klasën e parë, zhvillimin e teksteve digjitale ndërvepruese për klasën 4 dhe platformën për përdorimin e tyre me dhe pa internet (E-Biblioteka)**, pastaj vazhdoi të ndërtonte aleanca dhe partneritete për ta përmirësuar portalin Eduino. Përmirësimet do të lejojnë grumbullimin e burimeve shtesë të mësimdhënies dhe ngarkimin e teksteve të reja digjitale ndërvepruese në Eduino. Për më tepër, Eduino u zgjerua me një nënfaqe të dedikuar për zhvillimin në fëmijëri të hershme dhe një platformë shoqërore për arsimin e mesëm profesional. Për të zgjeruar shtrirjen e programit përtej hapësirave të lojërave të kopshteve, **UNICEF** është duke e mbështetur zhvillimin e përmbajtjes së animuar dhe televizive që transmetohet në mbarë vendin dhe shpërndahet në internet, e cila synon të depërtojë te fëmijët, që nuk e ndjekin edukimin parashkollor dhe për të ndihmuar në krijimin e kërkesës publike për mundësitë e të mësuarit social dhe emocional.

Për ta mbështetur **përfshirjen e plotë të të gjithë fëmijëve në arsimin standard**, **UNICEF-i** e mbështeti **transformimin e shkollave speciale në qendra burimore**, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve të stafit, **që i trajnoi 500 asistentë mësimdhënës**. Përveç kësaj, **UNICEF-i** po lokalizon një sërë modulesh mbi teknologjinë ndihmëse dhe komunikimin alternativ, me qëllim që t'i mbështetë profesionistët me identifikimin dhe ndërhyrjen e hershme për fëmijët me vonesa në zhvillim.

Ndërtimi i kompetencave të mësuesve parashkollorë për të ofruar arsim cilësor dhe të informuar nga trauma dhe **për t'i nxitur aftësitë sociale dhe emocionale te fëmijët në moshë të hershme - në edukim parashkollor**, përfundimi i shtrirjes së mësimin social dhe emocional (MSE), ku të **gjithë edukatorët e enteve parashkollore** ndoqën stërvitje dhe mentorim katër mujor në zotërimin e programit MSE. Grupi kryesor prej **190 liderësh për mbështetjen e kolegëve** vazhdon ta mbështesë zhvillimin profesional në fusha të tjera të zhvillimit të fëmijërisë së hershme të mbështetur nga Banka Botërore.

UNICEF-i mbështeti Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për rishikimin e **transferimeve të mjeteve nga Qeveria te komunat, të cilat i financojnë shkollat fillore dhe të mesme**. Formula të reja financimi bazuar në numrin e nxënësve dhe kostot për arritjen e standardeve arsimore u zhvilluan dhe u përfshinë në buxhetin nacional të vitit 2022,

duke e rritur efikasitetin, duke e përmirësuar transparencën dhe drejtësinë e financimit, gjegjësisht duke i vendosur mekanizmat, që do të rrisin cilësinë e mësimdhënies. Ndarjet adekuate janë bërë edhe për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe për mësimdhënien në gjuhët e bashkësive më të vogla etnike. Formulatat e reja ofrojnë financim të mjaftueshëm për shkollat për mirëmbajtje adekuate, investime të përshatshme në pajisje dhe mjete mësimore, trajnim profesional dhe zhvillim në karrierë të stafit të shkollës, si dhe rritje të numrit të bashkëpunëtorëve profesional.

Për herë të parë fondet për arsimin fillor 2022 të transferuara në komuna, të përgatitura në bazë të formulave të financimit, përfshijnë **ushqime falas për nxënësit nga klasa e parë deri në të pestën, duke i zgjeruar kështu më tej programet universale të mbrojtjes sociale të fëmijëve, si dhe tableta falas për qasje në burime arsimore digjital për nxënësit e familjeve në rrezik social.**

UNICEF-i gjithashtu e ka mbështetur **hartimin e planeve komunale për shfrytëzimin optimal** të shkollave, të cilat synojnë t'i identifikojnë mënyrat e mundshme për ta përmirësuar shpërndarjen e burimeve të kufizuara për të siguruar që të gjitha shkollat fillore ta mundësojnë mësimdhënien në përputhje me standardet nacionale, ligjet dhe konceptet arsimore. Është zhvilluar edhe indeksi i shfrytëzimit optimal të shkollave, i cili i mat mangësitë për çdo shkollë fillore dhe komunë lidhur me përmbushjen e standardeve arsimore dhe infrastrukturore, si dhe boshllëqet në kostot aktuale për nxënësit dhe kostot e standardizuara, duke e shpalosur nivelin e efikasitetit financiar. Për çdo komunë ku nevojitet veprim, përgatitet një plan i detajuar për përshtatjen e kapaciteteve infrastrukturore dhe arsimore, ndërsa efikasiteti financiar do të përmirësohet me përdorimin e formulës së re të financimit të shkollave. Zbatimi i këtyre planeve do ta: **vendosë një sistem të barabartë për arsimin fillor; krijimin e kushteve të barabarta për mësimdhënie në të gjitha shkollat; zbatimin e konceptit të ri të arimit fillor; sigurimin e shpërndarjes efikase të burimeve.**

Në konsultim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Byronë për Zhvillimin e Arsimit (BZHA), **UNFPA** e nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit që i përshkruan fushat kyçe për bashkëpunim dhe mbështetje në **përfshirjen e edukimit seksual gjithëpërfshirës**, nga pilotimi në vitin 2021, deri në hapjen e plotë gjer në fund të vitit 2025, duke përfshirë rishikimin e kurrikulave në lidhje me rolet dhe stereotipet gjinore, ndjeshmërinë për PAK, DHBGJ dhe tema tjera.

Në kuadër të Programit për ndryshime klimatike dhe edukim mjedisor, **UNICEF-i** e zbatoi ciklin UPSHIFT kushtuar temës. **10 ekipe prej 46 të rinjsh** nga shkollat e mesme në vend e **përfunduan punëtorinë tre-ditore të projektimit të idesë**, ndërsa **pesë ekipeve** iu dhanë **fonde fillestare** për t'i çuar përpara ndryshimet klimatike dhe **risitë sociale** për mbrojtjen e mjedisit. Ky program do t'i angazhojë edhe më tej të rinjtë në bashkëpunim me Qendrën Kulturorë Rinore të Qytetit të Shkupit. Brenda edicioneve të sivjetme të festivalit të filmit CineDays dhe festivalit muzikor "Zdravo Mladi" (Tungjatjeta të rinj), artistët e rinj do të marrin pjesë në një sërë punëtorish dhe sfidash, duke ua ofruar atyre mundësinë për t'i përdorë energjitë e tyre kreative për ta përkrahur zhvillimin e qëndrueshëm dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike.

UNHCR-ja në bashkëpunim me Shoqatën e Juristëve të Rinj Maqedonas dhe MPPS-në kanë punuar së bashku me subjektet tjera relevante (shkolla, OJQ dhe organizata ndërkombëtare) për t'i identifikuar sfidat, mundësitë dhe praktikatat e mira ekzistuese në sigurimin e **arsimit cilësor për fëmijët azilkërkues dhe refugjatë**. Përveç kësaj, UNHCR-ja dhe partnerët ofruan orë mësimore në gjuhën maqedonase, mentorim të mbështetjes arsimore dhe klasa plotësuese për 30 azilkërkues dhe 6 refugjatë, duke i mbështetur kështu autoritetet e pritjes dhe integritet në ofrimin e një mjedisi gjithëpërfshirës dhe pranues për refugjatët.

Është krijuar bashkëpunim i ri ndërmjet OKB-së, MPPS-së dhe **Fakultetit Filologjik "Blazhe Koneski" në zhvillimin e një Platforme gjuhësore në internet për mësimin e gjuhës maqedonase** për azilkërkuesit dhe refugjatët, që dëshirojnë përfshirjen lokale, duke e vënë atë në dispozicion

për këdo tjetër që është i interesuar t'i mësojë bazat e gjuhës maqedonase. Kapacitete për mësimdhënie përmes internetit iu ofruan 13 mësuesve dhe edukatorëve nga shkolla fillore "Kliment Ohridski", Shkup, e cila është nikoqire e fëmijëve refugjatë, shkollës ndërkombëtare "Nova" dhe Forumit Arsimor Rinor, duke e siguruar vetëdijen dhe mirëkuptimin bazë të punës me nxënësit me prejardhje refugjate dhe migrante si dhe njohjen e tyre me burimet, që mund të përdoren në klasë për ta kultivuar harmoninë dhe përkatësinë si pjesë e përpjekjeve më të mëdha për t'i mirëpritur dhe integruar plotësisht të ardhurit në komunitet.

PRODIMI 2.3. MBROJTJA SOCIALE DHE E FËMIJËVE

UNHCR-ja ka e mbështetur MPPS-në dhe institucionet përkatëse të mbrojtjes sociale përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe zgjidhjeve legjislative lidhur me refugjatët që kanë rezultuar në krijimin e një **strukture nacionale koordinuese për integrimin e refugjatëve**. Ai forcoi më tej kapacitetin e qeverisë për aranzhimet e kujdesit alternativ dhe përfshirjen lokale dhe mjetet e jetesës së refugjatëve në bashkëpunimin jug-jug me autoritetet nga Holanda dhe Sllovenia. Përveç kësaj, u mbështet ngritja e kapaciteteve për integrimin dhe mjetet e jetesës për autoritetet dhe OSHC-të që punojnë në përfshirjen e refugjatëve, si dhe për nëntë komuna për të drejtat e refugjatëve dhe politikat dhe standardet e integritetit lokal. Si rezultati i kësaj, komunat nga të cilat dy tashmë strehojnë refugjatë, janë të pajisura më mirë me njohuri mbi kornizën ligjor nacionale si dhe për rolet e autoriteteve lokale në përfshirjen e refugjatëve dhe azilkërkuesve.

Mbështetja ligjore për personat pa shtetësi në rast të refuzimit të qasjes në shërbimet sociale është ofruar nga UNHCR përmes partnerit të saj. Autoritetet u mbështetën në zbatimin e Ligjit për personat pa dokumente, gjegjësisht aktivitetet e ndërgjegjësimi të popullatës së prekur.

UNICEF-i e rifilloi zhvillimin e kapaciteteve për **menaxhimin e rasteve të punës sociale**, që u ndërpre në shkak të pandemisë, përmes mentorimit të 40 punonjësve të rasteve dhe 30 punonjësve të triazhit, zhvillimit të metodologjisë për përcaktimin e nocionit "lëndë" me indikator për rastet aktive, joaktive dhe komplekse, si dhe për ndihmën e 30 qendrave për punë sociale (QPS) lidhur me ndarjen e rasteve. Për më tepër, analiza e përdoruesve të shërbimeve sociale siguroi të dhëna të vlefshme dhe të diferencuara gjini/moshë, të cilat do të përdoren për të hartuar rekomandime politikash për përmirësimin e punës gjinore dhe të ndjeshme ndaj fëmijëve, planifikimin më të mirë të çështjeve dhe përmirësimin e sistemit statistikor të qendrave.

Duke pranuar se çdo fëmijë në rritje ka nevojë për kujdes edukativ, shëndet të mirë, ushqim optimal dhe një mjedis stimules dhe të sigurt, që ofron shumë mbështetje për mësimin e hershëm, UNICEF-i i nisi disa nisima për ta **mbështetur prindërimin** dhe për ta **siguruar fillimin më të mirë për fëmijët**. Për t'i mbyllur boshllëqet e njohurive për nevojat e shërbimit për ndërhyrjet në fëmijëri të hershme (NFH), UNICEF e porositi **Analizën e Situatës së NFH-së** për të gjeneruar prova mbi fuqitë dhe kapacitetet ekzistuese nacionale, nevojat e spikatura dhe mundësitë për të krijuar dhe mbështetur programe bashkëkohore dhe të qëndrueshme për NFH për fëmijët e moshës 0-6 vjeçare, me theks të fëmijët e moshës 0-3 vjeç në rrezik ose me vështirësi në zhvillim, duke përfshirë aftësitë e kufizuara.

Duke e kuptuar rëndësinë e ndërtimit të qëndrueshmërisë së familjes dhe ofrimin të shërbimeve parandaluese dhe ndërhyrjeve të hershme, dhe duke e parë potencialin në shërbimet e këshillimit parashkollor, UNICEF në bashkëpunim me MPPS-në bashkëpunoi me Mellow Parenting (Prindërimi i butë) për të ofruar një **program të vlerësuar prindërimi**. 30 praktikues nga entet parashkollorë dhe linja ndihmëse e prindërve u trajnuan për zbatimin e programit të bazuar në teoritë psikologjike të lidhjes, të mësuarit social dhe terapisë kognitive të sjelljes. Praktikuesit e kanë ofruar programin 8-javor të prindërimin në internet për 27 prindër të fëmijëve mes moshës parashkollorë dhe atyre para lindjes. Prindërit, që kanë nevojë për mbështetje gjatë periudhës stresuese dhe sfiduese të shkaktuar nga pandemia, përfituan nga qasje dhe lehtë në këshilla përkatëse

dhe të besueshme përmes **Linjës Nacionale të Ndhmës për Prindërit**. Operatorët ofruan mbështetje për **245 prindër dhe 22 fëmijë, përfshirë 28 prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara**, me qëllim të parandalimit dhe adresimit të ndikimeve të mundshme negative dytësore të COVID-19, shqetësimit psikosocial, neglizhencës dhe mungesës së kujdesit prindëror, dhe ekspozimit të shtuar ndaj dhunës. Përmes mediave sociale mesazhi me këshilla mbi teknikat pozitive të prindërimit u përcoll te 370,000 njerëz.

UNICEF-i gjithashtu vazhdoi ta mbështesë përfshirjen e vlerësimit funksional të bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (KNF) si një pikë e vetme hyrëse për fëmijët dhe të rinjtë për qasje në shërbime të ndryshme mbështetëse në fushën e shëndetësisë, arsimit dhe mbrojtjes sociale. Si rezultat i avokimit progresiv, dy organet për vlerësime funksionale të bazuara në KNF, që e mbulojnë rajonin e Shkupit dhe Trupi Nacional i Ekspertëve për vlerësim funksional, të krijuar me mbështetjen e UNICEF-it, u morën nga sistemi publik shëndetësor.

Qendra e Shëndetit Publik (QSHP) Shkup e hapi **Shërbimin e ri për vlerësimin funksional të fëmijëve dhe të rinjve deri në moshën 26 vjeçare**, ndërsa nga janari i vitit 2021 filloi me vlerësime të rregullta të fëmijëve dhe të rinjve nga rajoni i Shkupit. Në periudhën maj-tetor 2021, trajnimi dhe mentorimi për vlerësimet funksionale të bazuara në KNF u zhvillua në rajonet e Pellagonisë, Pollogut dhe Jugperëndimit, duke përfshirë pothuajse pesëdhjetë profesionistë. ESHP Shkup ka angazhuar dymbëdhjetë personat, të cilëve u është zhvilluar kapaciteti për të mbuluar tre organe të reja rajonale të vlerësimit funksional në Strumicë, Manastir dhe Gostivar.

Gjithashtu (përmes 15 punëtorive) UNICEF-i e mbështeti prezantimin e modelit të ri për vlerësimin funksional për ofruesit e shërbimeve – duke përfshirë Qendrat për Punë Sociale (QPS), shkollat dhe kopshtet – si dhe prindërit në tre rajonet e synuara.

Në koordinim me ministritë dhe institucionet tjera përkatëse, **hartimi i ndryshimeve** në Ligjin për mbrojtjen sociale, Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve, Ligjin e sigurimeve shëndetësore, Ligjin për kujdesin shëndetësor dhe Ligjin për arsimin fillor, u bë konsolidimi i ofrimit të vlerësimeve funksionale për fëmijët dhe të rinjtë në përputhje me KNF-në. Në dhjetor të vitit 2021 u miratuan ndryshimet nga Qeveria dhe u vunë në rendin e ditës së Kuvendit.

Kjo është ndërmarrë së bashku me rishikimin e **draft-Rregullores për vlerësimin e aftësisë së kufizuar të bazuar në KNF**, në mënyrë që të përafrohet me tri ministritë e linjës – të Shëndetësisë, Arsimit dhe Shkencës, dhe Punës dhe Politikës Sociale – si dhe me institucionet tjera relevante.

Përkundër themelimit të organeve funksionale të vlerësimit, që mbulojnë katër nga tetë rajonet e Maqedonisë së Veriut, fëmijët dhe të rinjtë jashtë rajoneve të mbuluara nuk mund ta përfundonin vlerësimin e tillë dhe si rrjedhojë nuk kishin të drejtë të kenë qasje në asistentë arsimorë dhe personalë. Kjo rezultoi me vështirësi në realizimin e të drejtës së tyre për arsimim, si dhe probleme në kryerjen e aktiviteteve të tyre të përditshme. Për të adresuar këtë, **UNICEF-i** e mbështeti krijimin e një **ekipi të posaçëm** për kryerjen e vlerësimit e aftësisë së kufizuar të bazuar në KNF për **fëmijët nga komunitetet e cenueshme në vende, të cilët nuk mbulohej nga organet rajonale të vlerësimit**.

Për t'i adresuar **rreziqet e shfaqura të shëndetit mendor të fëmijëve** gjatë COVID-19, Klinika Universitare e Psikiatrisë ofroi mbështetje për **750 fëmijë, të rinj, prindër dhe kujdestarë** përmes linjës së ndihmës, ndërsa 45 kujdestarë dhe 30 fëmijë në kujdestari morën mbështetje të synuar dhe individuale. Videot me këshilla dhe informacione në lidhje me mbështetjen psikosociale arritën qasje te 77,967 persona përmes rrjeteve sociale. **60% e të gjithë fëmijëve në shtëpitë e grupeve të vogla** kanë përfituar nga **aktivitetet kreative dhe edukative**, që synojnë përmirësimin e shëndetit të tyre mendor, ndërsa **59 profesionistë** që punojnë me fëmijët dhe adoleshentët kanë përfituar nga një program trajnimi i përshtatur mbi metoda efektive, të ndjeshme kulturore dhe të adaptueshme për të minimizuar rrezikun e

dhunës ndaj adoleshentët.

Përveç kësaj, në përgjigje të **dhunës mbi bazë gjinore** që shënon rritje globale, **deri në 100 punonjës të linjës së parë të shërbimit social morën njohuri mbi shërbimet mbështetëse parandaluese të shëndetit mendor**, ndikimet specifike gjinore të pandemisë dhe dhunës mbi bazë gjinore. **200 fëmijë me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre përfituan nga një mbështetje e individualizuar përmes internetit**, nëpërmjet një platforme të zhvilluar posaçërisht të ofruesve të shërbimeve përmes internetit. Ndërhyrjet përfshinin mbështetje falas për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe prindërit/kujdestarët e tyre, si për qëllime arsimore, psikosociale dhe rehabilituese, në mbarë vendin. Ofrimi i shërbimit përmes internetit u prezantua **104 zyrtarëve nacionale dhe lokalë**, me qëllim të zbutjes së hendekut ekzistues të mungesës së ofrimit të shërbimeve në vend, veçanërisht në komunitetet më të vogla, dhe identifikimin e rrugëve për të siguruar qëndrueshmërinë e shërbimit. Për më tepër, **80 qendra ditore, kopshte dhe qendra për profesionistët e punës sociale**, fituan njohuri se si ta përdorin platformën dhe ta përfshijnë atë si një element informues në punën e tyre të përditshme me fëmijët me aftësi të kufizuara.

Me qëllim të adresimit të nevojave të **familjeve që përjetojnë vështirësi gjatë pandemisë**, hartimi dhe ofrimi i shërbimeve të mbrojtjes sociale u siguroa për **260 familje, 928 persona, 487 fëmijë në rrezik social nga dhjetë komuna, nga shtatë ekipe mobile** të përbëra nga avokatë dhe punonjës socialë, në bashkëpunim të afërt me qendrat për punë sociale, duke rezultuar gjithashtu që **87 familje të aplikojnë për herë të parë për ndihmë sociale**. Shtatë OSHC lokale janë trajnuar në ofrimin e mbështetjes për familjet në rrezik.

UNICEF-i e menaxhoi zbatimin e fazës fillestare të programit të përbashkët të **OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (PAK)**, e cila rezultoi në marrjen e një njohurie dhe provash thelbësore për realizimin e të drejtave themelore të njeriut të personave me aftësi të kufizuara, duke përdorur Konventën për të drejtën PAK-ve nën thjerrëzën e tyre. Duke marrë parasysh zhvillimet dhe arritjet e mëparshme, **analiza e gjendjes** ndihmoi në identifikimin e pengesave dhe sfidave kryesore, si dhe dha rekomandime, duke hapur rrugën investimeve dhe programimit të ardhshëm. Programi gjithashtu mbështeti palë të ndryshme të interesuara dhe bartës të të drejtave për ta kuptuar më mirë **Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK)** dhe Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ), që e përfshijnë aftësinë e kufizuar.

Përpjekjet avokuese dhe mbështetja teknike e ofruar përmes programit garantuan që në fund të vitit 2021, Maqedonia e Veriut **vazhdon të mbajë zero fëmijë në institucione rezidenciale në shkallë të gjerë**, pavarësisht sfidave të tendencave të prapambetura, përfshirë varfërinë në rritje. Mbështetja afatgjatë e **UNICEF-it** e ofruar për Qeverinë dha rezultate në **përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar për fëmijët në kujdestari dhe përkujdesje fafaisnore**.

Në veçanti, MPPS ridrejtoi burime të konsiderueshme njerëzore dhe financiare nga kujdesi institucional në komunitet dhe në familje, duke përfshirë **themelimin e qendrave mbështetëse të kujdestarisë**, që për herë të parë përfshihen në sistem. Dy qendra të reja mbështetëse për familjet kujdestare filluan të funksionojnë në **Shkup dhe Manastir**, duke mbuluar të gjitha familjet kujdestare dhe fafaisnore në mbarë vendin si element kyç në sistem, duke u prezantuar për herë të parë bazuar në Ligjin për Mbrojtjen Sociale të vitit 2019. **Të dymbëdhjetë punonjësit e sapoangazhuar** të këtyre qendrave fituan njohuri të nevojshme për të kryer rolin e tyre në promovimin e shërbimit të kujdestarisë familjare, vlerësimin dhe edukimin e familjeve kujdestare potenciale dhe të ardhshme, si dhe observimin dhe mbështetjen e familjeve strehuese dhe fafaisnisë ekzistuese.

Studimi shumëdimensional i varfërisë së fëmijëve, i porositur nga UNICEF-i, e parashtroi një indeks që përfshin **12 dimensionet të varfërisë së fëmijëve dhe 27 indikatorë**. Duke përdorur të dhënat nga Anketa e grupeve me indikator të shumëfishtë, ai tregoi se **janë të prekur 12% e fëmijëve**

të moshës 5 deri në 17 vjeç dhe 9% e fëmijëve nën 5 vjeç. Privimet në arsim, zhvillimi i hershëm i fëmijëve, ushqimi, siguria, dashuria dhe kujdesi janë ndër pesë kontribuuesit kryesorë në varfërinë e fëmijëve, duke sinjalizuar fushat, në të cilat janë më të nevojshme përmirësimi i shpërndarjes së financave publike dhe ofrimit të shërbimeve. Studimi ofron prova për fokusin e nevojshëm në grupet më të cenueshme, duke përfshirë aspektin e përkatësisë etnike dhe atë të vendndodhjes. Fëmijët romë janë dukshëm më të cenueshëm – të paktën një në tre fëmijë romë përjetojnë varfëri shumëdimensionale, krahasuar me një në nëntë fëmijë në popullatën e përgjithshme.

Rajoni lindor dhe ai juglindor kanë një prevalencë të dukshme të varfërisë shumëdimensionale, ndërsa rajonet e Pollogut dhe të Shkupit gjithashtu tregojnë cenueshmëri të lartë. Studimi shumëdimensional i varfërisë së fëmijëve shënon një bazë solide për angazhimet e ardhshme që i trajtojnë shtresat e shumta të varfërisë së fëmijëve. Meqenëse e prezanton një Indeks të ri Shumëdimensional të Varfërisë së Fëmijëve për vendin, njashtu e ofron një mundësi për t'i pasuruar statistikat zyrtare me të dhëna shtesë për varfërinë e fëmijëve, e cila aktualisht është e kufizuar në varfërinë monetare/të ardhurat dhe i mungon një ndarje e rëndësishme, duke përfshirë strukturën gjeografike dhe kategorizimin sipas moshës së fëmijëve.

Fillimi i Studimit Shumëdimensional të Varfërisë së Fëmijëve u krye në bashkëpunim me Presidentin e Maqedonisë së Veriut – pasi lidhet me kompetencat e ministrive të ndryshme përkatëse – dhe Iniciativën e Oksfordit mbi Varfërinë dhe Zhvillimin Njerëzor. Si rezultat i këtij partneriteti, Maqedonia e Veriut ftohet t'i bashkohet Rrjetit Global Shumëdimensional të Varfërisë mes Homologëve. Rrjeti u krijua për të ofruar informacione mbi zbatimin e masave shumëdimensionale, shkëmbimin e përvojave dhe mbështetjen teknike dhe institucionale. Pjesëmarrës të rrjetit janë ministra dhe zyrtarë të lartë nga 60 qeveri nacionale dhe 19 institucione rajonale dhe ndërkombëtare, duke përfshirë Bankën Botërore, OECD, SIDA, UNDP dhe WFP (Programi Botëror i Ushqimit).

UNDP e mbështeti ofrimin e **shërbimeve sociale përmes ndërhyrjeve të ekonomisë së kujdesit**, duke iu mundësuar grave që aktualisht janë të angazhuara me ofrimin e kujdesit brenda familjeve të tyre, që të fitojnë njohjen formale të punës së tyre. Fokusi i UNDP-së është komplementar me punët tjera në fushën e punësimit dhe shërbimeve sociale - puna me PAK-të dhe palët tjera për t'i kuptuar më mirë mundësitë e sjelljes dhe barrierat që i fuqizojnë personat me aftësi të kufizuara për t'u bërë punëkërkuar të suksesshëm, sipërmarrës, të punësuar me kohë të pjesshme e kështu me radhë, dhe me fokus të veçantë në dimensionet gjinore. Më shumë detaje mbi këto aktivitete mund të gjenden në Rezultatit 1.

PRODHIMI 2.4. ELIMINIMI I TË GJITHA FORMAVE TË DHUNËS

Ofruesit e shërbimeve mbështetëse të përgjithshme dhe të specializuara për viktimat e të gjitha formave të dhunës tani e posedojnë kapacitetin për zbatimin e standardeve të parashikuara në CEDAW dhe në Konventën e Stambollit. **UN Women** dhe OSHC-ja partnere, Shoqata për Edukimit dhe Kërkim Shëndetësor, kanë ofruar katër trajnime mbi ngritjen e kapaciteteve për ofruesit e shërbimeve të përgjithshme dhe të specializuara nga komunat e Strumicës, Shtipit dhe Velesit. Me këtë synohej të rriten kapacitetet e tyre në ofrimin e këshillimit dhe mbështetjes psiko-sociale në përputhje me CEDAW dhe Konventën e Stambollit. Në Strumicë, Shtip dhe Veles u krijuan tri grupe lokale multi-sektoriale për të mbijetuarit e dhunës për të siguruar bashkëpunim të rregullt dhe cilësi të shërbimeve të ofruara për personat, të mbijetuar të dhunës. Për më tepër, u ndërtuan kapacitete për mentorët socialë për proceset e integritimit në punë të grupeve të cenueshme, duke përfshirë punën me gratë e mbijetuara të dhunës në familje nga Shoqata e OShC-ve për Kërkim, Zhvillim dhe Komunikim – PUBLIC.

Me mbështetjen e UN Women dhjetë module dhe pesë trajnime janë dorëzuar në **gjashtë shkolla të mesme** nëpër komuna të ndryshme në Maqedoninë e Veriut për t'i **fuqizuar nxënësit dhe mësuesit mbi stereotipet e dëmshme**

gjinore, dhunën ndaj grave (DHG) dhe dhunën në familje (DHF), nga OSHC, Shoqata e Juristëve të Rinj Maqedonas. 68 gazetarë dhe profesionistë të tjerë të medias që punojnë në të gjithë vendin u trajnuan për raportimin me ndjeshmëri gjinore të DHG nga OSHC-ja, Projekti Zgjedhje Shëndetësore Shkup. Mbi **300 vizita derë më derë dhe pesë sesione dialogu që synojnë fuqizimin e komunitetit rom** (gratë, burra, djem dhe vajza) mbi DHG, DHF, stereotipet e dëmshme gjinore dhe martesat e hershme u kryen nga partneri i OKB-së për OSHC-të e grave, Qendra Nacionale Rome.

Ppo ashtu u ndërtuan kapacitetet e Organizatave të Shoqërisë Civile për të avokuar për zhvillimin dhe zbatimin e **ligjeve dhe politikave në përputhje me CEDAW dhe Konventën e Stambollit**. Për ndryshimin e Kodit Penal janë dorëzuar 24 projekt amendamente dhe 38 komente dhe 10 amendamente janë hartuar në Ligjin për Mbrojtjen e Shëndetit dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve në përputhje me Konventën e Stambollit, nga OSHC të mbështetura nga UN Women. Nëntë OSHC anëtarë të Platformës për Barazi Gjinore kanë rritur tani kapacitetet për monitorimin e bazuar në fakte të zbatimit të Konventës së Stambollit dhe përgatitjen e raporteve në hije për GREVIO. Janë organizuar dy fushata ndërgjegjësuëse dhe avokuese për ndryshimin e Kodit Penal në përputhje me Konventën e Stambollit dhe dispozitat e Ligjit të ri për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje.

OSHC-të të mbështetura nga **UN Women** kanë dorëzuar 24 projekt amendamente dhe 38 komente për ndryshimin e Kodit Penal, si dhe kanë hartuar 10 amendamente në Ligjin për mbrojtjen e shëndetit dhe Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve në përputhje me Konventën e Stambollit. Nëntë OSHC anëtarë të Platformës për Barazi Gjinore kanë rritur tani kapacitetet për monitorimin e bazuar në fakte të zbatimit të Konventës së Stambollit dhe përgatitjen e raporteve në hije për GREVIO. Janë organizuar dy fushata për ngritjen e vetëdijes dhe avokimin për ndryshimin e Kodit Penal në përputhje me Konventën e Stambollit dhe dispozitat e Ligjit të ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje.

Me mbështetjen e **UN Women dhe NFPA-së**, u hartuan **Ligji i ri për parandalimin dhe mbrojtjen e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje** si dhe gjashtë (6) akte të reja nënligjore nga një grup ekspertësh dhe konsulentësh, përmes një procesi pjesëmarrës me homologë të ndryshëm nga shteti. PO ashtu në këtë drejtim u iniciuan partneritete të reja.

Gjithashtu u **mobilizuan figurat/liderët e komunitetit** për ta rritur barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave përmes qasjeve të pranueshme kulturore. Në këtë drejtim është realizuar një ngjarje madhore dhe një fushatë (ngjarja e nisjes dhe fushata e aktivizimit 16 ditësh). **Fushata e përbashkët e OKB-së për aktivizmin 16-ditor për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave** u zhvillua me sukses me mbi 1.1 milion qasje vetëm në fejsbuk.

REZULTATI 3

Mjedis i shëndetshëm



Deri në vitin 2025, njerëzit në Maqedoninë e Veriut përfitojnë nga veprimet ambicioze të klimës, burimet natyrore të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme dhe biodiversiteti i ruajtur mirë përmes qeverisjes së mirë mjedisore dhe komuniteteve të qëndrueshme ndaj katastrofave.

Kontributi për:



Fillimisht parimet themelore: Zhvillimi Ekonomik dhe Konkurrueshmëria
Kapitulli 15: Energjia;
Kapitulli 27: Mjedisi

Shpenzimet e OKB-së në 2021

\$9,169,225

Partnerët e zhvillimit:

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Bujqësisë, Ministria Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Ministria e Kulturës, Ministria e Financave, Ministria e Arsimit; Ministria e Punës dhe Politikës Sociale; Ministria e Ekonomisë; Kabineti i Zëvendës Presidentit të Qeverisë për Çështje Ekonomike; Qendra për Menaxhimin e Krizave; Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, vetëqeverisjet lokale; shoqatat e fermerëve; odat tregtare; OJQ-të, sektori privat, Fondacioni Ballkanik për Zhvillim të Qëndrueshëm, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Qyteti i Shkupit, Lidhja e vlerave natyrore dhe njerëzve - Zyra, DEKONS EMA, Drejtoria e Shëndetësisë Elektronike, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Fondi për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik, Unioni Ndërkombëtar për Ruajtje e Natyrës - Evropa Lindore dhe Azia Qendrore, Shoqëria Ekologjike Maqedonase, Komuna e Resnjës, Instituti Shtetëror i Shëndetit Publik, Komisioni Nacional i UNESCO-s, Federata Nazionale e Fermerëve, Instituti Shtetëror i Bujqësisë.

PRODHIMI 3.1. ZHVILLIMI ME EMETIME TË ULËTA DHE QËNDRUESHMËRI NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Komunikimi i Katërt Nacional për UNFCCC (UNDP): Raporti i 3-të i përditësuar dyvjeçar u miratua nga Qeveria dhe iu dorëzua UNFCCC-së në qershor të vitit 2021. Deri më tani objektivi më ambicioz i synimit të zbutjes, i dhënë në Raportin e 3-të të përditësuar dyvjeçar me reduktim prej 82% të emetimeve neto në vitin 2030 krahasuar me nivelet e vitit 1990 është paraqitur në Kontributin e Përcaktuar Nacional (KPN) më ambicioz në rajon. Zhvillimi i Komunikatës së 4-të Nationale për Ndryshime Klimatike përparon mirë me vonesa të vogla të disa prej raporteve analitike. Cilësia e inventarit të gazrave serrë (GS) është përmirësuar ndjeshëm në fushat e bujqësisë, blegtorisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokës, duke përdorur mjete novatore si përcaktimi nga distanca e Sistemit Informativ Gjeografik (SIGJ) dhe anketat. Janë përgatitur analizat e ngjarjeve klimatike ekstreme historike për vendin dhe janë analizuar rezultatet nga matjet mezo-meteorologjike në luginën e Shkupit për periudhën 2011-2020. Është krijuar indeksi i cënueshmërisë së jetesës nga ndryshimet klimatike, i cili ndihmon në identifikimin e komunave më të cënueshme ndaj ndryshimeve klimatike në vend.

Partneriteti i krijuar me Qendrën e Menaxhimit të Krizave në fushën e ndryshimeve klimatike rezultoi në përfshirjen e moduleve të reja në platformat e tyre ekzistuese elektronike për vlerësimin e me shumë rreziqe dhe rrethanave të rrezikshme në mbarë vendin. Modulet e reja do të mbështesin mbledhjen dhe analizën e të dhënave të rëndësishme për raportimin drejt UNFCCC, Kornizën Sendai për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë dhe OZHQ-të. Portali primar informativ për ndryshimet klimatike, gjegjësisht ueb faqja

nacionale për ndryshimet klimatike (www.klimatskipromeni.mk) është përditësuar rregullisht. Më shumë se 170 lajme/blogje/përmbledhje politikash/raporte/veprime klimatike u publikuan në faqen e internetit ndërsa 14 buletine janë shpërndarë me rrjetin në rritje të ndjekësve.

Platforma gjithëpërfshirëse dhe transparente e monitorimit, raportimit dhe verifikimit të ndryshimeve klimatike (MRV) (UNDP): Platforma MRV, e cila u krijua me mbështetjen e UNDP-së do ta mbështesë vendin në përbushjen e kërkesave të transparencës së zgjeruar siç përcaktohet në nenin 13 të Marrëveshjes së Parisit. Platforma mundëson koordinim efikas dhe përpilimin e informacioneve të nevojshëm për raportimin e rregullt në UNFCCC mbi ecurinë e veprimeve klimatike në vend. Platforma MRV do të lehtësojë gjithashtu raportimin të UNFCCC dhe BE/Komuniteti i Energjisë në fushat e energjisë dhe ndryshimeve klimatike. Mbledhja digjitale e harmonizuar e këtyre të dhënave thelbësore do ta lehtësojë punën e të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin e transparencës dhe do të sigurojë të dhëna të përmirësuara dhe më të sakta. Platforma MRV është në fazën e testimit. Kërkesat e MRV-së janë inkorporuar në projektligjin për veprimin ndaj klimës dhe është zhvilluar një legjislacion dytësor për platformën MRV, duke siguruar kështu qëndrueshmërinë e ofrimit të të dhënave. Më shumë se 50 trajnime dhe uebinare u kryen duke synuar një gamë të gjerë të palëve të interesuara, duke filluar nga vendimmarrësit e nivelit të lartë dhe nëpunësit civilë përgjegjës për politikën klimatike dhe raportimin e MRV-së, e deri te pikat kryesore gjinore, të rinjtë dhe shoqëria civile, duke rezultuar kështu në më shumë se 3000 pjesëmarrës (61% gra), që janë sensibilizuar dhe i kanë shtuar njohuritë për çështjet e ndryshimeve klimatike.

Udhërrëfyeni dhe tejkalmi e rrezikut dhe Strategjia e Financimit për Rritjen e Kontributeve të Përcaktuara Nationale (UNDP): KPN i zgjeruar i Maqedonisë së Veriut, i zhvilluar me mbështetjen e UNDP-së, e vendosi një synim nacional për ta arritur 51% reduktimin e emetimeve të gazrave serrë deri në vitin 2030 krahasuar me emetimet e vitit 1990, duke krijuar kështu platformë për zhvillim të vendit me karbon të ulët. eKPN u shoqërua nga Udhërrëfyeni për implementimin dhe Strategjia për financimin të zgjeruar të KPN-së së Maqedonisë së Veriut. Të dy dokumentet e parashikojnë adresimin e sfidës më të madhe dhe prioritetin më të lartë të paraqitur për zbatimin e eKPN-së, shkëputjen e emetimeve të lidhura me energjinë nga rritja e BPV-së. Gjithashtu, politika dhe heqja e rrezikut financiar për të gjithë sektorët e zgjeruar të eKPN-së dhe udhërrëfyeni për vendosjen e taksës së karbonit në vend e përmirësojnë më tej mjedisin mundësues për zbatimin e masave dhe veprimeve të përcaktuara në KNP-në e zgjeruara. Metodologjia e Etiketimit të Buxhetit të Klimës e filluar nga UNDP do të ndihmojë në integrimin e ndryshimeve klimatike



Pastrimi i pellgut të lumit Bogovinë si pjesë e një sere aktivitetesh për përmirësimin e rezistencës ndaj përmytjeve në rajonin e Pollogut. Foto: UNDP

në sistemin nacional të menaxhimit të financave publike. Ministria e Financave e ka inkuorporuar etiketimin e klimës në projektligjin përkatës.

Qasja në financat e gjelbra për NVM-të dhe grupin e synuar të individëve/familjeve (UNDP, IOM, UNECE, EBRD): Projekt-propozimi "Lehtësia financiare e gjelbër për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe luftimin e ndryshimeve klimatike në Maqedoninë e Veriut" e zhvilluar bashkërisht nga UNDP, IOM, UNECE dhe BERZH iu dorëzua Fondit të OZHQ-ve. Agjencitë e OKB-së në bashkëpunim me BERZH do ta mbështesin vendin për ta zhvilluar dhe funksionalizuar Instrumentin për Financim të Gjelbër (IFGJ), një mjet i ri financiar, që do të përmirësojë ndjeshëm qasjen në financimin e gjelbër të përballeshëm për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe grupet e synuara të individëve/familjeve për investime në zgjidhjet e energjisë së rinovueshme (ER) dhe eficientësisë së energjisë (EE), si dhe nxitjen e inovacionit në sektorin e ER dhe EE. IFGJ e mundësoi miratimin e përsheptuar të zgjidhjeve ER, ndërsa EE do të kontribuojë në reduktimin e emetimeve të gazrave serrë dhe ndotjes së ajrit dhe do të forcojë ekosistemin lokal për inovacionin të ER & EE si dhe të financimit të gjelbër.

Zhvillimi i Projekt Propozimi për Planin Nacional të Përshtatjes (UNDP): Propozimi për zhvillimin e Planit Nacional të Përshtatjes është në fazë të avancuar. Një numër takimesh konsultative për projekt-propozimin u organizuan me ministritë përkatëse, pushtetin vendor, OSHC-të dhe komentet dhe sugjerimet e marra u përfshinë në draftin përfundimtar që u nda me Autoritetin e Përcaktuar Nacional (APN). Propozimi nuk iu dorëzua financimit të klimës së gjelbër pasi APN donte të kryente takime shtesë konsultative. Megjithatë, zgjedhjet lokale dhe kriza politike që pasuan, nuk ofruan mjedis të favorshëm për organizimin e konsultimeve të tilla.

Përsheptimi i inovacioneve në teknologjitë e pastra dhe punët e gjelbra, duke përdorur një qasje të zhvillimit të zgjuar urban klimatik (UNDP): Finalizimi i Fondit për Investim Publik (FIP) për projektin "Përsheptimi i inovacioneve në teknologjitë e pastra dhe inovacioni i punëve të gjelbra duke përdorur një qasje të zhvillimit të zgjuar urban klimatik (ZHUK)" vonuar për shkak të çështjeve që lidhen me modalitetin e zbatimit të projektit Instrumenti Global i Mjedisit (IGM). Modaliteti i plotë i përvetësimit nga autoritetet nacionale (NEX) nuk është i preferuar as nga Ministria dhe as nga Zyra e OKB-së në vend, kështu që çështja e partnerit zbatues të projektit është ende e pazgjidhur.

Udhëzimet dhe praktikmat më të mira për ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme në Maqedoninë e Veriut në ofrimin e produkteve me efikasitet energjetik dhe në ofrimin e pajisjeve të energjisë së rinovueshme (UNECE): Përshtatja e Udhëzimeve dhe praktikave më të mira të zhvilluara më parë për NMVM-të në ofrimin e produkteve me efikasitet energjetik dhe në ofrimin e pajisjeve të energjisë së rinovueshme për Maqedoninë e Veriut.

Plani i menaxhimit të largimit të hidroklorofluorokarbureve (HCFC) (UNIDO). Ky aktivitet e mbështet angazhimin e vendit në kuadër të Protokollit të Montrealit. Hartimi dhe miratimi i legjislacionit në lidhje me menaxhimin e kontrolluara/uljen graduale të substancave:

- Urdhri që ndalon tregtimin e HCFC-141b dhe komponimeve që përmbajnë HCFC-141b

- Importi kufizues i porosisë (kuota) të hidroklorofluorokarbureve (HCFC)

- Urdhri që ndalon tregtimin e HCFC

- Projekt-rregullorja për llojet e kategorive të licencave për administrimin e ftohësve dhe/ose produkteve që përmbajnë ftohës.

- Propozim urdhëresa për ndalimin e importit dhe eksportit të frigoriferëve, frigoriferëve me ngrirje të thellë, kondicionerëve, pompave të nxehtësisë dhe pajisjeve të tjera ftohëse dhe ngrirëse, elektrike dhe të tjera.

- Monitorimi dhe kontrolli i përhershëm i konsumit të HCFC dhe substancave tjera të kontrolluara nga Protokollit i Montrealit mbi substancat që e hollojnë shtresën e Ozonit (vlerësimi i 40 licencave të importit)

- Monitorimi i skemës së rikuperimit dhe riciklimit: 36,115.05 kg substanca të kontrolluara dhe përzjeret e tyre të rikuperuara dhe ricikluara në vitin 2021.

Mbikëqyrja nacionale e dëmtuesve të bimëve dhe sistemet e certifikimit fitosanitar (FAO): Në vitin 2021, FAO kontribuoi në forcimin e njohurive teknike të autoriteteve nacionale të mbikëqyrjes së dëmtuesve të bimëve dhe certifikimit fitosanitar në vend, duke përfshirë Drejtorinë Fitosanitare në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe Laboratorin Shtetëror Fitosanitar, duke zhvilluar dhe vënë në dispozicion një udhëzues teknik për Menaxhimin e Integruar të Dëmtuesve (MID) dedikuar forcimit të kapaciteteve nacionale për t'u mbrojtur nga dëmtuesit e bimëve disa prej kulturave më të rëndësishme ekonomike në Maqedoninë e Veriut. Udhëzuesi "Menaxhimi i integruar i shkaktuesve të sëmundjeve dhe dëmtuesve kryesorë në prodhimin e hardhisë, domateve dhe specit në Republikën e Maqedonisë së Veriut" është i disponueshëm në gjuhën [angleze](#), [maqedonase](#) dhe atë [shqipe](#).

Ky ishte aktiviteti i fundit i një projekti të FAO-s, i cili kontribuoi në forcimin e kapaciteteve të rreth 20 përfaqësuesve të stafit të organizatave nacionale mbi dëmtuesit e bimëve në sistemet nacionale të mbikëqyrjes së dëmtuesve të bimëve, diagnostikimin e dëmtuesve dhe certifikimin fitosanitar, bazuar në standardet ndërkombëtare për masat fitosanitare (SNMF), miratuar sipas Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Bimëve (KNMB)

Bujqësi dhe agroekologji e mençur klimatike - rritje e qëndrueshme e produktivitetit në bujqësi përmes të dhënave me cilësi të lartë për vendimmarrje (FAO): Në vitin 2021 me mbështetjen e FAO-s, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave filloi të integrojë të dhëna nga platformat dhe bazat e të dhënave të ndryshme nacionale për mjedisin (pako të dhënash nacionale dhe harta për klimën, tokën, terrenin, statistikën dhe më shumë) me të dhëna të ndryshme ekzistuese globale në një platformë të vetme të Hartës së Tokës (zhvilluar nga FAO dhe Google) për t'i shërbyer formulimit efektiv dhe me kohë të politikave, vendimmarrjes dhe ndërhyrjeve për bujqësi të qëndrueshme, si dhe për përmbushje të detyrimeve ndërkombëtare, siç janë raportimi kundër në raport me OZHQ-të.

Strategjia për Humbjen e Ushqimit dhe Reduktimin e Mbeturinave (FAO): Pakoja edukative për fëmijë e FAO-s për Humbjen e ushqimit dhe reduktimin e mbeturinave- "Bëj mirë: kurse ushqimin!" u përshtat në gjuhën maqedonase në vitin 2021. Materialet mësimore janë të synuara për fëmijët dhe të rinjtë nga pesë deri në katërmëdhjetë vjeç, për të nxitur ndërgjegjësimin për pasojat ekonomike, sociale dhe mjedisore të shpërdorimit të ushqimit, avantazhet e parandalimit të mbetjeve ushqimore, veprimet që fëmijët mund t'i ndërmarrin për t'i reduktuar mbetjet ushqimore dhe zakonet e mira që ata mund t'i zhvillojnë dhe prezantojnë të miqtë, familjet dhe komunitetet e tyre për t'i reduktuar mbetjet ushqimore. Pakoja arsimore kontribuon në përmbushjen e objektivit 12.3 të Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm global - Përgjysmimi i mbetjeve ushqimore globale për kokë banori në nivelet e shitjes me pakicë dhe nivel të konsumatorit dhe zvogëlimi i humbjeve ushqimore përgjatë zinxhirëve të prodhimit dhe furnizimit deri në vitin 2030 - si dhe adresimi i objektivave tjerë shoqëruar si p.sh. Kequshqyerja, Ndryshimet klimatike dhe Ruajtja e burimeve natyrore. Këtu janë të disponueshme publikimet ([Bëj mirë, kurse ushqimin 1](#), [Bëj mirë, kurse ushqimin 2](#), [Bëj mirë, kurse ushqimin 3](#), [Bëj mirë, kurse ushqimin 4](#)). Gjithashtu u zhvillua dhe publikua versioni maqedonisht i [Udhëzuesit të FAU-s për zvogëlim të mbeturinave të ushqimit nga konsumatorët](#).

Programi i punës së vendit për Fondin e Gjelbër Klimatik dhe fuqizimi i kapaciteteve për përshtatjen dhe zbutjen ndaj ndryshimeve klimatike (FAO): Në vitin 2021, FAO e mbështeti Kabinetin e Zëvendëskryeminitrit të Qeverisë përgjegjëse për Çështjet Ekonomike, për të zhvilluar dhe

dorëzuar në FGJK Programin e parë të punës së FGJK. Si pjesë e zhvillimit të Programit të Punës FGJK në vend, u realizua një Vlerësim i Nevojave të Gatishmërisë dhe Zhvillimit të Kapaciteteve. Bazuar në Vlerësimin e Nevojave të Kapaciteteve, FAO e zhvilloi një program mësimor të detajuar trajnimit për trajnime në fushën e ndryshimeve klimatike dhe angazhim me Fondin e Gjellbër Klimatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, veçanërisht në fushat specifike të: 1) Angazhimit të sektorit privat në financimin e FGJK-së; 2) Ndikimit në ndryshimet klimatike, masat dhe roli i FGJK-së në mbështetjen e veprimit klimatik; 3) Gjinia dhe ndryshimet klimatike; 4) Financimi i klimës; 5) Teknologjitë klimatike; 6) FGJK/Procesi Nacional i FGJK. Trajnimet janë në dispozicion për të gjitha palët e interesuara të FGJK-së në www.greendevlopment.mk.

Është zhvilluar një propozim katalog për teknologjitë klimatike nga të nëntë sektorët prioritarë. Procesi i Vlerësimit të Shpejtë të Subjekteve Nationale të Qasjes së drejtpërdrejt të mundshme në FGJK u realizua duke propozuar tre skenarë të ndryshëm për akreditimin nacional të FGJK-së në Subjekteve Nationale të Qasjes. FAO punoi me Qeverinë për hartëzimin e palëve të sektorit privat në Maqedoninë e Veriut dhe për t'i ndihmuar ata t'i shfrytëzojnë plotësisht mundësitë e FGJK-së, duke përfshirë zhvillimin e metodologjisë së angazhimit të sektorit privat, anketën në internet, manualin e angazhimit të sektorit privat dhe bashkëpunimin e ngushtë me Fondin për Inovacion dhe Zhvillim të Teknologjisë.

Përmirësimi i qëndrueshmërisë klimatike në bujqësi (sistemi i farëve të qëndrueshme) (FAO): Në vitin 2021 FAO e mbështeti Qeverinë e Maqedonisë së Veriut për të përmirësuar sistemin e farës së vendit, duke përmirësuar prodhimin vendas të farëve të kulturave strategjike me cilësi të lartë, tolerante ndaj klimës, dhe duke ndërtuar kapacitetet nacionale për ta siguruar furnizimin e duhur të farës për fermerët. Në bashkëpunim me Institutin e Bujqësisë të UKIM, në komunat e Koçanit, Shkupit dhe Llozovës u krijuan parcela demonstruese në terren për shumimin e varieteteve tolerante ndaj klimës të fasules, specit dhe grurit dhe u ofruan e trajnime në fermë për forcimin e kapaciteteve të fermerëve në prodhim cilësor të farës për rritjen e rezistencës dhe arritjen e rendimenteve optimale në një klimë në ndryshim. Si pjesë e nismës, u trajnuan më shumë se 35 fermerë dhe prodhues bujqësorë, si dhe përfaqësues të fermave të farës, kooperativave bujqësore dhe Agjencisë Nationale për Promovimin e Zhvillimit të Bujqësisë se si t'i përzgjedhin, testojnë dhe ta rritin farat me cilësi të lartë për çdo kulturë, në mënyrë që të arrihen rendimentet optimale në kuadër të ndryshimeve klimatike. Përveç kësaj, FAO e bëri një vlerësim të sistemit nacional të farës në Maqedoninë e Veriut, duke përfshirë rishikimin e prodhimit nacional të farës, certifikimit, shpërndarjes, vlerësimit të cilësisë, ruajtjes ex situ (jashtë ambientit natyror) dhe programeve të mbarështimit të bimëve.

Komunikimi i bazuar në fakte për iniciativat zhvillimore mbi veprimin klimatik të udhëhequr nga të rinjtë (UNICEF): Po ashtu në drejtim të fuqizimit të më tejme të zërit të të rinjve, UNICEF e krijoi platformën U-Raport në vend. Gjatë kësaj periudhe raportuese grumbulloi 300 U Reporter dhe publikoi 9 sondazhe. Këto aktivitete angazhuan shumë vullnetarë të UNICEF-it dhe do të vazhdojnë ta bëjnë këtë në punën e mëtejme të U-Raportit.

Edukimi për mjedisin dhe ndryshimet klimatike (UNICEF): Me financim nga Agjencia Suedeze e Zhvillimit Ndërkombëtar, UNICEF-i vendosi një fokus më të madh në edukimin mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike. U krijuan partneritete të reja me qeverinë dhe organizatat e shoqërisë civile, ndërsa përmbajtja e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike u gërshetuan në kurrikulat e reja për klasat I dhe IV. Për t'i mbështetur kapacitetet e mësimdhënësve, mbi 60 mësues dhe edukatorë të enteve parashkollore dhe shkollave fillore e ndoqën një program trajnimit për mësimin nga përvoja dhe integrimin e koncepteve mjedisore në mësimdhënie, i cili do të shpërndahet përmes komuniteteve të mësimin profesional.

Mësimi eksperimental mbi praktikën mjedisore (UNICEF): Mbështetur nga qeveria dhe partneritetet me të rinjtë dhe

zyrën e Presidentit të Maqedonisë së Veriut, programi i ri i ndryshimeve klimatike i UNICEF CO u shty përpara në më pak se 10 muaj. Deri në nëntor, Deklarata Rinore mbi Klimën e zhvilluar nga të rinjtë, u mbështet nga Presidenti i vendit dhe u prezantua në Konferencën e OKB-së për Ndryshimet Klimatike në Glasgou.

Modelimi i zgjidhjeve inovative për mjedisin dhe klimën - kapacitetet dhe financimi fillestar për të rinjtë (UNICEF): Në kuadër të programit për ndryshimet klimatike dhe edukimin mjedisor, UNICEF e zbatoi ciklin UPSHIFT kushtuar temës. 10 ekipe prej 46 të rinjsh nga shkollat e mesme të vendit e përfunduan punëtorinë treditore të të projektimit të idesë. Pesë ekipeve iu nda financim fillestar, për ta çuar përpara novacionin e tyre mbi ndryshimet klimatike dhe sociale për mbrojtjen e mjedisit.

PRODHIMI 3.2. MENAXHIMI I INTEGRUAR, I QËNDRUESHËM DHE GJITHËPËRFSHIRËS I RESURSEVE NATYRORE

Planifikimi i përdorimit të tokës dhe siguria industriale për Evropën Juglindore (UNECE): Punëtorja nënrajonale mbi planifikimin e përdorimit të tokës dhe sigurinë industriale për Evropën Juglindore siguroi një platformë për vendet e Evropës Juglindore (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovina, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut, Serbi) për t'i ndarë përvojat dhe praktikën e tyre të mira në koordinimin e planifikimit të përdorimit të tokës dhe procedurat e sigurisë industriale dhe për ta mbështetur bashkëpunimin ndërmjet eksperteve përkatës për parandalimin e aksidenteve industriale, duke përfshirë në kontekstin ndërkufitar. Punëtorja nënrajonale për planifikimin e përdorimit të tokës dhe sigurinë industriale për Evropën Juglindore u mbajt në Beograd, 27-29 tetor 2021.

Pakot e politikave për qeverisjen mjedisore (UNECE): 1) Analizuan dhe zhvilluan një propozim të politikave dhe qeverisjes së duhur në sektorë me potencial për zbutjen e emetimeve të gazrave serrë (GS), duke kontribuar në përmirësimin e OZHQ-ve dhe integrimin e ndryshimeve klimatike drejt një angazhimi më ambicioz nacional, duke përfshirë luftimin e pandemive; 2) Ofruan mbështetje teknike për krijimin e një kuadri monitorimi dhe vlerësimi për dokumentet aktuale dhe të ardhshme të politikave mbi menaxhimin e cilësisë së ajrit. Prezantimi i një modeli për planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e dokumenteve të politikave të cilësisë së ajrit; 3) Dokument që mundëson dhe kontribuon në ngritjen e kapaciteteve (krijimin e një kornize efektive) të njësive të vetëqeverisjes vendore për zbatimin e legjislacionit mjedisor dhe rekomandimeve të Rishikimi i Performancës Mjedisore (RPM), si dhe përmirësimin e koordinimit ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor në zbatimin e legjislacionit mjedisor. Po ashtu dokumenti duhet t'i paraqesë edhe sfidat e vetëqeverisjes lokale gjatë krizës së KOVID-19; 4) Vlerësuan nivelin aktual të zbatimit të planeve ekzistuese rajonale të menaxhimit të mbeturinave. Duhet të vlerësohet kapaciteti i ndërmarrjeve publike komunale në komuna për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave në stacionet e transferimit ose qendrat rajonale. Njashtu duhet të zhvillohen udhëzimeve profesionale për komunat dhe qendrat rajonale të menaxhimit të mbeturinave; 5) Vlerësuan kapacitetet për zbatimin dhe zbatimin e Planeve të Menaxhimit të Pëllgjeve Lumore (PMPL) në mënyrë që të përgatitet një plan për forcimin e kapaciteteve për zbatim dhe një plan për procedurën e konsultimit publik për zhvillimin dhe miratimin e dokumenteve të menaxhimit të pëllgjeve lumore.

Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës dhe Pyjeve (UNEP): UNEP filloi ta planifikojë dhe përgatisë konceptin dhe kurrikulën për trajnimin mbi ngritjen e kapaciteteve, si dhe realizim të vizitave studimore, me qëllim të forcimit të kapaciteteve nacionale ligjore dhe institucionale për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Tokës dhe Menaxhimin e Qëndrueshëm të pyjeve të partnerëve të projektit, si MMJPH dhe MBPEU, Pyjet Nacionale, NP për Menaxhimin e Kullotave, Shërbimet Nacionale për Menaxhimi e Ujërave, Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale (Komunat), institucionet kërkimore dhe universitetet, OSHC-të dhe palët tjera të projektit.

Strategjia për mbrojtjen e tokës dhe udhëzimet për krijimin

e programit të monitorimit të cilësisë së tokës (UNEP): Për t'i adresuar mangësitë dhe dobësitë nacionale në politikën e përdorimit të tokës dhe degradimit të saj dhe për të përshpejtuar arritjen e neutralitetit të degradimit të tokës, UNEP e filloi procedurën për përgatitjen e strategjisë për mbrojtjen e tokës, dhe udhëzimet për monitorimin.

Programi i trajnimit për menaxhimin e zonave të mbrojtura + udhëzime për të mbështetur rishikimin e Planit Kombëtar Hapësinor (UNEP): Trajnimi për ngritjen e kapaciteteve për rojet e zonave të mbrojtura që përfshin katër module (Legjislacioni për ruajtjen e natyrës; Ruajtja dhe monitorimi i vlerave natyrore; Bashkëpunimi ndërinstitucional me inspektoriatet; Përmirësimi i komunikimit dhe aftësive personale), kontribuoi në përmirësimin e aftësive dhe njohurive për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, përmirësimin e ruajtjes dhe monitorimit të biodiversitetit. Në këtë drejtim janë përgatitur dy doracakë: (1) për përfshirje më të madhe të biodiversitetit në planifikimin hapësinor në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe (2) për menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve në vend.

Korridoret pilot nga Rrjeti Kombëtar Ekologjik i propozuar (MAK-NEN) (UNEP): Për të arritur mbrojtjen e biodiversitetit, duke krijuar dhe menaxhuar në mënyrë efektive zonat e mbrojtura dhe duke integruar biodiversitetin në planifikimin e përdorimit të tokës, UNEP i ndihmoi organet përkatëse shtetërore në përmirësimin e lidhjes së zonave të mbrojtura duke e përgatitur dokumentacionin për dy bio korridoret: 1. Korridoret ekologjike: Bukoviq (Sretkovë) dhe Bukoviq (Kollari), si vazhdimësi e korridorit ekologjik ndërkufitar Mavrovë (MK) - Korab Koritnik (AL) - Mali Munela (AL).) dhe 2. Korridoret ekologjike: Mali Seleçkë, Dren - Vitolishtë dhe Kozjak (Pletvar), si pjesë e korridorit më të madh ekologjik Nixhe - Kozhuf - Jakupicë (MK). Dy video promovionale në dispozicion – [video 1](#) dhe [video 2](#).

Librat e Kuq për Zvarranikët dhe Ujëtokësorët (UNEP): Është përgatitur lista e parë të kuqe në nivel nacional të zvarranikëve dhe ujëtokësorët, duke ofruar informacione kryesore mbi rreziqet e zhdukjes. Krijimi i Listës së parë nacionale të kuqe ofron pasqyrë mbi rreziqet e zhdukjes në nivel nacional dhe ndihmon në vlerësimin e ndikimit të masave për ruajtjen e biodiversitetit. [Listat e kuqe](#) pritet ta përmirësojnë politikëbërjen shtetërore, të ndihmojnë në përcaktimin e objektivave të ruajtjes dhe ta matin progresin drejt arritjes dhe zbatimit të Direktivave të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së natyrës, si dhe Marrëveshjes së Gjelbër të BE-së. Gjithashtu të dhënat do të plotësohen në raportimin për marrëveshjet shumëpalëshe si Konventa për Diversitetin Biologjik. Krijimi i Listave të kuqe në nivel nacional u bë në kuadër të projektit Arritja e ruajtjes së biodiversitetit përmes krijimit dhe menaxhimit efektiv të zonave të mbrojtura dhe përfshirjes së biodiversitetit në planifikimin e përdorimit të tokës - iniciativë e zbatuar nga UNEP së bashku me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Maqedonisë së Veriut, me financimi nga Fondi Global i Mjedisit. Bazuar në gjetjet e listës së kuqe dhe me disa punë shtesë në terren, janë prodhuar gjithashtu Libra të kuq për zvarranikët dhe ujëtokësorët.

Identifikimi i pyjeve me vlerë të lartë natyrore në shkallë nacionale (UNEP): UNEP e finalizoi procesin për identifikimin e 188 pyjeve (55988 hektarë) me vlera të larta natyrore dhe përgatiti udhëzime për menaxhimin e ardhshëm. Pyjet janë habitate të përshtatshme për shumë bimë, zogj dhe specie të tjera shtazore, për shkak të kompleksitetit të tyre strukturor dhe funksional, andaj këto specie shpesh varen shumë nga cilësia e pyjeve. Pyjet me vlerë të lartë natyrore (PVLN) janë "pyje tërësisht natyrore dhe pyjet gjysmë-natyrore në Evropë, ku menaxhimi (historik ose aktual) mbështet një diversitet të lartë të specieve dhe habitateve vendase, dhe/ose ato pyje që e mbështesin praninë e specieve evropiane, nacionale dhe/ose rjonale, për të cilat është ngritur shqetësim, siç është përcaktuar nga Instituti i Politikave Evropiane të Mjedisit.

Kuotat e identifikuara për specie në nivel nacional (UNEP): Rëndësia e produkteve pyjore jo-drunore në ekonominë (PPJD) lokale dhe vlerat e biodiversitetit kanë rol të ndryshëm, por të rëndësishëm. Përcaktimi i kuotave të PPJD mund të

ndikojë ndjeshëm në ekuilibrin dhe qëndrueshmërinë e specieve brenda vendit. Me qëllim të krijimit të menaxhimit të qëndrueshëm të PPJD, UNEP e përgatiti një Vlerësim të statusit të rrushin e arushës (identifikimi i kuotave në shkallë nacionale) si dhe e përgatiti Raportin për përdorimin e PPJD në Maqedoninë e Veriut me një pasqyrë socio-ekonomike dhe analizë ligjore, së bashku me Vlerësimin e Burimet Juniperus communis në njësinë pyjore Umlena. Për të arritur qëndrueshmërinë e PPJD-së, u zhvillua trajnimi për ndërtimin e kapaciteteve për mbledhësit e PPJD-së. Bazuar në gjetjet dhe rekomandimet në lidhje me rrushin e arushës, MMJPH e lëshoi një Urdhër për ta kufizuar mbledhjen e këtyre specieve, për përdorim dhe tregtim dhe një [video promovuese të rrushit të arushës](#).

Zhvillimi i hartave të bimësisë pyjore (UNEP): Tri zonat pilot, që mbulohen nga përgatitja e hartës së vegjetacionit pyjor, në kuadër të këtij projekti ndodhen në pjesët lindore të Maqedonisë së Veriut dhe përfshijnë pjesën më të madhe të maleve të Maleshevës dhe malit Ograzhden. Sipërfaqja totale e projektit është 55,777.0 hektarë ose 2.17% e territorit të vendit. Shumica e pyjeve brenda kufijve të zonës së projektit janë në pronësi të shtetit dhe menaxhohen nga NP Pyjet Nacionale, nga filialet e saj në Pehçevë, Berovë dhe Strumicë, ndonëse janë përfshirë edhe pyjet në pronësi private.

Zhvillimi i bazës së të dhënave për shkallën e vulosjes dhe humbjes së lëndës organike të tokës (UNEP): UNEP i mbledhi të dhënat e nevojshme për shkallën e vulosjes së tokës dhe humbjen e lëndës organike të tokës (LOT), duke pilotuar tre lokacione në rajonin e Strumicës, Prilepit dhe Ohrit. Evidenca tregoi një rënie të LOT në të tre vendet, veçanërisht në tokën bujqësore, e cila është rezultat i praktikave jo të duhura të menaxhimit, të zbatuara në rajonet pilot.

Harta nacionale e ndjeshmërisë ndaj erozionit dhe thatësisë (UNEP): Përmes një procesi hetimesh në terren, modelimit të erozionit, modelimit të intensitetit të erozionit, UNEP e përgatiti hartën nacionale të ndjeshmërisë ndaj erozionit dhe thatësisë dhe identifikimin e zonave me rrezik të lartë dhe ndikimin e tyre në biodiversitet.

Planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura sipas metodologjive të reja (UNEP): Në bashkëpunim me ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë, përmes një procesi pjesëmarrës konsultimesh, UNEP i përgatiti draft planet e menaxhimit për [Parkun Nacional Mali Sharr](#) dhe liqenin e Ohrit, duke marrë parasysh të gjitha të dhënat dhe prioritetet nga Studimet për valorizim.

Studimi i valorizimit për liqenin e Ohrit (UNEP): UNEP me ekspertizën e Bashkimit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (BNRN) dhe përmes një procesi pjesëmarrës konsultimesh e përgatiti Studimin për valorizimin e vlerave natyrore të liqenit të Ohrit. Studimi për vlerësim është përdorur si informacion bazë për përgatitjen e draft planit të menaxhimit dhe gjithashtu do të kontribuojë në rishpalljen e liqenit të Ohrit si monument i natyrës.

Ngjirt e kapacitetit të fermerëve në pellgun e lumit Strumica për praktika të mira bujqësore (GAP) (UNDP): Kanë përfunduar ndërhyrjet për restaurimin e pellgut të lumit Strumica, të cilat kanë filluar në vitin 2015. Me sukses janë finalizuar aktivitetet tjera, si lidhja e 25 amvisërive individuale në sistemin e grumbullimit të ujërave të zeza dhe funksionalizimi i plotë i impiantit për menaxhim të ujërave të zeza në fshatin Edrenikovë, cikli i tretë i marrësve të grantit për prezantimin e praktikave të reja bujqësore agro-ekologjike, që përfshinte 60 fermerë, marrësit e granteve që kanë marrë njohuri të plota eksperte dhe aftësi teorike dhe praktike për përfshirjen e praktikave bujqësore agro-ekologjike dhe kompletin e plotë të pajisjeve të nevojshme bujqësore.

Qëndrueshmëria urbane në rajonin e Shkupit (UNDP): Vlerësimi i rreziqeve për qytetin e Shkupit u përditësua, madje në bashkëpunim të ngushtë me departamentet përkatëse u zhvillua një plan për mbrojtjen nga zjarri dhe një plan për përmirësimin e kapaciteteve të Brigadës së Zjarrfikësve të Qytetit të Shkupit. Gjithashtu, është përgatitur

dokumentacioni teknik për zbatimin e masave antierozive në Karadak të Shkupit. Zbatimi i masave të propozuara duhet t'i parandalojë ngjarjet e rënda të përmytjeve të tilla si ato që ndodhën në vitin 2016. U identifikuan shtigjet e mundshme të transmetimit të kromit gjashtëvalent në ujërat nëntokësore të malit Zheden dhe u vlerësua ndikimi i tyre në burimin e Rashçes. Janë instaluar pesë stacione automatike pa tel (zhytës) në piezometrat e rrjetit të ri monitorues në zonën e pusit Nerez – Lepenc për të vendosur monitorim të vazhdueshëm të ujërave nëntokësore, të realizuar në kohë të duhur dhe më saktësi.

80 punonjës të administratës së qytetit u trajnuan për ta përdorur dizajnin me në qendër njeriun, mjetet dhe metodat për përmirësimin e shërbimit publik, me çka u ridizajnuan dhe u përmirësuan 5 shërbime. Çatia e Gjelbër është ndërtuar në Shtëpinë e Kulturës "Koço Racin", kontribuon në uljen e temperaturës në blloqet urbane në qendër të qytetit dhe ofron hapësirë për organizimin e manifestimeve publike. Gjithashtu, Kadastra e Gjelbër për Qytetin e Shkupit është përmirësuar me 12,537 pemë dhe shkurre të gjeo-referencuara dhe të inventarizuara. Përpjekjet për përmirësimin e mëtejshëm të transparencës së administratës publike u mbështetën përmes zhvillimit të të dhënave të Partneritetit të Qeverisjes së Hapur (PQH) për qytetin e Shkupit, organizimit të trajnimeve për departamentet përkatëse dhe zhvillimit të udhëzimeve përkatëse.

Qëndrueshmëria klimatike e prodhimit bujqësor në rajonin juglindor (FAO): FAO në bashkëpunim të ngushtë me MBPEU dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e përgatiti dhe dorëzoi një projekt të Maqedonisë së Veriut për Fondin e Përshtatjes, i cili synon ndërtimin e qëndrueshmërisë klimatike të prodhimit bujqësor në rajonin e Radovishit përmes përmirësimit të ujitjes, menaxhimit të tokës dhe ujit, me një buxhet prej 9.9 milionë dollarë amerikanë. U miratua koncepti i projektit, ndërsa propozimi i plotë i projektit është në zhvillim e sipër. Zhvillimi i propozim-projektit përfshin konsultime të gjera me palët e interesuara në nivel lokal dhe qendror, duke përfshirë konsultime në komunitetin, konsultime me burra dhe gra fermere dhe autoritetet e vetëqeverisjes lokale në rajonin e synuar, si dhe konsultime teknike me Ndërmarrjet Shtetërore të Ekonomisë së Ujërave, MBPEU dhe MMPH (si Autoriteti Nacional i Përcaktuar për Fondin e Përshtatjes).

Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve të peshkimit në brendësi (FAO): Projekti kontribuoi drejtpërdrejt në jetesën e komunitetit të peshkimit, duke synuar përmirësimin e qëndrueshmërisë së të gjithë sektorit të peshkimit në brendësi përmes mbledhjes dhe menaxhimit më të mirë të të dhënave. Veç më janë të disponueshme të dhënat dhe metodologjitë e rëndësishme, duke u mundësuar vendeve me burime të përbashkëta liqenore të zhvillojnë plane të përbashkëta të menaxhimit, ta reduktojnë peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar të rrugëve ujore të brendshme dhe të përmirësojnë koordinimin midis palëve të ndryshme të interesit të trupave të përbashkët ujorë të brendshëm. Në këtë drejtim u prodhuan "Udhëzimet e praktikave të mira për sistemet e të dhënave në mbështetje të peshkimit të qëndrueshëm në brendësi të vendit dhe për qëllime rekreative në rajonin e Ballkanit Perëndimor" ([anglisht](#), [maqedonas](#), [shqip](#) dhe [gjuha malazeze](#)) dhe u dorëzuan qeverisë për përdorim nga palët kryesore nacionale.

Strukturat e Kodit Nacional (FAO): Duke marrë parasysh sfidat e imponuara nga pandemia COVID-19, një sërë aktivitetesh kyçe të projektit u prolonguan, duke përfshirë konferenca për ngritjen e vetëdijes, takime përgatitore, trajnime në punë, të cilat duhej realizuar me prani fizike të ekspertëve, veçanërisht duke pasur parasysh faktin se Maqedonia e Veriut është një vend me përvojë të kufizuar të Kodit për ndjekje të aktivitetëve në internet.

Standardet e sigurisë dhe cilësisë së ushqimit në sektorin e produkteve të qumështit (FAO): FAO e mbështeti MBPEU-në dhe palët përkatëse të interesuara përgjatë zinxhirit të vlerës së qumështit për të zhvilluar dhe futur standarde të cilësisë së ushqimit në sektorin e produkteve të qumështit

me fokus në skemat e pagesës së qumështit të bazuar në cilësi. Bazuar në vlerësimin e boshllëqeve strukturore dhe nevojave për zhvillimin e kapaciteteve për zbatim të parimeve të Organizatës së Tregut të Përbashkët (OTP) në sektorin e produkteve të qumështit, u zhvilluan dokumentet e mëposhtme mbështetëse të politikave në vend për ta përkrahur zhvillimin dhe krijimin e një skeme të pagesës së qumështit të bazuar në cilësi:

1. Koncepti për skemën e pagesës së qumështit, duke përkrahur hapat dhe mekanizmat, politikat, strukturat legjislative dhe institucionale të nevojshme për funksionalizimin e sistemit.

2. Udhëzime për prodhuesit e qumështit; për marrjen e mostrave të qumështit dhe për përpunuesit e qumështit mbi standardet e cilësisë, duke u bazuar në praktikatat e mira të higjienës, si parakusht për prodhimin higjienik të qumështit.

Liqeni i Ohrit trashëgimia botërore e UNESCO-s - Nisma e udhëhequra nga të rinjtë për të ndihmuar mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të liqenit të Ohrit (UNESCO): Ky aktivitet financohet nga Programi i pjesëmarrjes së UNESCO-s (PP), i cili ofron mekanizëm për t'i mbështetur aktivitetet nacionale, nënrajonale ose rajonale të shteteve anëtare, që janë në përputhje me prioritetet programore të Organizatës.

Menaxhimi i INNS në statusin e liqenit të Ohrit si trashëgimisë botërore e UNESCO-s (UNESCO): Ky aktivitet financohet nga Programi i Pjesëmarrjes së UNESCO-s (PP), i cili ofron një mjet për t'i mbështetur aktivitetet nacionale, nënrajonale ose rajonale të shteteve anëtare, që janë në përputhje me prioritetet programore të Organizatës.

PRODHIMI 3.3. ZVOGËLIMI I NDOTJES SË AJRIT NË MJEDISE URBANE

Ndërgjegjësimi i publikut mbi shkaqet dhe efektet e ndotjes së ajrit (UNDP): Në bashkëpunim me Shoqatën e Gazetarëve (ZNM), UNDP e krijoi një çmim për artikuj gazetaresk, videot ose historitë kërkimore mbi ndotjen e ajrit. Po ashtu kontribuoi për ta tërhequr vëmendjen mbi një temë, që nuk është shumë e pranishme në media, me përjashtim të periudhës së dimrit kur ndotja e ajrit zakonisht e arrin nivelin më të lartë. Artikulli "Konspiracion kundër ajrit" nga Laboratori i Gazetarisë Investiguese (LGI), i cili u vlerësua me çmimin e parë, e trajton çështjen e ndotjes së ajrit nga këndvështrime të ndryshme pasi i identifikon lidhjet e drejtpërdrejta midis cilësisë së keqe të ajrit dhe praktikave korruptive.

Të paktën 20 përfaqësues të OSHC-ve morën pjesë në trajnim dhe i avancuan njohuritë dhe kuptimin e tyre mbi çështjet përkatëse për burimet e ndotjes së ajrit, monitorimin dhe indeksat e cilësisë së ajrit, masat për adresim të ndotjes së ajrit, me çka iu mundësua atyre që të veprojnë për zgjidhje/politika të caktuara. Gjithashtu, të paktën 15 shitës me pakicë të pajisjeve ngrohëse i përforcuan njohuritë e tyre në lidhje me promovimin në mënyrë argumentuese të veçorive energjetike të pajisjeve të reja me efikasitet energjetik dhe në këtë mënyrë të ndikojnë në vendimin e klientëve të tyre për përzgjedhjen e këtyre produkteve.

Ndotja e ajrit nga ngrohja e amvisërive, dëshmi e konceptit të masave (UNDP): Gjithsej 128 shtëpi në vendbanimin Lisicë, Aerodrom, janë mbështetur në zëvendësimin e sobave joefikase me dru me kondicionerë të rinj, pompa ngrohjeje, dhe soba me pelet për ta reduktuar ndotjen e brendshme dhe të jashtme dhe masat e eficientës së energjisë në një numër amvisërish si instalimi i fasadës së re, ndërrimi i kulmeve, dritareve dhe dyerve. Shfrytëzuesit në gjendje më të mirë më mirë pjesërisht i kanë mbuluar kostot e këtyre ndërhyrjeve, ndërsa për familjet më të rrezikuara, kostot janë mbuluar plotësisht. Vëmendje e veçantë për përzgjedhjen e familjeve përfituese i është kushtuar statusit socio-ekonomik të familjeve dhe familjeve me PAK, fëmijëve dhe familjeve me kryefamiljar femra.

Ndryshimet rregullatore drejt sistemit të energjisë shtëpiake me emetim më të ulët (UNDP): Në koordinim me Ministrinë e Ekonomisë dhe përmes një procesi konsultativ

me institucionet përkatëse dhe palët kryesore të interesuara, UNDP e mbështeti zhvillimin e 15 tabelave korresponduese (formulari EU-MK dhe MK-Formulari i BE-së) për Rregullonet për Etikimin e Produkteve të Ndërlidhura me Energjinë.

Sistemi gjithëpërfshirës i monitorimit të ndotjes së ajrit në qytetin e Shkupit (UNDP): Një grup i të dhënave që janë mbledhur nga stacionet fikse monitoruese, të vendosura në vendbanimet Lisice dhe Karposh, dhe në stacionet mobile monitoruese, që janë vendosur në lokacione të ndryshme janë përcaktuar si kritike brenda kufijve të qyteti i Shkupit. Këto të dhëna do të modelohen dhe analizohen si pjesë e Studimit të Përhapjes së Burimeve për Aglomeracionin e Shkupit, që është zhvilluar nga Universiteti "Goce Dellçev", Shkup. Të dhënat e mbledhura nga monitorimi i studimit janë paraqitur në mënyrë vizuale në Platformën për Ndotjen e Ajrit: www.cistvozduh.mk. Platforma e bazuar në ueb ofron prezantim të besueshëm të të dhënave për ndotjen e ajrit, prezanton aktivitetet mbi ndotjen e ajrit në vend dhe krijon dhe komunikon ngjarjet përkatëse. Për më tepër, pesë pajisje monitoruese të brendshme u instaluan përkohësisht te familjet e përzgjedhura në Lisicë për ta matur cilësinë aktuale të ajrit në ambient të brendshëm.

Diskutimet për formatin e platformës së koordinimit janë ende në vazhdim. Synimi fillestar i një aktiviteti të tillë të platformës ishte ta mbështeste Grupin e punës ndërsektoriale për monitorimin e cilësisë së ajrit, drejt fuqizimit të efikasitetit të aktiviteteve koordinuese në faza të ndryshme, i cili fatkeqësisht nuk funksionon për një periudhë më të gjatë.

Aplikimi i nanogramave dhe strukturave funksionale në maskat dhe filtrat shëndetësore të ftyrës për mbrojtjen nga Covid 19 (UNESCO): Ky aktivitet financohet nga Programi i pjesëmarrjes së UNESCO-s (PP), i cili ofron një mjet për t'i mbështetur aktivitetet nacionale, nënrajonale ose rajonale të shteteve anëtare që janë në përputhje me prioritetin programor të Organizatës.

PRODHIMI 3.4 ZVOGËLIMI DHE PËRGJIGJA EFEKTIVE NDAJ RREZIKUT TË FATKEQËSIVE

Politika të bazuara në rrezik përmes mbledhjes dhe analizës së të dhënave nën nivelin nacional (UNDRR): OKB-ja mbështeti forcimin e vendimmarrjes së bazuar në prova për ZRRF-në, përmes krijimit të një indeksi rreziku të modelit nën nivelin nacional INFORM, hartës së cënueshmërisë, ekspozimit dhe përballimit të kapaciteteve nëpër njësitë nën nivelin nacional në Maqedoninë e Veriut. Zhvillimi i indeksit të rrezikut të modelit INFORM u bë në bashkëpunim me Qendrën e Përbashkët të Kërkimit të Komisionit Evropian, ndërsa rezultatet janë të disponueshme në këtë [link](#).

Qëndrueshmëria e komuniteteve të rajonit të Pollogut ndaj rrezikut nga përmblytjet (UNDP): Plani i menaxhimit të rrezikut nga përmblytjet për basenin e sipërm lumit Vardar u përditësua me të dhëna dhe informacione nga studimet e reja të kryera për rajonin e Pollogut. Një qasje e tillë u zgjodh pasi Plani i menaxhimit është dokumenti më i rëndësishëm i planifikimit për ndërhyrjet e ardhshme mbi zbutjen e rrezikut nga përmblytjet në rajon dhe si i tillë duhet të sigurojë të dhëna dhe informacione të sakta dhe të besueshme. Në këtë drejtim janë identifikuar masat për rritjen e elasticitetit të dy qendrave më të mëdha urbane në Pollog, qyteti i Tetovës dhe Gostivarit. Është identifikuar gatishmëria ndaj përmblytjeve dhe gjeo-rreziqeve tjera të ndërlidhura dhe është përgatitur draft koncepti për vendosjen e sistemit të paralajmërimit të hershëm në rajonin e Pollogut. Po ashtu janë identifikuar burimet kryesore të fundërrinës/sedimentit (rrëshqitjet e dheut dhe përrenjtë) në rajon së bashku me qasjet për menaxhimin e tyre në të ardhmen. Për 8 vendet më kritike do të përgatitet dokumentacioni teknik për stabilizimin e tyre. Është finalizuar dokumentacioni teknik për stabilizimin e përroit të Shipkovicës dhe rregullimin e shtratit të lumit të Bogovinës.

Menaxhimi i integruar i rrezikut ndërkufitar nga përmblytjet klimatike të pellgut të lumit Drin (UNDP): Me mbështetjen e UNDP-së, rrjeti i monitorimit hidrologjik dhe meteorologjik në pjesën maqedonase të pellgut të lumit Drin u zgjerua me 17 stacione të reja hidrologjike dhe 9 stacione meteorologjike,

që janë aktive dhe plotësisht funksionale. Për më tepër, në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit (MoU) me Institutin Hidrometeorologjik, u ndanë seritë historike të të dhënave hidrologjike dhe meteorologjike nga stacionet ekzistuese hidrologjike dhe meteorologjike në rajon, të cilat e mbulojnë periudhën nga viti 1960 e kënde. Ky grup i të dhënave është shumë i rëndësishëm dhe thelbësor për kalibrimin dhe saktësinë e modelit hidraulik të parashikuar, që do të zhvillohet për pellgun e lumit Drin, i cili është parakusht për zhvillimin e mjeteve të rrezikut nga përmblytjet dhe hartës së rrezikut, që synojnë kryerjen e vlerësimit të cënueshmërisë, prodhimin e hartave të cënueshmërisë, të cilat do të përfshijnë dëmet dhe vlerësimet e humbjeve të jetës dhe për testim të opsioneve të menaxhimit të përmblytjeve. Metoda e rilevimit LiDAR (Zbulimi i dritës dhe shtrirjes) për përgatitjen e DTM (Modeli Digjital të Lartësisë) dhe DSM (Modeli Digjital të Sipërfaqes) është kryer për pjesën maqedonase të pellgut të lumit Drin në bashkëpunim me Agjencinë për Kadastër të Patundshmërisë, duke përdorur një teknologji të sofistikuar (sipërfaqe prej përafërsisht 4,125 km²). Modeli i krijuar digjital i terrenit me rezolucion të lartë (DTM) do të përdoret si mjet bazë për përmirësimin e saktësisë së simulimeve të përmblytjeve dhe vlerësimeve të rrezikut dhe planifikimit të parashikuar të rrezikut nga përmblytjet, gjegjësisht menaxhimit të rrezikut. Është përgatitur dokumentacioni teknik për restaurimin e lumit Sateska dhe devijimin në shtratin e tij natyror, si dhe ka filluar procedura e lejes administrative me palët/përfuttesit kryesorë të prekur (komunat). Realizimi i masave strukturore do të kontribuojë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së ujit dhe ekosistemeve të liqenit të Ohrit, i cili është Monument i Natyrës dhe do ta adresojë edhe një nga rekomandimet e misionit reaktiv të UNESCO-s.

Reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë në sektorin bujqësor (FAO): Në vitin 2021, FAO e mbështeti përditësimin e një analize të mëparshme gjithëpërfshirëse të sistemeve nacionale të ZRRF-së për sektorin e bujqësisë, duke identifikuar pikat e forta dhe boshllëqet e kapaciteteve në legjislacionin, strukturat administrative dhe ngritjen institucionale në lidhje me ZRRF-të dhe menaxhmentin, për të dhënë rekomandime mbi forcimin e sistemit ekzistues. Një studim i ZRRF-së i vendit me fokus në sektorin e bujqësisë së Maqedonisë së Veriut u finalizua në dhjetor të vitit 2021 dhe u dorëzua për verifikim në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Qëndrueshmëria e sektorit të bujqësisë përmes praktikave bujqësore të mençura në raport me klimën (FAO): Në vitin 2021, FAO e mbështeti Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave për ta hartuar "Strategjinë e parë Nacionale të Kullimit dhe Ujitjes 2021-2031", një dokument i ri në të cilin vendi për herë të parë do ta përfshijë një plan/dokument strategjik të kullimit dhe ujitjes, i cili synon ta trajtojë menaxhimin e burimeve natyrore, veçanërisht të ujit përballë çështjeve sfiduese të ndryshimeve klimatike.

Në kuadër të të njëjtit projekt, FAO e mbështeti futjen e teknologjive të reja dhe inovative të bujqësisë së mençur në raport me klimën (BMK) nga komunitetet bujqësore vendase, përmes krijimit të tre vendeve për demonstrim pilot, në Strumicë, në fshatin Miravci (Komuna e Gjevgjeliçës) dhe në Resnjë. Në fakt, janë pilotuar disa teknologji të reja për BMK dhe qëndrueshmërinë klimatike në prodhimin bujqësor, duke përfshirë: i) Mbrojtjen e rrushit të pjergullës nga rrezet ultraviolette dhe breshëri në një sipërfaqe prej 0.4 hektarësh në fshatin Miravci; ii) prodhim komercial i mbyllur/i mbyllur me teknologji të lartë i perimeve të larmishme në një mjedis të kontrolluar (tunel modern plastik i lartë, me ngrohje elektrike, ujitje me pika dhe kontroll të lagështisë) në Miravci; iii) hidroponia dhe kultura e substratit të perimeve në mjedis të mbyllur dhe të kontrolluar në shkollën e mesme profesionale në Strumicë "Dimitar Vlahov"; iv) teknologjia e ujitjes përmes ruajtjes së ujit nëntokësor në Resnjë për prodhimin e mençur të lajthive në proporcion me klimën. Gjatë krijimit të zonave pilot, u mbajtën dy raunde trajnimesh për secilën zonë, ku u përfshin 55 fermerë vendas, të cilët u trajnuan për tema të ndryshme si: prodhimi i kulturës së substratit, prodhimi i klimës së kontrolluar, prodhimi i mjedrës, ujitja e nëntokës dhe planifikimi dhe strukturat e mbrojtura për vreshtat.

FAO e mbështeti një vlerësim të detajuar të gjendjes së sistemit ekzistues nacional të informimit për dëmtimet dhe humbjet dhe lidhjen e tij me metodologjinë e FAO-s për dëmtimet dhe humbjet, dhe rishikimin e cilësisë së të dhënave në secilin institucion të palëve të interesuara në lidhje me nevojat e të dhënave dhe ofroi rekomandime për përmirësimin e sistemi ekzistues informacionit për vlerësimin e dëmtimeve dhe humbjeve në sektorin e bujqësisë.

Gjithashtu u mbështet nga FAO rishikim i plotë i të gjitha politikave dhe planeve nacionale në lidhje me ndryshimin e klimës dhe bujqësinë, duke rezultuar me një raport me rekomandime për ndërhyrjet prioritare në politikat dhe planet nacionale, të cilat ndërlihen me përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike në sektorin e bujqësisë, me qëllim të mbështetjes së harmonizimit të politikave dhe planeve të përzgjedhura nacionale në lidhje me ndryshimet klimatike dhe bujqësinë me rregulloren e BE-së.

Gatishmëria për emergjencat shëndetësore dhe vlerësimi i rrezikut, duke përfshirë epidemitë dhe pandemitë (OBSh): Rishikimi i brendshëm i veprimit, ndihmoi në identifikimin e veprimeve të menjëhershme, afatmesme dhe afatgjata që duhet të ndërmerren për të përmirësuar reagimin aktual ndaj COVID-19 dhe në përgjithësi për të forcuar gatishmërinë e Maqedonisë së Veriut për përgjigje ndaj epidemive. Rekomandimet ndërsektoriale të paraqitura nga pjesëmarrësit përfshinin: i) investimin në qëndrueshmërinë e burimeve njerëzore dhe kapacitetet teknike të zhvilluara gjatë pandemisë, ii) ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve dhe trajnimin (me ushtrime të rregullta simuluese), iii) përditësimin e legjislationit në lidhje me emergjencat dhe sëmundjet ngjithëse, iv) përmirësimin e komunikimit ndërmjet ofruesve të kujdesit shëndetësor në të gjitha nivelet dhe v) rritjen e digjitalizimit të vazhdueshëm të sistemeve të informimit shëndetësor.

Përgjigja ndaj COVID-19 me gatishmëri e forcuar të emergjencës shëndetësore (OBSh): OBSh vazhdoi t'i mbështetë aktivitetet për forcimin e kapaciteteve të laboratorëve Nacionalë të Shëndetit Publik për zbulimin e SARS CoV 2, duke siguruar gatishmërinë për testime të laboratorit nacional të virologjisë përpara depërtimit të virusit në vend dhe më pas. Më tej suksesi i testimit të pandërprerë cilësorë përmes prokurimit në shkallë të gjerë të pajisjeve, furnizimeve dhe pajisjeve për mbrojtje personale për laboratorët, bazuar në vlerësimin e fuqishëm të kapacitetit, si dhe në trajnimin javor të pandërprerë për testimin, raportimin dhe biosigurinë. OBSh investoi në infrastrukturën dhe përmirësimin e serverëve për mbikëqyrje dhe punë të suksesshme laboratorike. Strategjia Nacionale e Sekuencës Gjenomike u finalizua dhe u miratua nga MSH. OBSh mbështeti koordinimin e rrjetit laboratorik për sekuencim dhe i zbatoi udhëzimet e OBSh-së për sekuencën, si dhe trajnimin rutinë të sekuencës gjenetike për ekspertët e laboratorit të shëndetit publik.

Është themeluar Qendra e Inteligjencës Epidemike dhe Operative e Emergjencave, duke rritur kapacitetet për menaxhim strategjik dhe monitorim të emergjencave, janë forcuar komunikimet dhe koordinim, si dhe janë përmirësuar mundësinë e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve për gjurmimin e kontakteve. Gjithashtu, u zhvillua koncepti dhe plani operativ për mobilizimin e burimeve dhe ngritjen e Rrjetit Funkcional të Qendrave Operative Emergjente të Shëndetit Publik (QOESH) nën koordinimin e MSH/ISHP dhe u funksionalizua QOESH ekzistuese dhe rrjetëzimi me Qendrave Operative Emergjente (QOE) rajonale. Platforma e trajnimit onlajn për COVID-19 u krijua për profesionistët shëndetësorë në gjuhën maqedonase dhe shqipe, duke ofruar trajnime dhe asistencë teknike për menaxhimin e rasteve të pacientëve me COVID-19, për ISHP-të, rehabilitimin, shëndetin mendor e kështu me radhë, duke siguruar qasje të qëndrueshme në kurse të akredituara për dhe në shkallë të larta të pranimit në nivele të ndryshme të kujdesit, duke i arritur rezultatet e synuara për ndërtimin e kapaciteteve të punonjëse shëndetësorë për t'iu përgjigjur më mirë sfidave të COVID-19. OBSh i mbështeti aktivitetet për ndërtim të besimit me komunitetet dhe për rritje të përfshirjes së sjelljeve mbrojtëse dhe parandaluese të

KOVID-19 midis punonjësve shëndetësorë, të moshuarve, të rinjve dhe popullatës rome. Kapacitetet e menaxhimit Infodemik u zhvilluan përmes organizimit të trajnimeve për përfaqësues nga autoritetet nacionale shëndetësore, organizatat për verifikimin e fakteve, agjencitë e OKB-së dhe partnerët ndërkombëtarë. OBSh gjithashtu shpërndau pajisje dhe furnizime mjekësore (pajisje biomjekësore, pajisje për mbrojtje personale, pajisje diagnostike dhe jo mjekësore prej rreth 800.000 dollarëve amerikanë në vitin 2021);

OBSh dhe një kontribut të madh në digjitalizimin dhe forcimin e sistemit elektronik shëndetësor: "Moj Termin" (Takimi im), duke përfshirë: digjitalizimin e të gjithë laboratorëve që kryejnë testimin për COVID dhe unifikimin e sistemit të të dhënave për teste pozitive dhe lidhjen me mjekët e familjes dhe epidemiologët; Digjitalizimi i sistemit të mbikëqyrjes së kontakteve; Zhvillimi i modulit të telemjekësisë për vazhdimin e shërbimeve shëndetësore; Zhvillimi i një baze të dhënash-moduli për të gjitha profilet ekzistuese të modulit të vlerësimit të Burimeve Njerëzore të Shëndetësisë, furnizimit dhe pajisjeve; Pyetësi elektronik epidemiologjik për COVID19; dhe Regjistri i plotë i pacientit me COVID-19 me import dhe analitikë retroaktive të të dhënave.

PRODHIMI 3.5 ZVOGËLIMI DHE MENAXHIMI EFIKAS I MBETURINAVE

Mekanizmi për operimin e qëndrueshëm të pastrimit në kompleksin OHIS (vend i kontaminuar me HCH (lindan)) (UNIDO): Janë dorëzuar dhe instaluar pajisje laboratorike për Institutin e Shëndetit Publik. Trajnimet dhe testimet janë në vazhdim e sipër. Thuajse ka përfunduar ndërtimi i themelit, i cili do ta bëjë zonën ku do të bëhet gërmimi i dheut të ndotur.

Aktivitetet e rehabilitimit të basenit të vogël të mbetjeve në kompleksin OHIS (UNOPS): Është nënshkruar kontrata për rehabilitimin e basenit të vogël të OHIS dhe kanë filluar aktivitetet.

REZULTATI 4

Qeverisja e mirë



Deri në vitin 2025 i gjithë shteti përfiton nga sundimi i përmirësuar i ligjit; politikat e bazuara në dëshmi, politikat parashikuese dhe të përgjegjshme gjinore; kohezioni më i madh shoqëror; dhe ofrimi efektiv i shërbimeve nga institucione transparente, llogaridhënëse dhe të përgjegjshme.

Kontributi për:



Fillimisht parimet themelore
Kapitulli 3.23 Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore
Kapitulli 3.24 Drejtësia, Liria dhe Siguria

Shpenzimet e OKB-së në 2021

\$9,084,881

Partnerët e zhvillimit:

Kabineti i Presidentit, Kabineti i Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit përgjegjës për Integrimin Evropian dhe Euroatlantik, Çështjet Ekonomike, Sistemin Politik dhe Qeverisjen e Mirë, Sekretariati për Çështjet Evropiane, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Vetëqeverisjes Lokale, të Punës dhe Politikës Sociale, Punëve të Jashtme, Financave, Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Drejtësisë, Kulturës, Arsimit dhe Shkencës, Mbrojtjes, Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Shëndetësisë, Parlamenti, Banka Popullore, Enti Shtetëror i Statistikës, Enti Shtetëror për Revizion, Byroja për Zhvillim Rajonal, Qendrat për Zhvillimin e 8 rajoneve planore, Gjykata Supreme, Gjyqësori, Prokuroria Publike për Krim të Organizuar dhe Korrupsion, Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Avokati i Popullit, Komisioni kundër Diskriminimit, Grupi i punës ndërmirësore për miratimin e politikës së migracionit, Këshilli Nacional për Barazi Gjinore, Drejtoria e Doganave, Agjencia për Rini dhe Sport, Organizata Botërore e Doganës, INTERPOL, OSBE, Komisioni Nacional për UNESCO, Oda e Avokatëve, Fakulteti Juridik "Justinian Prima", Akademia e Shkencave dhe Arteve, Asociacioni i Zyrtarëve Financiar, Asociacioni i Njësitë të Vetëqeverisjes Lokale, Rrjeti i Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS), Qyteti i Shkupit. Komuna e Aerodromit, Manastirit, Bogdancit, Bogovinës, Qendërs, Çashkës, Dellçevës, Gazi Babës, Gjevgjeliës, Gjoçe Petrovit, Gostivarit, Karposhit, Kavadar, Kisella Vodës, Kočanës, Kriva Pallankës, Kumanovës, Makedonski Brodit, Makedonska Kamenicës, Mavrovë-Rostushe, Novacit, Ohri, Shtipit, Nagoricit të Vjetër, Strugës, Strumicës, Sveti Nikollës, Tetovës, Velesit, Vinicës, Shoqata e Juristëve të Rinj Maqedonas, "Akcija Zdruzenska", organizatat e personave me aftësi të kufizuara dhe organizatat tjera të shoqërisë civile.

PRODHIMI 4.1. SUNDIMI I LIGJIT, QASJA NË DREJTËSI DHE MBROJTJA DHE PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT PËR TË GJITHË

Gjatë gjithë vitit 2021, OKB-ja forcoi partneritetin e saj me aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë për t'i përshpejtuar reformat e politikave, ligjore dhe institucionale, të cilat e avancojnë sundimin e ligjit, të drejtat themelore, barazinë gjinore dhe qasjen në drejtësi dhe shërbime cilësore që janë në dispozicion ndaj atyre që janë në nevojë. OKB-ja e investoi ekspertizën e saj kolektive për ta mbështetur hartimin e politikave të bazuara në prova, parashikuese dhe gjithëpërfshirëse dhe krijimin e vizionit strategjik afatgjatë, të bazuar fuqishëm në prova dhe në mbledhjen dhe analizën sistematike të të dhënave. OKB-ja ndihmoi më tej në ndërtimin e institucioneve të forta, efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet, të afta për t'i promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut për të gjithë, veçanërisht grupet që kanë mbetur pas.

Eksperti dhe mbështetja teknike e OKB-së ishte qendrore në hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe legjislacionit nacional në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe standardet ndërkombëtare në fushat e respektimit, promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, reformës gjyqësore, drejtësisë për fëmijët, ligjit civil dhe penal, kompensimit të viktimave, menaxhimi i migracionit, mbrojtja ndërkombëtare, decentralizimi, anti-korrupsioni, kontrolli i armëve dhe lufta kundër krimit të organizuar. OKB-ja kontriboi në zhvillimin e 21 politikave dhe 98 ligjeve dhe akteve nënligjore, të cilat ishin në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Shumë nga këto nisma të reja legjislative janë në procedurë parlamentare. Është zhvilluar një numër i madh rregulloresh, manualesh, udhëzuesish dhe analizash që e nxisin zbatimin e tyre në praktikë.

UNOPS e mbështeti Ministrinë e Drejtësisë në zbatimin e masave specifike të parashikuara në Strategjinë Sektoriale të Reformës në Drejtësi 2017-2022. Në këtë drejtim, UNOPS ofroi mbështetje legjislative në hartimin e Kodit të ri të procedurës civile dhe ndryshimeve në Ligjin për përgjegjësinë civile. Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut i është ofruar ndihmë teknike lidhur me hartimin ligjor dhe procesin e harmonizimit të shtatë akteve nënligjore, që kanë të bëjnë me punën e prokurorisë. Si rezultat i mbështetjes së UNOPS-it, mbi 200 nëpunës civilë, gjyqtarë dhe prokurorë u kualifikuan përmes 15 trajnimeve për çështje që kanë të bëjnë me hetimet dhe ekzaminimin efektiv, mekanizmin e kontrollit qytetar të punës së policisë dhe funksionimin e



Pjesëmarrës në një punëtori për rrjetëzimin e organizuar nga OJQ-ja "Akcija Zdruzenska", organizatë partnere e UN Women në kuadër të projektit për buxhetim të përgjegjshëm gjinor, 14-16 korrik 2021, Strugë. Foto: UN Women

Mekanizmit parandalues kombëtar në varësi të Avokatit të Popullit, jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (veçanërisht rastet historike), Konferenca e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private (HCCH) dhe Ligjin për Bashkëpunimin Ndërkombëtar në Çështjet Penale. Programi nacional për Miratimin e Legjislacionit të Bashkimit Evropian (NPA) 2021-2025 u përafra me prioritetet strategjike të Qeverisë, strategjitë sektoriale, prioritetet në Programin e Reformës Ekonomike dhe Agjendën 2030. Mbështetja e komunikimit të Sekretariatit të Çështjeve Evropiane (SEA) rezultoi në rritjen e pranisë digjitale dhe mediatike të SEA-s.

Disa agjenci të OKB-së kontribuan në një vlerësim gjithëpërfshirës të Projektligjit për barazinë gjinore dhe u angazhuan në zhvillimin e një Strategjie të re Nacionale për Barazi Gjinore. Vlerësimi i thekson fushat ku nevojiten përmirësime dhe ofron rekomandime konkrete për grupin hartues të udhëhequr nga MPPS. Duke punuar ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë dhe shoqërinë civile, OHCHR gjithashtu i mbështeti nismat legjislative, të cilat synojnë ta përmirësojnë qasjen në drejtësi dhe në sundim të ligjit, duke e përfshirë një ligj të ri për ta lehtësuar qasjen dhe për t'u orientuar kah kompensimi për të mbijetuarit dhe viktimat e të gjitha formave të krimeve të dhunshme, duke përfshirë trafikimin e personave dhe dhunën me bazë gjinore, dhe duke siguruar përputhshmëri me normat dhe standardet ndërkombëtare.

Pas miratimit të legjislacionit të ri kundër diskriminimit, OKB-ja i forcoi kapacitetet e mekanizmit të ri të ankesave, që Komisionit kundër diskriminimit, të angazhohet në mënyrë efektive në promovimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi në të gjitha bazat e njohura nga sipas të drejtës ndërkombëtare. OKB-ja i mbështeti institucionet nacionale të të drejtave të njeriut dhe shoqërinë civile për ta avancuar të kuptuarit e tyre për mënyrat për ta rritur kërkesën dhe për t'u angazhuar në mënyrë domethënëse në proceset e raportimit të shtetit dhe ndjekjes, si dhe për t'u angazhuar me mekanizmat ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut. Me synimin për të avancuar qasjen e bazuar në të drejtën ndaj aftësisë së kufizuar, **OHCHR e mbështeti krijimin e një kornize nacionale të monitorimit në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara**, e cila u fillua zyrtarisht në prill të vitit 2021, si një partneritet strategjik midis Avokatit të Popullit dhe 20 organizatat e personave me forma të ndryshme të aftësisë së kufizuar dhe organizatat e shoqërisë civile.

Njerëzit e mbetur pas u fuqizuan për t'i kërkuar të drejtat e tyre, për të marrë pjesë në mënyrë efektive dhe për të ndikuar në vendimmarrje. **Mbështetja e UNHCR-së forcoi sistemin shtetëror të ndihmës juridike falas për të filluar funksionimin për azilkërkesit, refugjatët dhe personat pa shtetësi**, e ndjekur nga një fushatë avokimi dhe udhëzime specifike për përmirësimin e zbatimit të legjislacionit përkatës. Përpjekjet e përbashkëta me SHOQËTËN e Avokatëve të Rinj Maqedonas (SHARM), si OSHC partnere, rezultuan në krijimin e një grupi prej 55 avokatësh, nga të cilët 40 të trajnuar për të ofruar ndihmë juridike.

Në vitin 2021, drejtimi i juridikut për refugjatët, e drejtuar nga Fakulteti Juridik në Shkup dhe UNHCR, regjistroi numrin më të madh prej 33 studentësh, të regjistruar duke përfshirë tre cikle studimi (universitare, master dhe studentë të doktoraturës). Përveç kësaj, dy module bazë të trajnimit për Mbrojtjen Ndërkombëtare të Refugjatëve janë dizajnuar për Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë dhe Oden e Avokatëve të Maqedonisë së Veriut, për t'u bërë pjesë e kurrikulës së rregullt të trajnimit të të dy subjekteve, të cilat do të vazhdojnë t'u ofrohen gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve, si dhe profesionistëve tjerë në sektorin e drejtësisë. UNHCR-ja e ka mbështetur MPPS-në në hartimin e Procedurave Standarde Operative për Integrimin Lokal të Refugjatëve, që përfshijnë gjithashtu elemente të monitorimit dhe vlerësimit dhe menaxhimit të integritetit (koncepti SOS). UNHCR-ja prokuroi dhe dhuroi pajisje TI për njësitë rajonale të policisë kufitare, që do të mundësojnë mbledhjen në kohë të të dhënave dhe regjistrimin e migrantëve që udhëtojnë në lëvizje të përziera.

Është intensifikuar dialogu dhe koordinimi i UNHCR-së me palët përkatës nacionale dhe ndërkombëtare, që punojnë në parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë, duke synuar çrënjosen e plotë të saj deri në vitin 2024. Brenda muajit të fushatës #IBelong (#UnëIPërkas), u transmetua një video në televizionet nacionale për ta rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e përfundimit të pashtetësisë në vend. Deri në fund të vitit 2021, rreth 33 persona pa shtetësi u ndihmuan me marrjen ose konfirmimin e shtetësisë, ndërsa rreth 512 personave iu ofrua këshillim ligjor. **UNHCR vazhdoi forcimin e aleancave drejt një zgjidhjeje sistematike për t'i dhënë fund pashtetësisë**, duke bashkëpunuar me aktorë të ndryshëm në forume kombëtare dhe ndërkombëtare. Mes tjerash, këto nisma përfshinin diskutime publike për draftin e parë të Strategjisë së Integritetit të Romëve 2022-2030, duke pasur parasysh se shumica e personave të regjistruar pa shtetësi janë romë, ngritja e kapaciteteve, ndërgjegjësimi i fëmijëve, siç është projekti "Ditë e hapur për edukim qytetar", konkretisht në temën "Edhe unë jam fëmijë dhe kam të drejta – fëmijë pa shtetësi".

UNICEF-i kontribuoi në përmirësimin e sistemit të drejtësisë për fëmijët përmes analizës ligjore, hartimit të politikave dhe legjislacionit. Analiza e boshllëqeve ligjore i dha Qeverisë rekomandime thelbësore për rishikim të Ligjit e drejtësisë për fëmijët, në drejtim të ofrimit të zgjidhjeve alternative për paraburgimin, kujdestarinë dhe nevojën për vendosjen e modeleve të drejtësisë restauruese. UNICEF-i i avancoi propozime për rishikimin e Kodit Penal për të gjithë

nenet që i prekin fëmijët, veçanërisht fëmijët viktime të dhunës. Këto ndërhyrje synojnë ta përmirësojnë ndjeshëm sistemin e mbrojtjes së fëmijëve përmes parandalimit, rehabilitimit dhe risocializimit më të mirë të fëmijëve, përmes reagimit ndërsektorial dhe të informuar për traumat, në përputhje me interesin më të mirë të fëmijëve. Për të zbatuar siç duhet legjislacionin e rishikuar, është zhvilluar një kurrikulë trajnimi shumësektoriale për të gjithë profesionistët përkatës. 25 profesionistë kanë fituar aftësitë e nevojshme për të vepruar si trajnerë dhe për t'i shpërndarë më tej njohuritë e fituara.

Paralelisht me këtë, **UNICEF-i punoi për ngritjen e sistemit të monitorimit të fëmijëve në konflikt dhe në kontakt me ligjin**, si dhe në përmirësimet e mëtejshme në qasjen e fëmijëve në drejtësi. Për këtë qëllim, u hartua një plan për ngritjen e kapaciteteve për Këshillin Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve (KSHPDK) bazuar në procesin e tyre të vetvlerësimit, së bashku me konsultimet fillestare me Trupin Koordinues Nacional për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi dhe Neglizhenca, KSHPDK-në dhe ESHS-në. Për t'i adresuar barrierat themelore shoqërore, që i pengojnë fëmijët të kenë qasje në drejtësi dhe t'i gëzojnë të drejtat e tyre në sistemin e drejtësisë, u kryen dy anketa që i vlerësojnë njohuritë, qëndrimet dhe praktikën, të cilat do të formësojnë hartimin e një fushate multimediale për adresim të barrierave themelore shoqërore, të cilat i parandalojnë fëmijët nga qasja në drejtësi. Kjo fushatë është planifikuar të zhvillohet në vitin 2022.

UNODC i rriti kapacitetet e praktikuesve të drejtësisë penale për ta luftuar trafikimin e personave (TP) dhe kontrabandën e migrantëve dhe për t'u angazhuar në veprime të përbashkëta bashkëpunuese në nivele rajonale dhe nën-rajonale, dypalëshe dhe shumëpalëshe, veçanërisht në hetimin dhe ndjekjen penale të këtyre rasteve, duke mbrojtur të drejtat e viktimave në përputhje me standardet ndërkombëtare. Prandaj, 40 përfaqësues të palëve dhe ekspertëve nacionalë të drejtësisë penale, përfshirë gjyqësorin, Prokurorinë Publike, MPB-në, MPPS-në, inspektorët e punës, përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe ndërkombëtare, sindikatave, kompanive private dhe akademisë i avancuan njohuritë e tyre përmes gjashtë seminareve multidisiplinare, që e mbuluan rajonin e Evropës Juglindore. Ata u fokusuan në: 1) qasjen në mjete efektive juridike për viktimat e trafikuar; 2) trajtimin e rasteve të trafikimit personal për qëllime të shfrytëzimit të punës; 3) adresimin e anës së kërkesës së TP-së; 4) trafikimin e fëmijëve, veçanërisht me qëllim të kriminalitetit të detyruar; 5) adresimin e TP-së në prostitucion nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar; dhe 6) zbulimin efektiv, hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të TP-së dhe veprime të rënduara të kontrabandës së migrantëve nga dhe përmes Evropës Juglindore, përmes këndvështrimit gjinor dhe të drejtave të njeriut. UNODC bëhet një anëtar zyrtar i organeve operative të Komisionit Nacional për Luftën kundër Trafikimit të Njerëzve dhe Migrimit të Paligjshëm (Sekretariati dhe Nëngrupi i tij për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve).

UNODC ndërmori një përmbledhje gjithëpërfshirëse të sistemeve dhe praktikave ekzistuese për mbledhjen dhe analizën e të dhënave për armët e zjarrit të sekuestruara



dhe të konfiskuara, pjesët dhe komponentët e tyre dhe municionet në të gjithë sektorin e drejtësisë penale. Dy raundet e para të mbledhjes së të dhënave kanë zbuluar se agjenci të ndryshme, duke përfshirë ato të zbatimit të ligjit, doganat, prokuroritë dhe gjyqësori, kanë metodologji të ndryshme të mbledhjes së të dhënave, me çka pamundësohet marrja e pasqyrave të krahasueshme statistikore dhe të dhënave tjera thelbësore për t'iu përgjigjur efektivisht të gjitha formave të krimit dhe për ta siguruar mbrojtjen e viktimave. Gjithashtu, u mundësua angazhimi dhe përgjigjet e institucioneve të drejtësisë penale në Pyetësorin global të UNODC-së mbi rrjedhën e armëve të paligjshme.

PRODHIMI 4.2. FUQIZIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË PUSHTETIT QENDROR DHE VENDOR

OKB-ja i përmirësoi sistematikisht kapacitetet e palëve shtetërore dhe joshtetërore, duke përfshirë zyrtarët qeveritarë, administratën qendrore dhe lokale, gjyqësorin, prokurorinë, Avokatin e Popullit, Komisionin Kundër Diskriminimit, ESHS-në, organet tjera të pavarura, si dhe shoqërinë civile. Kapacitetet nacionale janë rritur për t'i harmonizuar dhe zbatuar politikën, legjislativën, planifikimin dhe buxhetimin në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare, Agjendën 2030 dhe OZHQ-të, pastaj për të ofruar shërbime me cilësi të mirë dhe të përqendruar te njerëzit. Në këtë segment fokusi parësor ishte në zbatimin e standardeve ndërkombëtare, përvetësimin e aftësive negociuese për anëtarësim në BE, avancimin e njohurive mbi metodologjinë e zgjerimit të BE-së dhe procesin e anëtarësimit, përafrimin me legjislativën e BE-së në fusha të shumta, duke përfshirë dinamikën e popullsisë, politikën e menaxhimit të migracionit, azilin, mbrojtjen ndërkombëtare dhe decentralizimin.

Në këtë drejtim, **ekspertiza dhe mbështetja teknike e IOM-it** rezultoi në zhvillimin e dokumenteve kyçe të politikave në lidhje me menaxhimin e migracionit, si **Politika e Migracionit 2021–2025 dhe Planit të saj të veprimit**, të miratuar me një Rezolutë të Parlamentit në dhjetor të vitit 2021. Një tjetër moment historik i rëndësishëm ishte Profili i vendit për migrimin. Përveç kësaj, IOM vazhdoi t'i përmirësojë njohuritë dhe aftësitë e Grupit ndërinstitucional për ta integruar dhe institucionalizuar planifikimin dhe zhvillimin e politikave pjesëmarrëse, inovative dhe largpamëse në menaxhimin e migracionit në vitet e ardhshme.

Duke u mbështetur në bashkëpunimin e mirë me Parlamentin, **UN Women vazhdoi të angazhohej** në një dialog konstruktiv me organet e Parlamentit, duke përfshirë Komisionin e përhershëm për Mundësi të Barabarta, Institutin Parlamentar dhe Klubin e Grave Deputete për procesin legjislativ dhe politikëbërës si nxitës dhe shtytës për zbatimin sistematik të buxhetit të përgjegjshëm gjinor (BPGJ). 30 deputetë i forcuan njohuritë dhe të kuptuarit e tyre për vlerësimin gjinor të politikave dhe ligjeve, si dhe rolin mbikëqyrës të Kuvendit në avancimin e zbatimit të angazhimeve për barazi gjinore.

UNOPS-i e dyfishoi mbështetjen e ndërtimit të kapaciteteve për Sekretariatit për Çështje Evropiane (SÇE) dhe MPJ-në mbi procesin e anëtarësimit në BE përmes trajnimeve dhe rritjes së kompetencave dhe njohurive ekzistuese mbi procesin e anëtarësimit. Gjithashtu janë forcuar kapacitetet teknike të Komisionit Parlamentar për Çështje Evropiane dhe stafit administrativ për mbështetjen e procesit të përgjithshëm të negociatave për anëtarësim. Përveç kësaj, u rritën kapacitetet e institucioneve kryesore qeveritare për ta filluar procesin e negociatave dhe për t'i identifikuar fushat që kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme në kuadër të procesit të përgjithshëm të reformës së qeverisë. Kjo u arrit kryesisht nëpërmjet ofrimit të ngjarjeve për ngritjen e kapaciteteve (56 ngjarje dhe mbi 670 nëpunës civilë të trajnuar), që mbulojnë aspekte të ndryshme të procesit të anëtarësimit në BE (sundimi i ligjit, energjia, bujqësia, mjedisi, tregtia, arsimit, shërbimet financiare, politika të ndryshme të BE-së. etj.). UNOPS gjithashtu mbështeti zhvillimin e një numri të madh të rregulloreve, doracakëve, udhëzimeve dhe analizave që kanë të bëjnë me BE-në, duke mundësuar zbatimin e tyre praktik.

Si rezultat i mbështetjes së vazhdueshme të UN Women, viti 2021 shënoi një numër të shtuar të qeverive vendore me buxhet dhe programim të përgjegjshëm gjinor në përputhje me angazhimin e Qeverisë për të mundësuar kushte për barazi më të madhe gjinore dhe shërbime që do t'i fuqizojnë gratë. Në 10 komuna të reja u pilotuan iniciativa për politikëbërje dhe buxhetim të përgjegjshëm gjinor. Ngritja e synuar e kapaciteteve, planifikimi strategjik, mentorimi dhe shkëmbimi i përvojës me 21 komuna të tjera që tashmë kanë krijuar buxhet dhe programim, i mundësoi administratës komunale ta rrisë kuptimin e rëndësisë së statistikave dhe treguesve gjinorë dhe mbledhjen e të dhënave për hartimin e programeve lokale. Më shumë se 300 përfaqësues të administratës lokale nga 31 komuna i përmirësuan njohuritë dhe aftësitë për aplikimin e mjeteve të BPGJ-së në proceset e planifikimit dhe buxhetimit lokal, duke demonstruar kështu një reagim më të madh ndaj nevojave të grave dhe atyre më të cenueshme.

Në përpjekje për të përforcuar rolin e Makinerisë nacionale gjinore, UN Women i ka rritur kapacitetet e Departamentit për Mundësi të Barabarta të MPPS-së për të marrë leadership të fuqishëm në udhëheqjen dhe koordinimin e institucioneve tjera qeveritare në hartimin e politikave dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. Në këtë drejtim, u krijuar një qendër burimore për politikbërjen dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor për të shërbyer si qendër e njohurive. Stafit i përkushtuar i administratës në 15 ministri dhe 3 agjenci shtetërore i nënshtruan programeve të trajnimit dhe mentorimit në lidhje me zhvillimin e programeve sektoriale. Prej tyre, 13 ministri të linjës dhe institucione shtetërore kanë vazhduar ta aplikojnë BPGJ-në në proceset e tyre të programimit sektorial në përputhje me Metodologjinë e Qeverisë për BPGJ.

Duke kapur momentin pozitiv të reformës në fushën e arsimit dhe mjedisit, **UNICEF-i e nisi iniciativën "Riimagjoni të ardhmen"** së bashku me Zyrën e Presidentit të vendit. Faza fillestare e eksplorimit u drejtua një numri të madh të rinjsh me synimin për t'i identifikuar fushat kryesore të interesit të tyre. Bazuar në opinionet dhe pikëpamjet e mbi 700 të rinjve, u mbajtën një seri konsultimesh të thella me të rinj nga i gjithë vendi mbi tre tema të veçanta: Arsimi; Mjedisi dhe Ndryshimet klimatike; dhe Shëndeti dhe mirëqenia mendore. Rekomandimet e dala nga diskutimet u inkorporuan në një Strategji të Rinisë për Veprim që synon të informojë politiksbërësit. Strategjia në fjalë është nënshkruar dhe mbështetur nga Presidenti i vendit, duke u zotuar se do t'i mbështesë këto thirrje në emër të tyre. OKB-ja e mbështeti pjesëmarrjen e Maqedonisë së Veriut në Sfidën Globale të Pafundme të Gjeneratës së Dytë, dhe përsëri nxori një nga pesë finalistët globalë. Ekipi i eBionics konkurroi me zgjidhjen e tyre për ta zgjeruar qasjen në kujdesin protetik me Venus Arm, një krah bionik i prodhuar me 3D printer me burim të hapur për njerëzit me mungesë të gjymtyrëve të sipërme. Një tjetër sukses i dukshëm është një nga nënkampionët në punuar lokale. Duke punuar në aplikacionin Walkiie, ekipi "Diçka Atipike" fitoi njohje globale si një nga shtatë idetë e Bankës Botërore 2020 për fituesit në veprim.

UNDP ka kontribuar në avancimin e decentralizimit, duke i forcuar kapacitetet e këshilltarëve komunalë dhe bashkëpunimin ndërkomunal. Mbi 1,300 këshilltarë komunal përfituan nga platforma e e-njohurisë e mbushur me më shumë se 200 materiale të reja referimi. Modalitetet inovative të ofrimit të shërbimeve të digjitalizuara janë integruar në 7 pilot projekte, ku janë përfshirë 26 komuna në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal. Po ashtu, skema e granteve komunale u mundësoi më shumë se 700 qytetarëve të marrin pjesë aktive në procesin e vendimmarrjes për përzgjedhjen e 12 projekteve prioritare të komunitetit.

Për më tepër, me mbështetjen e **UNDP-së, ka vazhduar të përmirësohet decentralizimi fiskal**, duke u bazuar në mjetet inovative dhe digjitale për mbledhjen dhe administrimin e taksave vendore dhe tarifave të administrimit, i ndjekur nga një analizë e praktikave më të mira dhe mësimet të nxjerra. Këto përpjekje u mundësuan 15 komunave dhe dy rajoneve planifikuese (duke përfshirë 19 komuna) të përfitojnë nga Fondi i Dokumentacionit Teknik i lidhur me OZHQ-të. Këto komuna u mbështetën për të zhvilluar,

financuar dhe zbatuar 53 dokumentacione teknik kompleks për zhvillim të infrastrukturës me prioritet më të lartë. Është ofruar mbështetje në analizën, trajnimin dhe përmirësimin e rregullores për transferimin e çmimeve dhe shkëmbimin e informacioneve për qëllime tatimore të Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së të Ardhurave Publike.

UNICEF-i e mbështeti MASH-in për të inicuar reformën e transferimin në komuna të mjeteve për financim të shkollave fillore dhe të mesme. Janë zhvilluar formula të reja financimi, të bazuar në numrin e nxënësve dhe kostot për përmbushjen e standardeve arsimore dhe të njëjta u përfshinë në buxhetin nacional të vitit 2022, duke e rritur efikasitetin, përmirësuar transparencën dhe drejtësinë e financimit dhe duke vendosur mekanizma që do të rrisnin cilësinë e mësimdhënies. Gjithashtu janë bërë ndarje adekuate për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe për mësimdhënien në gjuhët e bashkësive më të vogla etnike. Këto formula do t'u sigurojnë shkollave fonde të mjaftueshme për mirëmbajtje adekuate, investime të përshtatshme në pajisje dhe mjete mësimore, trajnim profesional dhe zhvillim të karrierës së stafit të shkollës, si dhe rritjen e numrit të bashkëpunëtorëve profesional. Për herë të parë, fondet e arsimit fillor 2022 të transferuara në komuna, të përgatitura në bazë të formulave të financimit të zhvilluara me mbështetjen e UNICEF-it, përfshijnë ushqime falas për nxënësit nga klasa e parë deri në të pestën, duke i zgjeruar kështu më tej programet universale të mbrojtjes sociale për fëmijët, si dhe tableta falas për qasje në burimet arsimore digjitale për nxënësit nga familjet në rrezik social.

PRODHIMI 4.3. POLITIKBËRJA E BAZUAR NË DËSHMI, TRANSPARENTE DHE E ORIENTUAR DREJT REZULTATEVE

Proceset transparente dhe pjesëmarrëse të zhvillimit të politikave në të gjitha degët dhe nivelet e qeverisjes fituan një theks të fortë të evidenca dhe të dhënat, objektivat dhe treguesit e matshëm të përafër me OZHQ-të. **UNDP përditësoi Indeksën e Zhvillimit Komunal**, si burim më i besueshëm i të dhënave për zhvillimin socio-ekonomik të komunave në vend. Ky Indeks u përafër gjithashtu me Strategjinë për Zhvillimin Rajonal 2021-2031 dhe Programin për Zhvillim të Qëndrueshëm Lokal dhe Decentralizim 2021-2026, me çka u bë më i ndjeshëm për komponentin gjinor duke i përmirësuar statistikën gjinore dhe mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë.

UNDP mbështeti 34 komuna për ta përmirësuar planifikimin dhe zbatimin e projekteve zhvillimore. Qytetarë nga 55 pushtete vendore (nga gjithsej 81 sosh në vend) përfituan nga zgjidhjet inovative digjitale që mundësojnë politikbërje gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në fakte dhe ofrim të avancuar të shërbimeve. Paralelisht, 7 komuna u mbështetën për ta përmirësuar bashkëpunimin me OSHC-të dhe për të ofruar shërbime të jashtme. Mbi 130 përfaqësues të administratës komunale dhe këshilltarë i kanë rritur njohuritë e tyre për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, statistikën gjinore dhe indikatorët gjinorë përmes sesioneve trajnuese të organizuara nga Bashkësia e Njësisve të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL).

UNFPA ka mbështetur zbatimin e strategjisë së komunikimit të Regjistrimit të ESHS-së, e cila ka ndikuar pozitivisht në procesin e mbledhjes së të dhënave të ndara sasiore dhe cilësore gjatë Regjistrimit të vitit 2021. Gjithashtu, kapacitetet analitike dhe raportuese të ESHS-së u rritën në lidhje me indikatorët e OZHQ-ve, veçanërisht indikatorin 5.1.1 i OZHQ-së, duke përfshirë indikatorë të ndarë sipas gjinisë, si dhe një pjesë të grupit të pyetjeve të Uashingtonit për vetëvlerësimin e aftësisë së kufizuar në mbledhjen e të dhënave. UNFPA vazhdoi të sigurojë të dhëna dhe kërkime analitike mbi ndikimin socio-ekonomik të COVID-19 te fëmijët, gratë, viktimat e dhunës dhe grupet e tjera të cenueshme.

UN Women e mbështeti Qeverinë në transpozimin e legjislativitetit të BE-së për Barazimin Gjinor. Duke e punuar për së afërmi me SÇE-në, një qasje dhe ekspertizë të përbashkët e strukturuar çoi drejt përmirësimit të integritetit gjinor në proceset e integritetit në BE. Është ofruar ekspertiza konkrete gjinore në dialogun e para-anëtarësimit në BE, duke përfshirë perspektivën gjinore në 15 përgjigjet strategjike

të vendit. Analiza e mbështetur nga UN Women të 10 edicioneve të kaluara të publikimit statistikor "Gratë dhe Burrat në Republikën e Maqedonisë/Maqedonia e Veriut", ofron rekomandime se si të përmirësohet publikacioni dhe si të harmonizohen më mirë publikimet e ESHS-së me indikatorët tjerë zë OZHQ-së të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë gjinore.

"Analiza e rasteve të femicideve në Maqedoninë e Veriut 2017-2020" e sponsorizuar nga UNDP-ja e zbuloi një numër të madh të grave viktime, duke u bërë thirrje autoriteteve përgjegjëse të ndërmarrin veprime vendimtare, shumë-sektoriale dhe gjithëpërfshirëse. Më shumë se 1000 përdorues e kanë shkarkuar aplikacionin celular "BE SAFE". Aplikacioni, së bashku me mediat sociale dhe fushatat e informimit në zonat rurale, e përmirësoi ndërgjegjësimin dhe qasjen në shërbimet e DHBGJ-së. Meqenëse digjitalizimi ofron një shtrirje më të gjerë, u bënë përpjekje për të zgjeruar shtrirjen në zonat rurale dhe drejt të gjitha grupeve demografike të grave nëpërmjet fushatës së mediave sociale.

UNICEF-i e mbështeti procesin e formulimit të një Strategjie Nacionale të Drejtësisë për Fëmijët, duke propozuar një program gjithëpërfshirës dhe pragmatik të aktiviteteve për ta arritur gradualisht një ndryshim pozitiv për fëmijët në kontakt ose konflikt me ligjin. Me qëllim të forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve të Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikuençës së Fëmijëve, u realizua një vlerësim, i cili i përcaktoi fushat e zhvillimit profesional. Theks i madh u vu edhe në pjesëmarrjen e fëmijëve në krijimin e zgjidhjeve për qasje në drejtësi. 60 fëmijë u përzgjedhën për të qenë pjesë e programit, duke u bërë kështu avokatë të drejtësisë për fëmijët dhe të rinjtë. UNICEF-i e mbështeti në vitin 2021 azhurnimi e studimit mbi efektet sociale dhe ekonomike të COVID-19 te fëmijët. Studimi në fjalë vlerëson se do të rritet varfëria relative e fëmijëve nga 27.8% para pandemisë në 32.4% pas saj, duke vënë në rrezik 19,000 fëmijë të tjerë. Derisa vazhdon pandemia, ndërprerjet në shërbimet e mbrojtjes sociale dhe arsimore dhe ulja e kërkesës për shërbime shëndetësore po i vënë fëmijët në rrezik të mëtejshëm.

IOM, UNHCR dhe UNFPA, në partneritet të ngushtë me palët kryesore nacionale, e filluan një program të ri të përbashkët që synon t'i forcojë kapacitetet dhe sistemet për qeverisje novatore dhe parashikuese në fushën e menaxhimit të migracionit. Në këtë drejtim përfundoi hartëzimi i palëve kryesore nacionale dhe u zhvilluan 8 takime intervistash me institucionet nacionale, agjencitë e OKB-së dhe OJQ-të, të përfaqësuara në organin ndërqeveritar për zhvillimin dhe zbatimin e politikës së migracionit 2021-2025, i miratuar në dhjetor të vitit 2021. Sipas një komponenti tjetër të programit të përbashkët, i cili e synon përmirësimin e mbledhjes dhe analizës së të dhënave sistematike, u zhvillua një koncept shënim, që ofron pasqyrë të analizë së remitançave. Kjo analizë ofron njohuri dhe udhëzime politikash si për matjen e migracionit ashtu edhe për kontabilitetin e remitançave. Fokusi specifik në flukset, vëllimet, mekanizmat e transferimit dhe përdorimin e remitançave veçon shumë përparësi në drejtim të hartimit të politikave, që mund të ofrojnë një shfrytëzim më të plotë të potencialit të tyre ekonomik dhe social. Puna për flukset e remitançave përmes kanaleve joformale rezultoi me një metodologji anketimi dhe instrumente anketimi. Në një muaj, 4 video të fushatës në rrjetet sociale kanë arritur më shumë se 740.000 shikime ose 450.000 persona, që është gati 45 herë më shumë se objektivi i vendosur dhe prezantimi i fushatës në mediat nacionale në të gjithë vendin.

PRODHIMI 4.4. KOHEZIONI SOCIAL

Gjatë gjithë vitit 2021, kohezion më i madh shoqëror dhe qëndrimet pozitive publike ndaj grupeve të cenueshme dhe të përjashtuara u promovuan përmes avokimit, strategjive të komunikimit, shtrirjes dhe përpjekjeve për përfshirjen dhe integrimin e njerëzve të mbetur pas, duke përfshirë gratë, migrantët, refugjatët, azilkerkuesit, njerëzit pa shtetësi dhe disa minoritete etnike.

Një vegël e rëndësishme për të ndihmuar në transformimin e narrativit të shoqërisë është **Strategjia e Komunikimit për**

Ndryshimin Social, e prodhuar nga UNHCR me ekspertë nga Universiteti i Kentakit. Për të ndihmuar në çuarjen përpara të Strategjisë, UNHCR-ja e krijoi një Trup Këshillimor të përbërë nga përfaqësues nga sektorë të ndryshëm të shoqërisë, si dhe një Qendër komunikuesish, një grup komunikuesish nga i gjithë bordi me synim të ndërtimit të kapaciteteve reciproke dhe veprimi të përbashkët për ndryshim shoqëror.

Strategjia e Komunikimit për Ndryshimet Sociale i identifikon mesazhet dhe mjetet kryesore që synojnë ndryshimin e sjelljeve dhe nxitjen e pikëpamjeve pozitive për refugjatët dhe migrantët si palë të zhvillimit. Strategjia, e zbatuar me partnerë të ndryshëm, veçanërisht me Institutin e të Drejtës Humanitare në San Remos, mundësoi trajnimin e 161 zyrtarëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile, gazetarëve (61% gra). U organizua një fushatë për nxitje të ndjenjave pozitive ndaj refugjatëve, migrantëve dhe personave pa shtetësi nën sloganin "Jo urrejtje - ndërto një qëndrim".

Fushata, së bashku me iniciativat tjera si Festivali i Xhazit në Shkup, Çmimi i Gazetarëve, Festivali Mediatik Shkupi, arriti shtrirje deri të 555.173 persona gjatë vitit 2021.

UN Women e përforcoi avokimin për fuqizimin, pjesëmarrjen dhe mundësitë e barabarta të grave, veçanërisht atyre më të cenushme. Partneriteti me 16 komuna rezultoi në 36 masa politikash, që ofrojnë shërbime të ndjeshme ndaj gjinisë, moshës dhe aftësisë së kufizuar në shëndetësi, mbrojtje sociale, transport publik si dhe **dhunë mbi bazë gjinore**. Me mbështetjen e OKB-së, mbi 3,300 gra u përfshinë drejtpërdrejt në informimin dhe ngritjen e ndërgjegjësimit të kryer nga OSHC-të dhe organizatat bazë të grave, ndërsa 128 gra i fuqizuan aftësitë e tyre lokale avokuese dhe drejtuese. Këto aktivitete rezultuan në 216 masa të politikave të propozuara nga gratë në 13 komuna (<https://bit.ly/3f3cVhx>), me çka u dorëzua në komuna pamje vizuale e prioritetëve të grave (<https://bit.ly/3t9yhST>) në kuadër të fushatës "Bëhuni të zëshëm dhe të qartë".

Mbështetja e UNDP-së rezultoi në zgjidhje inovative digjitale, që e rritën transparencën dhe llogaridhënien e qeverisjes vendore. Këto zgjidhje inovative mundësuan një shfrytëzim më të madh të bashkëpunimit ndërkomunal si një mekanizëm efektiv i ofrimit të shërbimeve alternative gjatë KOVID-19, që e fitoi vendin e tretë në Samitin Global për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur (PQH) për ndikim në përmirësimin e jetës së njerëzve dhe cilësinë e demokracisë. Grantet të posaçme mediatike kanë mundësuar që 140 forume televizive të shërbejnë si mekanizëm për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrjen e komunave. Po shtu metodologjia e Demokracisë lokale është miratuar nga 4 komuna të reja. 44 nëpunës civilë janë përzgjedhur për të marrë pjesë në fazën e dytë të projektit ReLOaD. Angazhimi aktiv i UNDP-së dhe modeli i ri i projektuar i financimit, të bazuar në projekte nga buxhetet e qeverisjes vendore, siguruan mbështetje për agjencinë e shoqërisë civile, rininë dhe gratë në nivel vendor.

PRODHIMI 4.5 KONFISKIMI (RIKUPERIMI) I PASURISË DHE LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Në përgjigje të prioritetit kryesor të qeverisë për luftë kundër korrupsionit dhe për ta siguruar konfiskimin e pasurisë, **UNODC** e mbështeti zhvillimin e dokumenteve kyçe – **Strategjinë e Konfiskimit të pasurive dhe Udhërrëfyesin kundër Korrupsionit dhe Financat e Paligjshme**, që mbulojnë të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor.

UNDP vazhdoi të mbështesë një bashkëpunim ndërkuftar dhe një qasje të integruar **në luftën kundër posedimit dhe trafikimit të paligjshëm të armëve të vogla ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës**. Një softuer dhe pajisje speciale i mundësoi Ministrisë së Punëve të Brendshme ta përmirësojë shkëmbimin e të dhënave në lidhje me incidentet dhe ngjarjet që përfshijnë armë zjarri. Dorëzimi i softuerit u shoqërua me një trajnim të specializuar të stafit mbështetës të sistemit. 60 zyrtarë policie i avancuan aftësitë e tyre për mbledhjen, analizimin dhe përmirësimin e informacioneve dhe proceseve në të dy juridiksionet, gjë që çoi në përmirësimin e shkëmbimit të të dhënave, efektivitetin e ekipeve të përbashkëta të hetimit dhe sekuestrimit e armëve të vogla dhe të lehta. Është prodhuar dhe transmetuar një video promovuese për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut.

[4] Akronimet dhe shkurtesat

BOS	Business Operations Strategy	NEET	Youth Not in Education, Employment or Training
CAP	Common Agricultural Policy	NES	National Employment Strategy
CEDAW	Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women	OG	SDCF Outcome group
CSA	Climate-smart agriculture	OPDs	Organizations of persons with disabilities
DV	Domestic violence	PAs	Protected areas
eNDC	Enhanced nationally determined contribution	PMT	UN Programme Management Team
EPR	Environmental Performance Review	PSD	Partnership for Sustainable Development
ESA	Employment Support Agency	PWD	Person with disabilities
ESC	Economic and Social Council	RC	Resident Coordinator
EU	European Union	RCO	UN Resident Coordinator's Office
GCF	Green Climate Fund	RMPS	Resource Mobilization and Partnership Strategy
GHG	Greenhouse gas	SDCF	Sustainable Development Cooperation Framework
GRB	Gender-responsive budgeting	SDGs	Sustainable Development Goals
GREVIO	Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence	SEEU	South-East European University
HCFCs	Ozone depleting substances	SEL	Social and emotional learning
HDI	Human Development Index	SSO	State Statistical Office
HORECA	Hotels, restaurants, and cafes	UN	United Nations
HOTAM	Association of employers in hotel and catering	UNCT	United Nations Country Team
ICF	International classification of Functioning, Disability and Health	VET	Vocational education and training
ILS	International Labour Standards	WAV	Violence against women
JSC	Joint Government-UN SDCF Steering Committee		
MAFWE	Ministry of Agriculture, Forestry and Water Economy		
MAP	Modified atmosphere packaging		
MLSP	Ministry of Labour and Social Policy		
MoES	Ministry of Education and Science		
MoEPP	Ministry of Environment and Physical Planning		
MRV	Monitoring, Reporting and Verification		
NDS	National Development Strategy		



UNITED NATIONS
NORTH MACEDONIA



northmacedonia.un.org

www.facebook.com/1un.mk

www.twitter.com/1UN_MK